



KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e VII-të (shtatë) -e rregullt, mandati VIII-të, e mbajtur më 31 mars 2026.

Mbledhja filloi në orën 10:20 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Isak Shabani Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Në mbledhje të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV: *Adelinë Stublla; Artrit Mulliqi; Fatri Zhitija; Kasib Bashota; Florent Hasani; Valdet Kamerolli; Arbrim Konushevc; Flandra Kadriu; Luljeta Muçolli-Azemi; Vlora Jashanica; Haki Rudari; Abedin Zeka; Avni Islami; Qëndresë Hajrizi; Ardi Hasani.*

Nga LDK: *Enis Shabani; Alisa Jetullahu; Enis Dërvisholli; Besim Latifi; Valdet Restelica; Blerta Azemi-Berisha; Valon Demolli; Ekrem Rrahmani; Ermal Osmani; Gresa Qosa-Maqastena; Arben Xhemajli; Arnisa Sylejmani; Isak Ejupi.*

Nga PDK: *Isak Shabani-Kryesues i Kuvendit; Lulzim Pollomi; Mimoza Abdullahu; Rinesa Goxhufi,*

Nga GUXO: *Demokrat Hodolli.*

Nga Unioni i Blakçorve: *Gentrit Arifi.*

Nga AAK: *Baki Feta, (i cili me kërkesë të tij, pas një kohe rreth 30 minutave, u lirua nga mbledhje për shkaqe shëndetësore).*

Gjithashtu të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin, z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës, U.D. drejtorët/shat e Drejtorive të Komunës, dhe atë;

(Ditjona Statovci-Drejtoria e Administratës DA; Arbnorë Uka Osmani-Drejtoria e Buxhetit dhe Financave DBF; Avni Fetahu-Drejtoria e Arsimit DKA; Lirie Hoti Rama-Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Saranda Stublla-Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Valbona Ibishi Azemi-Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSSH; Shuajb Blakçori-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSSH; Behram Latifi-Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE).

Të pranishëm ishin edhe, përfaqësues media lokale (TV Llapi), përfaqësues të KFOR; dhe disa zyrtar komunal.

Rendi i Ditës

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, konstatoi kuorumin ku për momentin sipas listës së nënshkrimeve dhe numërimit, 33 anëtar/e të Kuvendit ishin prezent për momentin në sallë, andaj mund të vazhdohet me punë, theksoi, kjo seancë është thirrur në përputhje me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale, Statutin e Komunës dhe në pajtim me Rregulloren e punës, andaj duke qenë se thirrja dhe materialet për këtë mbledhje ju janë shpërndarë me kohë, e shpallë të hapur mbledhjen e VII-të të mandatit të VIII-të, të rregullte të Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Të nderuar, para vetës kemi propozim rendin e ditës për këtë mbledhje, të cilin e keni marrë me kohë edhe në mënyrë elektronike duke përfshirë edhe konstatimet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa ku është shtuar edhe një pikë e rendit të ditës që është Propozim vendimi për ngritjen e Komisionit të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim - Podujevë, andaj para se të hedhet në votim rendi i propozuar i ditës, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën.

z.Isak Ejupi, theksoi, para se të hyjmë në seancë unë e kam një vërejtje, edhe kjo seancë është sikurse edhe tjerat që asnjëherë nuk fillon në kohën që thirret, do të thotë se tani veç janë 20 minuta vonesë e që për mua është e pakuptimtë, pra nëse seanca thirret në ora 10:00 do të duhej të merreshin masat që ajo edhe të filloj në ora 10:00 dhe pastaj të përfundoj apo të zgjatë sa do që kemi shqyrtim dhe diskutime të temave të parapara. Pra asnjë seancë deri më sot nuk ka filluar në kohën e paraparë, prandaj ju lus që herëve tjera t'i ndërmerri masat që seanca të filloj dhe përfundoj në mënyrë të rregullt.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën rreth rendit të ditës, atëherë e hedh në votim propozimin e rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, përfshirë edhe Konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së ku përfshihet edhe pika shtesë e rekomanduar.

Pas votimit, u konstatua se Njëzëri me 34 vota Për nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, përfshirë edhe Konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 30 mars 2026 ku përfshihet edhe pika shtesë e rekomanduar:

- Propozim vendim për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim Sh.A Podujevë

Rendi i miratuar i ditës:

1. *Procesverbalet nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, të mbajtura më: 29 janar 2026; 17 shkurt 2026; 26 shkurt 2026; 05 mars 2026*
2. *Raporti Vjetor Financiar i Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025*
3. *Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësitë kadastrale P-00706-0 dhe P-00704-0, Zona Kadastrale Llpashticë e Poshtme*
- 3.1. *Propozim vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*
4. *Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-202-3, Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm*
- 4.1. *Propozim vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*
5. *Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1339-0, Zona Kadastrale Orllan*
- 5.1. *Propozim vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*
6. *Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00459-0, Zona Kadastrale Podujevë*
- 6.1. *Propozim vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*
7. *Propozim vendim për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunë*
8. *Propozim vendim për dhënie në shfrytëzim afatgjatë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, objektin e ish Emergjencës së Qytetit*
9. *Propozim vendim për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Kompania Regjionale e Mbeturinave "Pastrimi" Sh.A.*
10. *Propozim vendim për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale Stacioni i Autobusëve Podujevë Sh.A*
11. *Propozim vendim për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Eko-Llapi" Sh.A Podujevë*
12. *Propozim vendim për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim Sh.A Podujevë*
13. *Të ndryshme*

**1. Procesverbalet nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, të mbajtura më:
29 janar 2026; 17 shkurt 2026; 26 shkurt 2026; 05 mars 2026**

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, siç e keni parë kemi 4 procesverbale nga mbledhjet e kaluara të Kuvendit, andaj nëse ndokush nuk ka vërejtje apo plotësim ndryshime në ndonjë procesverbal, unë me pajtimin e juaj do t'i hedhja në votim që të katërtit përnjëherë, por nëse nga ndokush vërejtje eventuale apo plotësim ndryshime në ndonjërin prej tyre atëherë votojmë veç e veç për secilin.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, duhet të hedhen në votim një nga një këto procesverbale të mbledhjeve të Kuvendit sepse dikush në disa seanca ka munguar, shembull unë nuk e votoj procesverbalin e mbledhjes së 05 marsit 2026 ngase nuk dua të votoj atë çka ke fole ti Kryesues me njerëz të Prishtinës që i ke ftuar këtu duke na tejkaluar edhe neve, Shoqatat e Luftës e të gjithë, kështu që hedhi në votim një nga një dhe pastaj votojmë disa për disa kundër.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, atëherë urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo pa humbur kohë i hedh në votim një nga një sipas radhës procesverbalet nga katër mbledhjet e kaluara të Kuvendit sipas kësaj pike të rendit të ditës.

Pas votimeve të ndara për secilin procesverbal veç e veç, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se:

-Njëzëri me 35 vota Për, miratohet pa vërejtje apo plotësim ndryshime Procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 29 janar 2026

-Njëzëri me 35 vota Për, miratohet pa vërejtje apo plotësim ndryshime Procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 17 shkurt 2026

-Njëzëri me 35 vota Për, miratohet pa vërejtje apo plotësim ndryshime Procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 26 shkurt 2026

-Nga 35 anëtarët e Kuvendit, me 28 vota Për, 2 vota Kundër, asnjë votë e Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), miratohet pa vërejtje apo plotësim ndryshime Procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 05 mars 2026

**2. Raporti Vjetor Financiar i Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më
31 dhjetor 2025**

znj.Arbnorë Uka-Osmeni, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, përshëndeti të pranishmit dhe filloj me paraqitjen e Raportit në fjalë duke theksuar, kam nderin dhe përgjegjësinë që sot, në cilësinë e Drejtoreshës së Financave, të paraqes para jush raportin financiar për vitin 2025. Ky raport paraqet një pasqyrë të plotë të menaxhimit të mjeteve publike gjatë vitit që lamë pas, duke përfshirë të hyrat, shpenzimet, si dhe nivelin e realizimit të buxhetit komunal. Të hyrat buxhetore janë realizuar në një nivel të kënaqshëm, duke reflektuar angazhimin në rritjen e disiplinës financiare dhe përmirësimin e mekanizmave të mbledhjes së të hyrave. Në anën tjetër, shpenzimet janë orientuar kryesisht drejt prioriteteve zhvillimore, përfshirë investimet kapitale, shërbimet publike dhe mbështetjen e sektorëve më me rëndësi për komunitetin ton.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar realizimit të projekteve kapitale, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e infrastrukturës dhe cilësisë së jetës së qytetarëve tanë.

Po ashtu, është synuar që çdo shpenzim të jetë i arsyetuar dhe në përputhje me planifikimin buxhetor dhe legjisllacionin tone në fuqi. Megjithatë, si në çdo vit tjetër edhe në vitin e kaluar ka

pas sfida me të cilat është dashur të ballafaqohemi e të cilat kanë ndikuar në ritmin e realizimit të disa projekteve apo kategorive buxhetore, por pavarësisht kësaj, janë ndërmarrë masa konkrete për të adresuar këto sfida dhe për të përmirësuar performancën financiare.

Në vazhdim po paraqesim raportin financiar për vitin fiskal 2025, besoj se materialin e keni pranuar me kohë dhe keni pasë kohë për të analizuar, por tutje unë po e paraqes në vlera financiare gjithë raportin ashtu në mënyrë të përmbledhur e mandej jemi të hapur për debate.

Shuma totale e buxhetit fillestar dhe atij përfundimtar dhe shpenzimit të buxhetit për vitin 2025 është sipas strukturës së paraqitur në vijim:

Te paga dhe shtesa ka pas lëvizje dhe dallim prej buxhetit fillestar dhe atij final, ku buxheti fillestar ka qenë 17,669,041.00€ kurse buxheti final ka qenë 19,222,217.00€.

Te mallra dhe shërbime po ashtu ka pas një lëvizje të vogël dallim prej buxhetit fillestar dhe buxhetit final e që buxheti fillestar ka qenë 4,090,032.00€ ndërsa buxheti final 4,097,234.00€.

Te shpenzimet komunale nuk ka pasur lëvizje, ndërsa te transferet dhe subvencione ka pasë po ashtu lëvizje dallim prej buxhetit fillestar dhe atij final ku buxheti fillestar ka qenë 1,810,000.00€ ndërsa buxheti final ka qenë 2,099,889.00€.

Te shpenzimet kapitale kanë qenë 9,256,442.00€, ndërsa buxheti final ka qenë 10,442,532.00€.

Total dallimi prej buxhetit fillestar të aprovuar në Kuvendin e Komunës së Podujevës, dhe atij final është 33,459,115.00€ si buxhet fillestar, ndërsa buxheti final 36,495,472.00€.

Realizimi i gjithë buxhetit është në vlerë 35,580,856.00€ apo shprehur në përqindje 98%, në vazhdim do t'i cekë të gjitha kategoritë ekonomike me përqindje secila qysh është realizuar.

Te pagat dhe shtesa, realizimi i buxhetit është 99.91%, prej grandit qeveritar 19,061,000.00€ kurse nga të hyrat vetanake 143,943.00€.

Te mallra dhe shërbime, 4,097,000.00€ buxheti, kurse realizimi 4,062,000.00€, prej grandit qeveritar 4,006,431.00€ kurse prej të hyrave vetanake 55,844.00€, realizimi i buxhetit është 99%.

Te shpenzimet komunale kemi realizimi 100% kuptohet kjo.

Te tranfere dhe subvencione realizimi i buxhetit është 89% dhe atë nga grandit qeveritar 827,906.00€ ndërsa prej të hyrave vetanake 770,991.00€.

Te shpenzimet kapitale realizimi i buxhetit është 96%, prej grandit qeveritar 8,473,730.00€ kurse prej të hyrave vetanake 1,280,067.00€.

Kemi pas edhe prej Klauzoles Investive në vlerë 88,130.00€.

Performanca e shpenzimeve siç e dim te pagat dhe mëditjet me dy Vendime të Qeverisë është bërë shtim në buxhet dhe atë në vlerë 1,553,176.00€.

Realizimi i të hyrave vetanake, buxheti fillestar i aprovuar në Kuvendin e Komunës për tatimin në pronë si të hyra direkte ka qenë 774,542.00€ ndërsa realizimi është 574,315.00€ pra kemi një realizim prej 74%. Pastaj të hyra jo tatimore direkte kemi një tejkalim të planifikimit fillestar buxhetor ku buxheti fillestar ka qenë 1,211,794.00€ ndërsa realizimi është 1,574,481.00€, apo 130%. Gjjobat në trafik, gjjobat e Gjykatave dhe të hyrat tjera siç e dim nuk planifikohen në buxhet kurse realizimi i tyre është përafërsisht 650,000.00€.

Nga buxheti i vitit 2025 kanë mbetur mjete të pashpenzuara, dhe atë nga grandit qeveritar vetëm 868,000.00€ që kanë shkuar në suficit, ndërsa të hyrat vetanake kanë mbetur 1,441,498.00€ të cilat pritet të barten gjatë prillit në buxhetin e 2026 për arsye se jemi duke pritur barazimet në Thesar.

Të hyrat vetanake të bartura të vitit të kaluar 890,001.00€, të hyrat e realizuara gjatë vitit 2025 në shumë 2,802,342.00€ dhe shuma e shpenzuar e të hyrave vetanake total nëpër projekte të ndryshme është 2,250,845.00€.

Siç e dim dhe jeni të informuar, ndër vite kemi pasur vendime Gjyqësore të cilat kanë prekur disa projekte, dhe unë këtu para vetës kam Vendimet Gjyqësore të marra gjatë vitit 2025 dhe ato të

ndara nëpër projekte të ndryshme, total vlera me Vendime Gjyqësore është 3,786,581.00€, prej mallrave dhe shërbimeve kemi 647,569.00€ apo krahasim me buxhetin e aprovuar është 3.37% e buxhetit që kanë shkuar për Vendime Gjyqësore. Te shpenzimet komunale kemi 13.09%, pa dashur t'i përmend termat financiar sepse më duket se po bëhet e tepërt por më shumë po i cekë me përqindje sepse është më e kapshme besoj, subvencione dhe transfere është 19.24% që kanë shkuar me Vendime Gjyqësore, shpenzime kapitale 25.51%, shprehur në vlerë financiare është 2,651,921.00€.

Ju falënderoj për vëmendjen dhe mbetem e hapur për pyetje apo komente sa i përket këtij Raporti financiar dhe shpenzimeve të realizuara gjatë vitit 2025.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, para se të vazhdojmë me punë, vetëm dëshiroj t'ju njoftoj se asambleisti z.Baki Feta nuk është në gjendje të mirë shëndetësore dhe ka kërkuar të lirohet nga kjo seancë, prandaj unë e liroj dhe vetëm i dëshiroj shërim sa më të shpejtë.

z.Haki Rudari, theksoi, monitorimi dhe mbikëqyra nga Kuvendi i Komunës lexohet përmes tri shtyllave kryesore, shtylla e parë dhe më e rëndësishme është Kuvendi i Komunës si organi më i lartë i pushtetit lokal dhe natyrisht si i autorizuar në mënyrë ligjore, pastaj shtylla e dytë e mbikëqyrjes është Auditimi i brendshëm dhe shtylla e tretë për auditimet e buxhetit komunal është Auditimi i jashtëm.

Natyrisht raportimet apo Raporti financiar është një prej mekanizmave kryesor përmes të cilave secili këshilltar komunal, por jo vetëm këshilltarë por edhe anëtarë apo qytetarë të ndryshëm, janë të njoftuar lidhur me grumbullimin e mjeteve buxhetore por në të njëjtën kohë edhe me natyrën e planifikimit apo harxhimit të atyre mjeteve buxhetore.

Ne kemi këtë Raport vjetor të vitit 2025, dhe nëse mund të shprehem juridikisht te neni 13 kemi pasqyrën e pranimeve dhe pagesave me para të gatshme deri më 31 dhjetor 2025. Fillimisht i kemi burimet e fondeve apo pranimet e buxheteve; 1-grandit qeveritar, 2-të hyrat vetanake, 3-grandet e përcaktuara nga donatorë të ndryshëm dhe 4-klauzola për investime kapitale. Në të njëjtën kohë tek kjo pasqyrë kemi edhe shpenzimin e fondeve apo pagesa të ndryshme dhe natyrisht se pjesa më e madhe e shpenzimeve ose pagesave është bërë tek pagat dhe mëditjet, në të njëjtën kohë një pagesë e madhe është bërë edhe te investimet kapitale. Totali i shpenzimeve për periudhën janar-dhjetor 2025 është 35,580,856.00€, nga kjo shumë mbi 33 milion euro janë grande qeveritare, dhe natyrisht 2,250,845.00€ janë të hyra vetanake.

Sa i përket investimeve kapitale kemi një shumë prej 9,841,928.00€ dhe ajo që është më detaj për mua që ta përfundoj si raport financiar, pra kemi mbi 9 milion euro investime që janë bërë në Komunën e Podujevës, dhe ato investime janë bërë nëpër sektor të ndryshëm *(ju lutem të ketë qetësi sepse nuk vazhdoj tutje, përndryshe unë 35 vite kamë punë në arsim dhe nuk vazhdoj pa pasë qetësi)*.

Pra dua ta përfundoj dhe ajo çka është te përfundimi i këtij Raporti kemi pra mbi 9 milion euro harxhime, investime në arsim, shëndetësi, kulturë, rini, sport e të tjera. Unë e kuptoj se kërkesat e qytetarëve janë të mëdha por në të njëjtën kohë edhe buxheti i Komunës është ai i cili është dhe më shumë se ky buxhet nuk mund të del askush.

Një shumë e madhe e parave që është bërë harxhim, e potencoj edhe drejtoresha parafolëse e DBF, është për pagesa Gjyqësore, obligim i Kontratës Kolektive që është nënshkruar diku nëse nuk gaboje në prill të vitit 2017 dhe ai obligim po i përcjellë Komunitat e natyrisht po kanë edhe dëme sa i përket procedurave Gjyqësore por jo vetëm në Komunën tonë, mirëpo nëse nuk gaboje janë shumica e Komunave që i kanë këto probleme rreth pagesave Gjyqësore, megjithatë më duhet të them se është një obligim që ka rrjedh nga Kontrata Kolektive e nënshkruar në prill të vitit 2017.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, lus drejtoreshën e DBF që për të mos bërë debat me secilin këshilltarë të Kuvendit, t'i evidenton kërkesat e tyre dhe pastaj në fund të mund të përgjigjet.

z.Besim Latifi, theksoi, sot po e diskutojmë Raportin financiar të Komunës së Podujevës për vitin fiskal 2025. Nga analiza e këtij raporti, shohim se kryefjalë e tij janë suficiti shumë i lartë dhe borxhi shumë i lartë. Në përgjithësi, raporti financiar për pasqyrat financiare të Komunës duhet të paraqesë një pasqyrë të detajuar të të hyrave dhe shpenzimeve për vitin fiskal 2025, por dokumenti që e kemi në dorë, shtrohet pyetja, a e paraqet gjendjen reale se si janë shpenzuar paratë publike gjatë vitit fiskal 2025, përgjigja është fatkeqësisht, jo.

Karakteristikë e këtij raporti është se ai është një dokument që tregon mungesë kompetence, si në aspektin profesional dhe përmbajtësor, ashtu edhe në aspektin teknik. Raporti është i paqartë, me mungesë bazike të të dhënave, me fare pak informacione se si janë shpenzuar paratë nëpër kategoritë ekonomike, me mungesë të të dhënave për pjesën më të madhe të zërave buxhetorë, ndërsa edhe ato të dhëna që janë, janë të pasakta dhe të pamatshme. Tabelat janë të paraqitura me mangësi dhe me shënime gjysmake. Çdo tabelë duhet të tregoj ose të paraqesë të dhënat e sakta dhe të detajuara për vitin raportues, si dhe të dhënat krahasuese për dy vitet paraprake, 2024 dhe 2023, kush ka punuar pasqyra financiare këtë e din shumë mirë. Tabelave u mungojnë të dhënat vertikalisht për vitet, si dhe burimi i mjeteve nga janë financuar dhe shpenzuar ato, dhe në vazhdim unë do t'i cek disa prej tyre, duke filluar nga tabela e shpenzimeve;

Shënimi nr. 2-paga dhe shtesa, shuma në kolonën e parë nuk sqaron asgjë, paraqitet si shumë totale 19,205,000.00€, ndërsa kur i mbledhim shumat sipas zërave buxhetorë, del se kolona e parë është 3,202,000.00€, e jo 19,205,000.00€ siç është paraqitur. Pra, mbi 16 milionë euro nuk janë të pasqyruara fare sipas zërave buxhetorë.

Kolona e dytë, është paraqitë shpenzim nga grandit qeveritar, e që në total 19,061,000.00€, ndërsa pas verifikimit, del se pagesat janë 3,202,000.00€, pra prapë mbi 16 milionë euro nuk janë paraqitur se ku janë shpenzuar, sipas zërave buxhetor gjithnjë.

Kolona e tretë, kemi shpenzimet nga të hyrat vetanake, por nuk i pasqyrojnë ku janë shpenzuar 144,000.00€, në cilët nga zërat buxhetor.

Përveç këtyre paqartësive, kësaj tabele dhe të gjitha tabelave të tjera u mungojnë të dhënat krahasuese për vitet paraprake 2024 dhe 2023, e të cilat sipas Rregullores për raportim financiar janë të domosdoshme për krahasim dhe analizim të raportit.

Ky raport është gjysmak, i dobët dhe joprofesional, i kamufluar dhe fsheh shpenzime të shumta, të bëra në vitin 2025 e që e dimi që ka qenë një vit zgjedhor, dhe paratë janë shpenzuar qysh ju kanë dashur juve e në kundërshtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe Rregulloren për shpenzimin e parasë publike. Nga ky raport i dobët, pritët të dalë negativ dhe i kualifikuar edhe Raporti i Auditorit të Përgjithshëm, siç ka ndodhur edhe në vitet e kaluara, si rezultat i kësaj, Komuna jonë ka humbur grandin e performancës për disa vite radhazi.

Në vitin e gjashtë të qeverisjes suaj, asnjëherë, do të thotë jeni në vitin e gjashtë dhe asnjëherë nuk e keni fituar grandin e performancës, kjo flet shumë për mënyrën tuaj të qeverisjes kurse qytetarët kanë humbur miliona që do të mund të investoheshin në projekte zhvillimore. Nëse e përdori fjalorin e juaj partiak, ky Raport financiar paraqet një gjakderdhje të rëndë financiare në të gjitha kategoritë ekonomike.

Pastaj nëse shohim shënimin nr.3-mallra dhe shërbime, pra edhe kjo tabelë nuk tregon të dhënat e pasqyruara sipas burimit të mjeteve nga janë marrë mjetet, pra janë vetëm disa zëra të paktë se ku janë shpenzuar ato. Kjo tabelë pasqyrojnë vetëm 15 lloje të shpenzimeve, kurse plani kontabël është shumë më i gjerë dhe është dashur t'i paraqitni shpenzimet sipas planit kontabël e jo kështu të përmbledhura, edhe ato të pasakta.

Buxheti total i shpenzuar në këtë kategori, sipas shënimeve, është 4,062,325.00€, nga ky shpenzim, vetëm për Vendime Gjyqësore janë 647,569.00€, ose 16% e këtyre shpenzimeve janë

shkuar për Vendime Gjyqësore, nga kjo del se në këtë kategori kemi dëmtim të mallrave dhe shërbimeve prej 16%. Pra në aspektin profesional dhe teknik, edhe këtu pasqyrimi tabelar është i pasaktë dhe mungojnë të dhënat për vitin 2024 dhe 2023.

Shënimi nr.4-shpenzime komunale, tabela paraqet totalin prej 633,600.00€, e këtu për çudi kjo tabelë barazohet matematikisht, por i mungojnë të dhënat paraprake për vitin 2024 dhe 2023.

Te shpenzimet komunale, rrymë, ujë dhe mbeturina, shpenzimet totale janë 633,600.00€, prej tyre 83,000.00€ kanë shkuar për Vendime Gjyqësore, apo 13%, e s rezultat i kësaj kemi pasur mungesë të ndriçimit publik me muaj të tërë në hapësirat publike në qytet e fshatra.

Në shënimin nr.5 kemi subvencionet dhe transferet, edhe këtu tabela është gjysmake, nuk i ka vitet krahasuese, në total i kemi të paraqitura 1,837,845.00€, nga kjo kategori, për Vendimet Gjyqësore janë tërhequr 404,091.00€ ose 22% e buxhetit ka shkuar do të thotë për Vendime Gjyqësore dhe është dëmtuar kategoria e subvencioneve, madje qysh e prezantoj drejtoresha e DBF edhe më i lartë duhet të jetë.

Kemi mandej shënimin nr.6-Shpenzime kapitale, edhe këtu tabela është me të dhëna gjysmake dhe shumë e pasaktë, rreth 7 milionë euro nuk janë të pasqyruara se në cilët zëra buxhetorë janë shpenzuar dhe nuk i ka të dhënat krahasuese për dy vitet paraprake. Nga analiza shihet se shpenzimet kapitale në total janë 9,841,927.00€, prej tyre 2,651,321.00€ ose 27% janë shpenzuar për Vendime Gjyqësore, janë investime kapitale por që janë tërheqë për Vendime Gjyqësore.

Nuk janë të pasqyruara edhe shpenzimet sipas projekteve në të cilat kategori janë shpenzuar këto mjete, shembull kemi Unazën e qytetit në shumë 1.064,000.00€ dhe nuk figuron fare në raport, kjo është vetëm njëra nga projektet e mëdha. Pra, kemi një realizim të ulët në kategorinë e investimeve kapitale prej vetëm 67%, e që 27% janë shpenzuar në Vendime Gjyqësore dhe 6% suficit në këtë kategori e që do të thotë se 33% të shpenzimeve kapitale kanë humbur.

Raporti për të arkëtueshmet, edhe këtu kemi tabela gjysmake për vitin 2024, kurse viti 2023 nuk figuron fare. Është shqetësuese pse nuk inkasohet qiraja komunale në vlerë 1,113,000.00€, a ka ndonjë shpjegim sepse nuk është pasqyruar te shënimet shpjeguese ose shpalosjet. Shqetësuese janë pothuajse të gjithë zërat e pa arkëtuar, tatimi në pronë për vitin 2025 ka qenë 2,962,622.00€, kurse gjendja në fund të vitit 2024 ka qenë 4,592,068.00€, pra diferenca është mbi 1.6 milion euro dhe nuk ka asnjë shpjeguese se çka ka ndodhë.

Te neni 17 janë detyrimet ose faturat e papaguara, shumat e paraqitura në tabelë nuk janë të pasqyruara sipas formatit të aneksit A3, pra nuk janë pasqyruar kujt i keni borxh, së paku për këto borxhet më shumë se 30 ditë është dashur lista me datë të pranimit, emrin e kompanisë, arsyen e mos pagesës, dhe të dhëna tjera që kërkohen në aneks, pra kemi gjithsej fatura të papaguara dhe borxhe në shifrën 1,682,520.00€.

Pastaj kemi nenin 18 që janë detyrimet kontingjente të cilat janë shumë të larta, vetëm te shpenzimet kapitale i keni 2,039,161.00€, kur i shtohen edhe detyrimet e paguara dhe faturat e neni 17 prej 1,682,000.00€, atëherë shuma e detyrimeve kontingjente ju del mbi 3.2 milion euro, e këto borxhe kaq të larta të Komunës janë shqetësuese. Borxhet që janë si detyrime kontingjente pritet të rriten kur t'u shtohen kamatat dhe shpenzimet gjyqësore, që e bëjnë edhe më të lartë borxhin e Komunës.

Neni 21-Raporti për të hyrat vetanake të pashpenzuara është shqetësues, pra tabela paraqet një bilanc për bartje në vitin 2025 prej 1,441,498.00€, pra suficiti nga të hyrat është 1,441,498.00€ nga të hyrat që keni paraqitur, te suficiti nga grandet patët mbi 860 mijë euro, do të thotë në total keni mbi 2 milion euro suficit. Suficiti do të ishte edhe më i lartë po të mos kishin qenë Vendimet Gjyqësore, ndoshta do të kalonte 5 milion euro. Kjo shumë prej afro 2 milionë euro pra shënon tepricën e mbetur pa u shpenzuar, e cila vjen nga të hyrat vetanake dhe grandit qeveritar.

Nga ky raport shihet se nuk keni arritur ta shpenzoni buxhetin e planifikuar dhe ju kanë tepruar mbi 2 milionë euro, pasi që ju nuk jeni duke respektuar asnjë rregull financiare gjatë shpenzimit të buxhetit, më mirë do të ishte që ashtu siç keni vepruar edhe në pagesa të tjera, të zvogëlonit ndonjë borxh, që të mos ju humbin paratë. Në rrafshin ligjor dhe profesional kjo tregon paaftësi për menaxhimin e parasë publike, duke dëmtuar direkt qytetarët, pasi që me 2 milionë euro do të mund të bëheshin shumë punë. Pa u lëshuar në detaje të plota, këto janë vetëm disa nga vërejtjet për këtë raport të pasqyrave financiare të Komunës së Podujevës për vitin 2025.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, edhe unë i kam disa shqetësime por njëkohësisht edhe pyetje që i dua përgjigjet për disa pagesa që mu kanë dukur goxha interesant, dhe këto i kam marrë nga raporti i free balance sepse ky raport që na është sjellë këtu as nuk ka detaje as nuk ka sqarime as nuk i përmbushë kërkesat për raportim.

Pyetja e parë ka të bëjë me veturat me qira, shembull janë 5 fatura që janë marrë vetura me qira, faturat janë me çmim të njëjtë nga 738 € që arrijnë shumën 3690.00€, pyetja do të ishte pse vetura me qira kur e dim që Komuna e Podujevës ka goxha shumë vetura andaj çka ju kanë dashtë ato.

Pyetja e dytë është, dreka, piçe, kafe në shumë 13,666.00€, edhe kjo shumë edhe pse paksa është zvogëluar, nuk po zvogëlohet dhe normale nuk po e di kaq shumë çka po ka nevojë gjithë kjo kafe gjithë kjo piçe pa pikë nevojë të harxhohet.

Pyetja e tretë, që më bëri përshtypje është trajtimi i qenve endacak në shumë 42,109.00€, tani të shikohen pagesat ndër vite, kontratat jepen dhe shkruhet aty që duhet të kastrohen qentë, kurse tani këtu me këtë shumë që unë e kam marrë po i bie që ata po i shumojmë, jo që po i pakojmë, pra qysh po kastrohen kur numri i tyre gjithë është në rritje, po i'u ikin qentë apo çka po bëhet me këtë, duhet të na jepni përgjigjen çka është kah ndodhë këtu.

Tjetra, furnizim me naftë 88,687.00€, këtu nuk përfshihen derivatet për ngrohje por ky furnizim me naftë është më shumë për vetura, dhe kjo është shifër e madhe,

Pastaj tjetra ishte furnizim me inventar 120,438.00€ pagesë, ku po shkon gjithë ky inventar dhe kaq shumë sepse në çdo vit po ka këso goxha shuma të mëdha.

Po ashtu edhe tjetra çështje që është shqetësim janë drunjtë dekorativ, shembull 178,656.00€ janë shpenzuar, e unë hyra e shikova kontratën ku për një dru rrap 86 €, blini 100 € dhe pisha e zezë 110 €, kurse ne kemi parë në shumë vende e njëra prej tyre shembull që ne nuk kemi pasë të drejtë t'i mbjellim është tek Rrethi me Shqiponjë deri te Market "Agnesa" ku janë mbjellë e pastaj janë heqë, ndërsa në Kontratë shkruan që brenda 1 viti operatori duhet t'i plehnoj, t'i ujis, ndërrimi i atyre që nuk janë të mira, kurse atje shumica e tyre kanë dështuar. Unë e di që neve na vyejnë këto gjelbërime, por kjo po dështon, ose po mbjellën jashtë kohës kur është i nxehti i madh dhe nuk po qëndrojnë ose nëse bëhet gjithë shpenzim është dashtë të mirëmbahen, shembull edhe në fshatin ku jetoj unë janë mbjellë goxha shumë disa drunjë por kanë dështuar, shuma e mjeteve financiare është shumë e madhe prandaj është dashtë pasa të mbikëqyren më shumë.

Mandej kemi pikën tjetër që është furnizim me ushqim, kjo pikë është më shumë për Çerdhe dhe nxënës nga klasa e I-rë deri në klasën e V-të, shuma 349,204.00€, këtu nxënësit ose e marrin një kifile një herë në javë ose shpesh herë i marrin të mykura dhe një farë "popkeku" sikur ta binte "AliExpres" fals.

Pika tjetër ishte mirëmbajtja në shumë 891,888.00€, këtu shifra është shumë e madhe por mirëmbajtje nuk po shohim të mirë, pra po shohim se nuk po mirëmbahen e që këtu shembull përfshihet edhe mirëmbajtja e trotuareve ku është goxha një shumë e madhe e mjeteve, mandej ndriçimi publik, mirëmbajtja dimërore dhe verore si dhe mirëmbajtja e kamerave ku është goxha një shumë e madhe e mjeteve buxhetore, unë në fakt nuk po e di cilët trotuare po i mirëmbani,

nëpër fshatra më shumë po i mbulon bari andej kah nuk qarkullojnë njerëz apo që ka më pak qarkullim pra nuk hyhet në ato trotuare si shkak i barit andaj nuk e di çfarë mirëmbajtje është ajo. Pastaj shifra që përsëritet për çdo vite është për shenjzimin vertikal dhe horizontal në 154,416.00€ e që edhe kjo është shumë e madhe.

Gjithashtu edhe te subvencionet i kam dy-tri çështje, disa janë lëshuar me vendim të Kryetarit të Komunës pa thirrje publike siç është shembull për 19 Qershorin - Ditën e Çlirimit të Podujevës (nuk po përmend me emër kujt i janë ndarë sepse nuk ka nevojë), pra janë dy-tri pagesa, njëra 3000€, tjetra 4700€ dhe njëra 1100€. Pastaj janë disa njerëz shembull që kanë përfituar prej subvencioneve e që unë i njoh personalisht kurse atje në Vendimin e Kryetarit i shkruan, shkaku është gjendja e rëndë shëndetësore, nuk po e them se i kam parë dokumentet apo që nuk janë ata persona të sëmurë por mua personalisht më duket se më shëndosh se unë janë (top duken), mirëpo diqysh më shumë për të dal për të bërë propagandë nëpër qytet se sa që janë të sëmurë ata persona, andaj për këto do të doja të marrë përgjigje më shumë prej Kryetarit të Komunës sepse drejtoresha e DSHMS ka ardh vonë dhe nuk e di a e din ajo përse janë bërë këto pagesa.

z.Valdet Restelica, theksoi, para së gjithash duhet ta kemi të qartë se pran vetes e kemi një prej dokumenteve më të rëndësishme që është Raporti vjetor financiar. Ishte shqetësuese edhe fakti se disa prej asambleistëve të LVV-së në fillim pengonin edhe procesin kur shefat e Grupeve ishin duke diskutuar për këtë Raport dhe kjo tregon se me sa seriozitet e marrin shpenzimin e parasë publike. Mënyra qysh është ardh ky raport është e papranueshme, një raport i cili është i pastrukturuar, i vështirë për t'u analizuar dhe totalisht i improvizuar, dhe përveç dobësive teknike është edhe tregues i mungesës së seriozitetit ku lë hapësirë të madhe për dyshim për keq menaxhim dhe mungesë transparence, jo vetëm kaq por ajo që është më shqetësuese është përmbajtja e tij, është alarmante se si është menaxhuar.

Kur hyjmë në detaje përmes sistemit free balance të cilin na e ka dërguar me kohë që na është përgjigjur, del në pah një realitet shumë i hidhur kur sheh pagesa të shumta në kategori të ndryshme por me një model të përsëritur, përfitues të njëjtë, operator të cilët përsëriten shumë, për më tepër, kur i sheh shpenzimet për dreka e darka, për kafe e pije të cilat i përmendi edhe kolegu parafolës, e kupton abuzimin që i bëhet parasë publike, ironia është se jeni ardh në pushtet me thirrje për barazi dhe mbrojtje të buxhetit publik por në praktikë po shohim komplet të kundërtën, shpenzime luksi dhe një qasje që rëndon direkt mbi qytetarët.

Po ndalem edhe shkurtimisht tek pasuritë jo financiare, neni 19 paragrafi 3.1 - Pasuritë kapitale me vlerë mbi 1000 euro, kur kemi një kontradiktë sepse edhe përkundër investimeve gjatë vitit 2025 vlera e pasurisë së infrastrukturës është zvogëluar për 1.5 milion euro, pse, pajisjet mbi 1000 euro janë zvogëluar për 117,000.00€ dhe pasuritë tjera janë zvogëluar për 47,000.00€. mandej neni 19 paragrafi 3.2-Pasuritë e jo kapitale me vlerë nën 1000 euro, shëndetësia në vitin 2024 pasuria nën 1000 euro kishte vlerën 342,754.00€ kurse në vitin 2025 pasuria paraqitet në vlerë 216,431.00€, do të thotë diferenca është negative për shumën prej 126,323.00€, pra ku mbeten këto pajisje.

Po ashtu evitohen edhe shpenzime të mëdha në fushat tjera mbi 800,000.00€ për mirëmbajtjen e rrugëve që është një shumë bukur e madhe sidomos kur e dim se qysh kanë qenë rrugët sidomos gjatë periudhës së dimrit, pastaj për ndriçim publik, dhe diçka që më ka lënë përshtypje ishte një hartim i një projekti apo kontratë në shumë rreth 90,000.00€, do të doja ta di çfarë projekti ka kushtuar kaq shumë, të na shpjegoni më këtë më në detaje.

Si përfundim mendoj se ky raport, nuk është vetëm që është i cektë por është një pasqyrim i një qeverisje lokale e cila nuk jep llogari fare.

znj. Arnisa Sylejmani, theksoi, sot po shqyrtojmë raportin financiar të Komunës së Podujevës për vitin 2025, qysh prej fillimit të mandatit herën e kaluar por edhe tani të këtij mandati të ri është një frazë që është shpesh e përsërisë dhe që kurrë nuk kam marrë përgjigje, e ajo frazë është që ky raport është raporti më i pakuptueshëm dhe më i pakuptimtë sa i përket pjesës financiare në fushën e ekonomisë, madje edhe për dikë që merret me këtë fushë është i pakuptueshëm e lëre më për qytetarët që duan ta dinë se ku po shkojnë paratë e tyre apo paraja publike në përgjithësi.

Sa i përket pagesave të bëra në vitin 2025 dua disa sqarime konkrete, shembull gjatë vitit vërehet se ka pagesa të përsëritura për shërbime të fotokopjes ku do të thotë se ka shuma të ndryshme e që realisht nuk janë shuma të vogla andaj dua ta di çfarë shërbimesh konkrete janë realizuar me këto pagesa që paraqiten në free balance. Së dyti sa i përket shërbimeve të sigurimit e automjeteve. Sistemit të GPS dua të di se a ka Komuna kontrata të rregullta kur i merre këto shërbime apo vetëm bënë ashtu pagesa në forma të ndara, dhe me qenë se jam te automjetet pa qare më duhet të ndërlihem te pjesa që e ceku edhe kolegu parafolës z. Ekrem Rrahmani ku në njërin anë kemi shpenzime të vazhdueshme për servisime, karburante, mirëmbajtje e që është krejt në rregull sepse për çdo veturë kërkohen ato mirëpo në anën tjetër shohim se kemi marrje të veturave me qira për disa muaj rresht e sikur për ironi këta muaj përkojnë me muajin që kemi qenë në fushatë zgjedhore, do të thotë gushat, shtator, tetor, nëntor e që kanë qenë muaj të fushatës, andaj dua të më sqaroni mënyrën se qysh organizohet dhe menaxhohet pjesa e veturave të Komunës.

Gjithashtu këtu në raport na paraqitet edhe një pagesë në shumë rreth 23,000.00€ për furnizim me kompjuter, andaj veç si pyetje po më intereson të di se çka është furnizuar me këtë shumë dhe çfarë nevojë konkrete është realizuar me këto shpenzime.

Në përgjithësi kjo çka po paraqitet në raport mendoj që na e krijon një përshtypje se kemi fokus të theksuar në shpenzime e jo në investime.

z. Ermal Osmani, theksoi, sa i përket raportit financiar 2025 duke analizuar raportin financiar e veçanërisht pasqyrat financiare në sektorin e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural konstatojmë parregullsi serioze dhe indikacione për manipulime në disa segmente kyçe përfshirë mekanizëm bujqësorë dhe dhënien e tenderëve në këtë Drejtori, në veçanti te mekanizmi bujqësorë siç janë multikultivatorët me frezë ku vërehen çmime të larta në tenderim krahasuar me tregun e kultivatorëve, shembull i njëjti kultivator me të njëjtën fuçi motorike 8h që e keni bërë shumë herë shpërndarjen e kultivatorëve, në tenderim e keni paguar me një frezë 850 euro ndërsa i njëjti kultivator në treg, mund ta marrim edhe profakturën dhe ta shikojmë, i njëjti prodhues sepse këta janë prodhim indian, kushton 450€, pra diferenca për një kultivator mes tenderimit dhe tregut është 400 euro. Një situatë e ngjashme është paraqitur edhe te serat ku dihet qartë kostoja reale e një sere kurse ju si Komunë në këto vite keni shpërndarë serat gjysmë ari apo 50 m² ose 5 ari ose 500 m², çmimi në tenderim për një gjysmë ari serë është 1,170.00€ ndërsa në treg e njëjta serë është 800.00€ me të njëjtin kapacitet me të njëjta shufra dhe me gjitha çka keni shtuar bazament me beton e gjëra tjera, (4 kacia beton asgjë hiq), e po ashtu edhe te serat 5 ari i njëjti rast është ku 8,295.00€ ka kushtuar në tenderim një serë 5 ha kurse në treg është 6,800.00€, pra të krahasohet sera gjysmë ari me atë 5 ha janë 10 sera gjysmë ari në 5 ari, po të llogaritet në përqindje edhe këtu del mbi 3000 euro diferencë, këtu unë nuk po di se çka keni dashtë të bëni por vetëm mendoj se kjo përbënë një shkëlqje të rëndë të menaxhimit të parasë publike dhe ngreh dyshime serioze për keqpërdorim të detyrës zyrtare, andaj për këtë arsye bëjë thirrje nga organet kompetente veçanërisht Prokuroria të merret me këtë çështje dhe të inicioj hetimin mbi këto tenderë.

Së dyti edhe një problematikë është edhe çështja e ndarjes së subvencioneve, ne e dim dhe i njohim fermerët Llapjan kush punon dhe merret me bujqësi, unë jam për të dhënë subvencione edhe më shumë dhe të shtohet buxheti për subvencione, të jepen subvencione të ndryshme dhe t'i

përkrahim fermerët, por kemi raste ku janë familje me 3, 4, 5 anëtar që i kemi shikuar dhe kemi gjet që e njëjta familje hap 5 NIF dhe vie e konkurren dhe përfiton për çdo vit, e që në Rregullore shkruan se duhet t'iu jepet përparësi atyre që nuk kanë qenë përfitues të paktën 3 vitet e fundit, mandej ka që merr e njëjta familje për çdo vit, përfiton për çdo vit, madje edhe në dy thirrje, andaj kërkoj nga institucionet përgjegjëse që të ndër marrin masa konkrete për ndalimin e këtyre abuzimeve në mënyrë që të siguroj shpërndarje të drejtë dhe transparente të fondeve publike.

znj. Qëndresë Hajrizi, theksoi, sot po diskutojmë raportin vjetor financiar i cili është një dokument i rëndësishëm për transparencë dhe llogaridhënie institucionale. Është e kuptueshme që raporti mund të shoqërohet me kritika por është po aq e rëndësishme që vlerësimi të bëhet në mënyrë objektive duke parë edhe arritjet dhe rrethanat reale gjatë vitit raportues.

Sa i përket dallimit mes planifikimit dhe realizmit duhet theksuar se këto janë të zakonshme në procesin buxhetor pasi që realizmi ndikohet nga dinamika e inkasimit të të hyrave të cilat nuk mund të parashihen me saktësi në fillim të vitit, procedurat e prokurimit si dhe faktorët objektiv gjatë vitit fiskal. Po ashtu lëvizjet buxhetore kanë ndodhur për shkak të obligimeve të reja që janë paraqitur përgjatë vitit e në veçanti zbatimi i Kontratës Kolektive si dhe nevojat shtesë operative të cilat Komuna ka qenë e detyruar të bëjë rishpërndarje të mjeteve, andaj këto dallime nuk nënkuptojnë domosdoshmërisht menaxhim të dobët por reflektojnë rrethana reale të zbatimit të buxhetit. Natyrisht ka hapësirë edhe për përmirësim në planifikim të buxhetit por megjithatë këto janë çështje që duhet të adresohen përmes rekomandimeve dhe përmirësimit të vazhdueshëm dhe jo arsye për ta konsideruar raportin si negativ.

Në përfundim, raporti vjetor financiar paraqet një pasqyrë reale të punës gjatë vitit me arritje konkrete, rritje të investimeve, menaxhim të qëndrueshëm financiar, prandaj për këto arsye konsideroj se raporti është i balancuar, real dhe i pranueshëm.

z. Demokrat Hodolli, theksoi, unë nuk deshta të shtoj shumë, do të thotë po foli në atë zhargonin popullor, këtu është bërë shprehi dhe është bërë zakon veç hajt të foli diçka se duhet të foli dhe çka është më e keqja kush nuk shoh bardh por veç zi, e unë e kam këtë kritikë ndaj këtyre njerëzve se është mirë me fol edhe bardh. Raporti financiar i Komunës së Podujevës tregon një storie suksesi sepse për të fol për raportin financiar po besoj se në atë drejtim duhet të njihet drejtimi financiar.

Pse është storie e suksesit Komuna e Podujevës, është sepse ka projekte konkrete, ka investime që shihen në terren, ka punë që nuk mundet askush t'i mohoj, por nuk po e them unë se është gjithçka perfektë por është shumë larg asaj që shumë prej këtyre shohin veç zi, do të thotë se është burri me fol edhe mirë edhe me fol për konkretet për punën e mirë që është bërë në Komunën tonë.

z. Isak Ejupi, theksoi, me vëmendje e kam shqyrtuar raportin financiar dhe një shqetësim që dua të ndaj me ju e që po besoj se shumë herë e keni trajtuar në këtë Kuvend dhe që nuk ka marrë asnjë përgjigje respektivisht është planifikuar një buxhet e që fjala është për Lumi Llap i cili po vazhdon të degradohet skajshmërisht e që unë e konsideroj se Lumi Llap është pasuri Kombëtare dhe qasja në menaxhim, me mirëmbajtje dhe investime që duhet të bëhen në këtë Lum janë të interesit nacional. Përkundër kësaj, në vitin e kaluar edhe pse janë planifikuar disa investime gjendja në terren nuk ka ndryshuar aspak, do të thotë Lumi Llap vazhdon të degradohet në radhë të parë nga vet Komuna e Podujevës sepse i ka qitë të gjitha fekalet ose kanalizimet jashtë qytetit dhe atje pastaj rrjedha e Lumit po vazhdon t'i infektoj qytetarët dhe rrjedhimisht po e rrezikon edhe shëndetin e qytetarëve përmes insekteve të shumta që janë në rrjedhën e Lumit i cili realisht po degradohet vazhdimisht.

Po ashtu janë edhe disa faktorë tjerë që ju e dini fare mirë, njëri prej tyre është një operator ekonomik i cili e ka një fermë atje me mbi 100 krerë lop dhe të gjitha ato fekalet nga ajo fermë i hudh në Lum, disa herë jemi ankuar, dhe këtë e them në emër të banorëve të fshatit Sekiraqë por

edhe banorët tjerë të rrjedhës së Lumit e kanë të njëjtën ankesë kështu që ato investime unë nuk kam parë që e kanë ndryshuar gjendjen në terren, ku kanë përfunduar ato mjete të planifikuara unë nuk e di sepse nuk ka ndonjë arsytim konkret por si do qoftë ajo që unë po kërkoj është që ne në raport me Lumin Llap bashkërisht pa asnjë ndryshim dhe pa asnjë dallim të gjithë të fokusohemi që Lumin Llap ta ruajmë sepse në të kallurën unë atje kam zënë peshq deri mbi 3 kg ndërkaq sot nuk ka asnjë gjallesë dhe se ekosistemi në Lumin Llap nuk ekziston, do të thotë vërtetë është e dhimbshme kur unë e di se çfarë pastërtie ka qenë në atë Lum ku edhe ujë kemi pirë, ndërkohë që sot aty ka vetëm fekale dhe gjatë verës jeta në atë pjesë në afërsi të Lumit Llap është e padurueshme nga kundërmimi i kanalizimeve dhe i këtyre dëmeve.

Pastaj ka edhe shumë mbeturina inerte që hedhen në Lum dhe nuk e di sak nëse eventualisht Inspeksioni ka zhvilluar ndonjë hap në atë pjesë bashkërisht edhe me organet e sigurisë në mënyrë që secilit qytetarë që jeton në afërsi të Lumit Llap t'i bëhet me dije se e konsumon një vepër penale nëse e ndotë Lumin Llap në ato përmasa.

Pra kërkoj që investimet që janë planifikuar për vitin 2026 që i përket Lumit Llap të materializohen dhe gjendja e Lumit Llap të ndryshoj për të mirë.

znj.Luljeta Muçolli-Azemi, theksoi, deshta të ndërlidhem pakëz me kolegët që thanë se në vitin 2025 ka rritje të çmimeve, ka rritje të shpenzimeve, është e vërtetë që ka rritje të shpenzimeve për shkak të rritjeve të çmimeve. Mund të them se për 20 vite sa ka udhëheqë LDK nuk është punuar sa është punuar për një mandat nga udhëheqja e LVV-së. Në Podujevë është punuar jashtëzakonisht, kah do që e kthen kokën vëren ndryshime dhe këto ndryshime janë vetëm për të mirë e normale që këto ndryshime kanë edhe koston e tyre, kërkesat dhe nevojat janë dhe kanë me qenë sa të ekziston njerëzimi, madje ne edhe sot në familjet tona por ndalemi dhe t'i pyesim anëtarët e familjes çfarë nevojash keni ose çfarë kërkesash keni, është e pamundur që t'i plotësojmë të gjitha, mirëpo në përgjithësi i ka jap prioritet projekteve të cilat kanë ndikuar në zhvillimin ekonomik, rritjen e numrit të punëtorëve dhe lehtësimin e jetës së qytetarëve.

znj.Gresa Qosa-Maqastena, theksoi, fillimisht deshta të kthej një përgjigje për kolegët asambleistë të cilët po thirren në përgjithësi, po flasin për ato që janë punuar në qytet dhe ato shihen është e qartë, pra këta po flasin në të përgjithshmen por ne jemi duke fol konkretisht për raportin financiar i cili na është dërguar, ndërsa kolegë të nderuar ju lutem shikoni të dhënat që i keni në raport financiar edhe nëse mund të gjeni dallimin ku ka parregullsi dhe gjëra të tilla.

Çështja tjetër, parafolësi z.Haki Rudari e tha se nuk fol pa pasur qetësi, ndërsa unë duke pasë parasysh që vije prej fushës së arsimit dhe e kemi nderin që edhe Kryetarin e Komunës e kemi Profesor Universitar, nuk e di i nderuar profesor në çfarë mënyrë e ke nënshkruar fillimisht këtë raport financiar i cili ka jashtëzakonisht gabime drejtshkrimore dhe kjo neve si profesionist na pengon shumë “na e vranë syrin”. Gjithashtu raporti financiar si duket nga viti në vite vetëm është përcjellë dhe nuk ka detaje, por ka mangësi shumë të mëdha të cilat nuk pasqyrohen të vitit 2023, 2024 e kështu me radhë.

Meqë vije prej fushës së arsimit, këtu përveç drejtoreshës së Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave dhe Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, buxheti tregon se keni planifikuar ndërsa raporti tregon se një pjesë shumicë ka mbetur në stoqe, do të thotë mallrat që ju e dini se nuk janë shpenzuar. Dallimi i vitit 2024 dhe vitit 2025 përafërsisht është 43,000.00€ që është, rritur, do të thotë këto mallra e thash edhe njëherë se janë paraqitur në buxhet por nuk figurojnë te raporti financiar.

Gjithashtu për vitin 2024, që ta tërheqim në diagonale, shuma pak ka rritje të buxhetit në mjekësi e që ish dashtë të ishte shembull higjiena më e lartë se sa në arsim i nderuar drejtor, kurse në këtë a ka keqpërdorime ju duhet ta diskutoni, pastaj a keni shpenzuar vetëm në administratë dhe në arsim vetëm për higjienë apo edhe për gjëra të tilla sepse e dim se në shkolla ka shumë papastërti dhe

gjithashtu për ta tërheqë një diagonale, edhe pse po bëhet shumë zhurmë e që nuk e di a po bëhet kjo qëllimisht për ta tërheqë vëmendjen sa i përket raportit financiar apo po bëhet me qëllim e që kjo gjendje fillimisht nuk është respekt as për Kryetarin e Komunës e as për të tjerët por edhe për neve folësit, do të thotë i nderuar drejtor i DKA-së 43,000.00€ e keni raportin shumë e cila në vitin 2025 është më e madhe ndërsa sot shkollat tona ballafaqohen edhe me irritim të lëkurës e gjëra të tilla për shkak të mungesës së higjienës, konkretisht kemi shkollën “Naim Frashëri” ku shembull kohëve të fundit ka një alergji nëpër duar ose një alergji dermatologjike e që vije sigurisht kjo prej mungesës së higjienës dhe gjëra të tilla, prandaj a mund të na tregoni përfaqësisht përse janë rritë këto shuma buxhetore, por që kohëve të fundit nuk ka as shujta dhe gjëra të tilla.

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, në cilësinë e anëtarit të Kuvendit, theksoi, raportimi financiar nuk është vetëm një deklaram ligjor por ai është pasqyra më e qartë e mënyrës se si një institucion i`u shërben qytetarëve të vet, përmes këtij matet jo vetëm shpenzimi i parasë publike por edhe niveli i transparencës dhe përgjegjësisë sonë. Unë nuk kam qenë në mandatin e kaluar pjesë e Kuvendit, por kam pas rastin të lexoj raportin financiar janar - shtator 2025 dhe kam vërejtur një dallim të dukshëm ndërmjet raportit financiar për periudhën janar - shtator 2025 dhe raportit financiar vjetor për vitin 2025. Pra raporti i periudhës janar-shtator 2025 karakterizohet me një strukturë më të detajuar dhe më të qartë, ai ofron zberthim sipas kategorive, kodeve dhe programeve duke dhënë mundësinë secilit prej neve të të kuptoj më lehtë rrjedhën dhe destinimin e mjeteve buxhetore, ndërsa raporti vjetor i cili në natyrë do të duhej të ishte më gjithëpërfshirës paraqitet më i përgjithësuar, kjo nuk e zbehtë vlerën e tij si dokument financiar por e kufizon në një masë të caktuar mundësinë për një analizë më të thellë dhe më të sakt.

Përveç aspektit përmbajtësorë do të ndalem edhe te një element teknik por mjaft i rëndësishëm për punën tonë si Kuvend, raporti në fjalë është i përgatitur me shkronja shumë të imta dhe me një paraqitje ku në shumë raste shifrat dhe tekstet janë vështirë të lexuara, kjo në dukje duket si një çështje e vogël por në fakt ndikon drejtpërsëdrejti në cilësinë e shqyrtimit tonë sepse kur dokumenti nuk është i lexueshëm lehtësisht kufizohet mundësia për një analizë të qartë, për diskutim substancial dhe për një debat të mirëfilltë në këtë Kuvend.

Të ndërtuar kolegë, shohë si një kontribut për përmirësimin e mëtutjeshëm dhe frymën e bashkëpunimit dhe mbështetjen institucionale sepse në fund të ditës të gjithë kemi të njëjtin qëllim që raportet tona të jenë jo vetëm të sakta por edhe të qarta, të detajuara dhe lehtësisht të kuptueshme për çdo qytetarë. Një raport i mirë financiar nuk është që të hapësirë për paqartësi, ai fol vet, tregon qartë se ku janë orientuar mjetet, cilët sektorë kanë përfituar dhe çfarë efekti kanë arritur, për këtë arsye besoj që në raportet e ardhshme duhet të shënoj një standard më i avancuar duke përfshirë zberthimin më të plotë sipas Drejtorive, ndarjen e detajuar sipas programeve dhe një paraqitje e thelluar sipas kodeve buxhetore, kjo do ta bëjë raportin jo vetëm një dokument formal por një instrument real dhe vendimmarrës për mbikëqyrje dhe informim publik, andaj në këtë drejtim jam i bindur se me përkushtim dhe bashkëpunim raportimet e ardhshme do të jenë edhe më të përkryera dhe në përputhje të plotë me standardet që synojmë si Institucion.

z.Bahri Selimi, U.D. drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSH, theksoi, po mundohem të jap përgjigje në disa prej pyetjeve që u bënë nga një numër i parafolësve asambleistë e që ndërlidhen me DSHPMSH e cila është kompetencë direkte e imja.

Për çudi u fol për trajtimin e qenve endacak, po e them për çudi sepse po thuajse në secilën seancë këtu diskutohet për këtë temë dhe ankoheni secili prej juve pse ka shumë qen endacak në rrugë, ,pse nuk po trajtohen qentë endacak kurse sot për çudi u tha e kundërta duke thënë se është shpenzuar shumë për trajtim të qenve endacak në shumë rreth 40,000.00€, dua të them se jo që nuk janë shumë por nuk janë të mjaftueshme por në pamundësi që ta ngrisim këtë buxhet përfshirë

edhe kategoritë tjera buxhetore ne në çdo vit po mundohemi me një shumë prej 30,000.00€ deri në 40,000.00€ të lidhim kontrata për trajtimin e qenve endacak. E kam sqaruar shumë herë këtu se çka përfshinë ajo kontratë e cila është publike dhe besoj e keni parë të gjithë dhe e dini se çka përfshihet në atë kontratë. Tani trajtimi i të gjithë qenve endacak besoj që edhe këtë duhet ta dini se është e pamundshme sepse nuk mund të gjithë qentë endacak njëkohësisht të trajtohen, por unë e di që këtu ngapak bëhet politikë dhe folët politikisht, por realisht realiteti duhet të vlerësohet pak më shumë se politika në këtë rast.

Në Komunën e Podujevës, në bazë të matjeve të fundit në bashkëpunim me një Organizatë Holandeze ka dalë se qarkullojnë rreth 2500 deri në 3000 qenë të cilët kryesisht janë endacak, do të thotë prej atyre 25000-30000 qenve mund të llogaritni sa mund të kushtoj një trajtim njëkohësisht i qenve edhe a kish qenë mundësia të bëhet një gjë e tillë, do të thotë nuk është ajo mundësi, por këto kontrata që ne i bëjmë 200 deri në 300 qen endacak trajtohen në vit me këtë buxhet që kemi për çdo vit për trajtimin e qenve endacak.

U fol për drunjë dekorativ, është zotim i joni dhe besoj që edhe ju pajtoheni që Komuna e Podujevës ka shumë pak gjelbërim dhe jemi përkushtuar që sa më shumë ta bëjmë gjelbërimin e qytetit, pjesës urbane në veçanti por edhe fshatrave, e dini që janë mbjellë shumë drunjë dekorativ, nuk po e them se të gjithë janë në gjendje të mirë sepse ka drunjë të cilët janë tharë por ajo varet edhe prej natyrës edhe prej vendit, koha kur janë mbjellë ata nuk qëndron se nuk janë mbjellë në kohë të përshtatshme sepse ne edhe nëse lidhim kontratë më herët gjithëherë mbjelljen e bëjmë në kohën e duhur kur duhet të mbjellën. Çdo operator ekonomik që e ka marrë kontratën e ka 1 vit mirëmbajtjen e tyre, ujitjen, krasitjen, prashitjen e drunjëve, mirëpo për segment që u cek nga rrethrotullimi me Shqiponjë deri te rrethrotullimi “Te Qershijat e Llapashticës” që janë mbjellë njëherë dhe janë larguar prej aty, po është shumë e vërtetë por nen i kemi mbjellë aty duke pasë parasysh se ajo pjesë qëndron shumë pak e gjerbëruar mirëpo pastaj ka ndërruar një projekt në Ministrinë përkatëse ku është futur renovimi (Loti 5) edhe kësaj pjese të magjistrales, pra nuk ka qenë i paraparë ndriçimi publik në atë pjesë kurse tani është paraparë ndriçimi publik që të bëhet në atë pjesë të rrugës andaj ne për shkak të hapësirës së vogël aty është dashtë që t’i zhvendosim ata drunjë dhe t’i mbjellim në vende tjera ku ka pas nevojë, prandaj ta keni të qartë se aty është bërë zhvendosja ku ata drunjë janë heq nga aty dhe janë, vendos diku tjetër.

Më bëri shumë përshtypje dhe j’u duk vlerë shumë e madhe shuma rreth 800,000.00€ për mirëmbajtje që janë shpenzuar në vitin 2025, nuk e di a keni të qartë dhe a keni të shkruar se çka nënkupton mirëmbajtja dhe çka mirëmbahet me atë buxhet që është harxhuar për mirëmbajtje brenda vitit. Pra ka të bëjë me mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve dhe unë vetëm sa për statistikë po them se në Komunën e Podujevës janë diku rreth 1140 km gjatësi rrugë e prej këtyre janë rreth 900 km rrugë të asfaltuara, pa i llogaritur edhe rrugët me kubza, rrugët me zhavorr dhe rrugët të cilat janë të pakalueshme që edhe ato duhet të mirëmbahen nga njëherë sepse shpeshherë duhet të intervenohet për t’jua bërë të qasshme banorëve rrugën qoftë për pronat e tyre qoftë për shkaqe tjera që ata i kërkojnë. Në kuadër të këtyre hyn edhe mirëmbajtja e ndriçimit publik që e kemi cekë disa herë, dhe tani në Komunën tonë prej 900 km rrugë të asfaltuara 380 km janë rrugë të ndriçuara e që për çdo ditë prej banorëve, bashkëfshatarëve tuaj por edhe vet prej juve si anëtar të Kuvendit vijnë kërkesa se ndriçimi publik nuk po punon, andaj është më se e nevojshme që ai ndriçim të mirëmbahet sepse nuk është vendos aty për të mbete i fikur por duhet të jetë funksional, dhe përkundër shumë kërkesave besoj që po përkushtohemi shumë ta mirëmbajmë ndriçimin publik por për shkak të numrit të madh dhe të kilometrave të shumë nganjëherë po kemi edhe vështirësi ta mirëmbajmë ndriçimin publik. Mandej edhe mirëmbajtja e trotuareve, do të thotë të gjitha këto që i përmenda janë kërkesa të juaja që vijnë, shembull një gropë apo ndonjë prerje që

është bërë prej KEDS, Ujësjiellit ose prej vet Komunës për ndonjë ndërhyrje menjëherë aty për aty vie kërkesa përse trotuari i prishur, normale që aty duhet të rregullohet prandaj me këto mjete rregullohen edhe trotuaret.

Mirëmbajtja e hapësirave publike, Komuna e Podujevës ka 630 km² dhe është prej Komunave më të mëdha, për këtë ka edhe rrugë e trotuare më së shumti por ka edhe hapësira publike të cilat mirëmbahen e mbahen e që besoj që te mirëmbajtja unë e di që pajtoheni edhe ju edhe pse keni kritika, por asnjëherë më mirë deri tani nuk ka qenë mirëmbajtja qoftë e pjesës urbane qoftë edhe rrugëve rurale të cilat janë brenda territorit të Komunës tonë.

Po ashtu u përmend edhe mirëmbajtja e lumenjve, për çdo vite lidhen kontrata për mirëmbajtjen e lumenjve, dhe është punuar shumë në lumenj, janë hapë shumë lumenjtë, nuk kemi mundur t'i ndalim ende mbeturinat që të mos hudhen në lumenj, nuk kemi mundur ende ta ndalim kanalizimin që të derdhet në lumenj, mirëpo edhe këtë e dini se jemi duke punuar në këto dy drejtime, do të thotë, për ujërat e zeza jemi duke punuar në kolektorin e ujërave të zeza edhe tani aktualisht kur po diskutojmë e që në seancën e parë të Kuvendit të Kosovës do të miratohet edhe buxheti për impiantin e ujërave të zeza i cili së shpejti do të filloj punën dhe do të pastrohen lumenjtë, pra të enjten është caktuar seanca e Kuvendit të Kosovës dhe në atë seancë pikë e rendit të ditës është edhe miratimi i kredisë për impiantin e ujërave të zeza për Komunën e Podujevës si një prej projekteve të mëdha për pastrimin e lumenjve, kurse në anën tjetër jemi duke e bërë një projekt për pastrimin e lumenjve i cili del të jetë në vlera shumë të mëdha e që nuk e di qysh do të mund t'ia bëjmë së bashku me ju dhe në fund ndoshta do të thoni se buxheti është shumë i madh dhe që është shpenzuar shumë në, rregullimin e shtretërve të lumenjve, por jemi në pritje të projektit i cili sillet diku rreth 8 milion euro që presim të fillohet me rregullimin e shtretërve të lumenjve ku do të pastrohen pastaj edhe prej ujërave të zeza edhe prej mbeturinave.

Shenjzimi vertikal dhe horizontal për çudi 170,000.00€ ju duken shumë kur që dy vite një kontratë është, pra dy vite me një kontratë jemi duke punuar sa i përket shenjzimit që ka qenë rreth 154,000.00€, pra në 2023 dhe në 2024 është kontrata e njëjtë që po punohet me atë punë dhe është ende e lidhur që do të shpenzohen disa mjete buxhetore edhe këtë vit, andaj ju e dini sa është e rëndësishme dhe e nevojshme sinjalistika në rrugët tona ku për secilin aksident që ndodh Policia na kërkon përgjegjësi neve nëse aty ka munguar një shenjë e komunikacionit apo një vijë horizontale e komunikacionit, prandaj u befasova kur dëgjova që shuma 800,000.00€ është e lartë për mirëmbajtje kur asnjëherë nuk ndalet goja këtu duke fol dhe duke kërkuar për mirëmbajtje secilën hapësirë ku shihet një mbeturinë, sepse këtu nuk e përmenda as largimin e mbeturinave ilegale dhe shumë mirëmbajtje të tjera, por unë besoj që ju e nënkuptoni se gjithçka çka shihet me sy kërkon mirëmbajtje, madje edhe unë u befasova që shuma qenka goxha e vogël sepse nuk merrem shumë me shuma buxhetore sa kushtojnë e të ngjashme por unë merrem me projekte dhe me punë në terren mirëpo mu duk se goxha e arsyeshme ishte kjo shumë i nderuar zotëri Ekrem.

znj.Lirie Hoti-Rama, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS, theksoi, fillimisht me lejoni që t'ju falënderoj secilit nga ju për kontributin e juaj në debat dhe në pikat e ngritura. Më lejoni t'i përgjigjem kolegut z.Ekrem Rrahmani lidhur me pikën për të cilën e ngriti e që ka të bëjë edhe me DSHMS, vendimet të cilat lëshohen nga Kryetari i Komunës për ndihmë me mjete financiare për personat me sëmundje të rënda shëndetësore, këto vendime lëshohen me një rekomandim i cili bëhet nga komisioni i cili është i ngritur për vlerësimin e këtyre kërkesave, pra kërkesat i dorëzojnë vetë këta persona të cilët kanë nevojë për ndihmë financiare dhe pjesë e kërkesës së tyre janë edhe raportet që e konstatojnë diagnozën e sëmundjes së tyre, kështu që komisioni i vlerëson në bazë të këtyre raporteve dhe i dërgon rekomandim Kryetarit për lëshimin e mjeteve për këta persona.

Me lejen e drejtorit të Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural i përgjigjem edhe kolegut z.Ermal Osmani, meqenëse se në periudhën për të cilën po flasim kam qenë unë në udhëheqje të kësaj Drejtorie, lidhur me çështjen e ngritur për çmimet e kontratave sipas tenderëve, ju informoj që çmimet nuk përcaktohen nga Drejtoria përkatëse, mirëpo këto janë procedura që ndiqen përmes prokurimit, pra janë procedura publike, nga Drejtoria dërgohet vetëm kërkesa për inicim të procedurave dhe këto çmime caktohen në bazë të ofertave e që sipas Ligjit të prokurimit e di që kontraktohen ofertat më të lira të cilat ofrohen, kështu që kjo nuk varet aspak nga ne, ndërsa sa i përket specifikave të Serave ato punohen nga zyrtarët përkatës të fushave të cilët marrin përgjegjësi për specifikat që ata i shkruajnë. Sa për plotësimin e juaj DBPZHR vitin e kaluar ka pas të hapur ftesën për Serra jo vetëm të madhësisë 50 m² dhe 500 m² por edhe Serra të madhësisë 1000 m², kështu që specifikat janë të përcaktuara nga zyrtarët përkatës të fushave ku ata i'a bashkëngjitin edhe një deklaratë të betimit me të cilën marrin përgjegjësi për specifikat që ata i shkruajnë. Po ashtu sa i përket pikës së ngritur për përfituesit në projekte të ndryshme të subvencionimit në këtë Drejtori sigurisht vlen ajo që e përmendet ju si përparësi kanë ata që nuk kanë përfituar në 3 vitet e fundit, ndërsa me Rregulloren për subvencionim shkruan se nuk ka të drejtë të jetë një përfitues më shumë se një herë brenda atij vitit, e di që kjo respektohet nga komisioni vlerësues për secilin projekt, pra janë ata që e mbajnë përgjegjësin dhe të cilët janë të gatshëm edhe t'ju përgjigjen nëse eventualisht keni ndonjë kërkesë me shkrim për ndonjë rast specifik e që ne kemi hasur në një rast të tillë dhe përveç në vitin e kaluar kemi hasur në dy ose tri raste ku të tilla ku janë larguar nga deklaratat e bashkësisë familjare e që ne nuk mund t'i përcjellim të gjithë sepse në sistem ajo nuk deklarohet dhe në afatin e ankesave prej 5 dit ku konkretisht e kemi pasur një rast në fshatin Dobërdol që dy përfitues të një projekti kanë qenë vëllezër dhe komisioni ka dalë dhe ka konstatuar e pastaj janë larguar brenda afatit të ankesave, kështu që nuk ka asgjë të keqe që ju nëse jeni në dijeni të ndonjë rasti të kontribuoni.

Edhe kolegët tjerë që kanë qenë pjesë e mandatit të kaluar e din që kam qenë e hapur gjithmonë për të raportuar para jush, mirëpo edhe për t'ju përgjigjur çdo pyetje që e parashtroni, kështu që ju falënderoj shumë për pyetjet, mirëpo mund të ketë ndonjë gjë për të shtuar në vazhdim edhe Kryetari i Komunës apo Drejtori i DBPZHR.

znj.Valbona Ibishi-Azemi, U.D drejtoresh e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS, theksoi, edhe pse në cilësinë e Drejtoreshës së Kulturës Rinisë dhe Sportit, deshta që të përgjigjem në disa pyetje të cilët u shtruan nga z.Ekrem Rrahmani rreth funksionalizimit dhe shërbimeve të cilat kryhen në kuadër të Autoparkut, meqenëse pyetja ishte për vitin 2025 dhe kam qenë unë ajo që e kam menaxhuar direkt atë. Sa i përket veturave me qira është e vërtetë që i kemi marr dy vetura me qira dhe për këtë duhet të jemi krenar edhe ne por edhe ju sepse e ka lehtësuar shumë punën dhe njëkohësisht e ka rritur efikasitetin e Autoparkut dhe kjo i ka ulur shpenzimet e veturave sepse ne e dimë që kemi një flotë të veturave të stërvjetruara dhe kjo i ka rritur shpenzimet e veturave të Autoparkut për mirëmbajtje dhe për derivate, Pra këto dy vetura janë marr me plotë të drejtë dhe besoj që kanë kryer shërbime shumë të mira dhe e kanë rritur efikasitetin e Autoparkut, ndërsa sa i përket fushatës që u theksua nga ju që janë marr në kohë fushate, atë nuk mund ta dokumentoni në asnjë rast sepse e ndërlihet me GPS dhe lëvizja e tyre çdo herë përgjohet dhe në asnjë rast nuk mund të argumentoni që këto vetura janë përdorur në kohë fushate.

Sa i përket pyetjes rreth GPS, dua të them se ka qenë shumë nevojë për funksionalizimin dhe menaxhimin e veturave dhe kemi kontratë dy vjeçare për këtë dhe e cila menaxhohet detajisht nga Drejtoria e Administratës, pra secila veturë. Asnjë prej veturave nuk ka qenë e përdorur në mënyrë private apo në kuadër të fushatës, nuk mund ta argumentoni asnjë prej jush sepse nuk kanë qenë të përfshira asnjë veturë e Autoparkut por të gjitha janë shfrytëzuar për nevoja të institucionit dhe ju e

dini shumë mirë që të gjitha këto projekte që janë bërë janë punë të cilat duhet të dalim në teren dhe çdo shpenzim që është bërë sa i përket Autoparkut është i raportuar dhe është i evidentuar.

z.Avni Fetahu, U.D. drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, theksoi, unë po ndërlihem fillimisht te dy mësimdhënësit parafolës profesori i respektuar zotëri Restelica dhe profesoresha zonja Qosa, dy termet që u përmenden, abuzimi i buxhetit dhe keqpërdorimi, si mësimdhënës do të ishte mirë që fillimisht t'i analizoni këto terme për arsye se çdo projekt që është realizuar në Komunën e Podujevës i ka disa faza, faza e parë është inicimi i procedurës së një projekti që nënkupton se këta zyrtarë që i keni lënë ju këtu e që punojnë në Komunë i hartojnë specifikat dhe niset një projekt, pastaj ai projekt e ka një menaxher dhe ka një mbikëqyrës si dhe ka një komision prej 3 anëtarëve që e pranojnë atë punë, pas kësaj janë edhe nja 10 persona që kalon një pagesë e caktuar, përkatësisht janë nja 20 sy që e shikojnë atë procedurë të realizimit të pagesës, e mbi të gjitha është edhe certifikuesi por edhe ekzekutuesi i pagesave.

Po ashtu ju e dini se gjatë këtyre gjashtë viteve ka pas shumë herë që këto lëndë i keni dërguar edhe nëpër organe të caktuara të shtetit edhe sot e gjashtë vite Komuna e Podujevës nuk e ka asnjë aferë korruptive.

Pra këto projekte janë zhvilluar në mënyrën e duhur, me transparencë dhe llogaridhënie edhe ashtu qysh e kërkon ligji. Krejt në fund, në vitin 2025 janë realizuar shumë projekte të mëdha por që qytetarët i kanë prekur këto projekte si në shëndetësi, arsim, infrastrukturë, përmirësim të kushteve të jetesës, dhe krejt këto projekte që u potencuan prej drejtoreshës së Drejtorisë së buxhetit dhe Financave normale që prej qiellit nuk kanë ardhur mirëpo duke punuar duke u angazhuar, duke u munduar edhe me Memorandume Kryetari i Komunës së bashku me Ekzekutivin e Komunës, duke sjellë projekte të mira qytetarëve, ndërsa a ka hapësirë për përmirësim natyrisht se po për arsye se i kemi 57 objekte mësimore me 652 klasë e me 182 banjo/tualete që janë ka nevojë për hapësirë, ka nevojë edhe për ngritje të buxhetit që t'i kem edhe më të pastërta edhe më të mira, mirëpo e dini që disa shkolla i kemi gjet të trashëguara, madje e dini që shkollën "Naim Frashëri" edhe në kohën e LDK-së ka pas shumë zëra që ajo shkollë është dashtë të ruhet dhe është dashtë të përmirësohet infrastruktura e saj sepse ka qenë objekti më i vjetër por me një projekt të Komisionit European është punuar pa e analizuar formën e çështjes së kanalizimit dhe kemi probleme e që hera e tretë vetëm ne që po intervenojmë e hiq më larg se para dy jave veç kemi intervenuar në të, kështu që probleme ka mirëpo vullnet dhe interesim për punë dhe për përmirësim të gjendjes ka.

z.Shuajb Blakçori, U.D. drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit-DI, theksoi, dua t'i përgjigjem asambleistit z.Isak Ejupi lidhur me pyetjen që ka të bëjë me një stallë të lopëve në fshatin Sekiraqë e që kemi pasë ankesa të vazhdueshme këtu për të dhe për ndotjen e Lumit Llap, dua t'i tregoj që me procesverbal më datën 06.03.2025 Inspektorët e mjedisit kanë dalë në vendin e ngjarjes si dhe kanë parë ndotjen e lumit Llap ku e kanë gjobitur në vlerë 500 euro. Mandej pas një kohe të caktuar ka pas edhe disa ankesa të tjera për atë ndotje nga ajo fermë e madhe e cila pastaj ka kaluar kapacitetin e nivelit lokal me mbi 110 krerë lopë, ndërsa më datë 10.06.2025 kemi bërë një procesverbal të ri ku i kemi shkruar edhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë si dhe Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës sepse e kalon kapacitetin e nivelit lokal.

znj.Arbnorë Uka-Osmani, U.D. drejtoresh DBF, theksoi, faleminderit të gjithëve për komentet, po provoj ta plotësoj pjesën tjetër që po mendoj që nuk kanë mundur të plotësojnë kolegët nga Ekzekutivi. U përmend nga disa anëtar/e të Kuvendit raporti financiar dhe mënyra se si janë prezantuar të dhënat, ju informoj që raporti si format vie nga Thesari, pra nga Ministria e Financave dhe nuk kemi të drejtë të ndryshojmë, por nëse kërkon informata shtesë lidhur me raportin financiar jemi të gatshëm çdo moment t'ju prezantojmë qoftë përmes mënyrës elektronike siç i keni bërë apo në mënyrë fizike, nuk ka asnjë problem dhe çdo gjë është transparente.

Pastaj u tha pse nuk ka krahasim për vite, kjo për shkak se nuk na e mundëson formati i raportit që të bëjmë krahasime të tilla, përndryshe ju mund t'i merrni raportet e viteve të kaluara dhe të bëni krahasimet e nevojshme, mandej përveç kësaj, nga z.Besim Latifi u tha që mungojnë shënime dhe se ky raporti nuk paraqet pamje të drejtë dhe të vërtetë, mirëpo unë e them se raportet financiare edhe prej auditorëve të viteve të kaluara cekët që është paraqitje e drejtë e shënimeve financiare, ndërsa sa i përket opinionit është e vërtetë që kemi keq klasifikime dhe nuk është vetëm që ne si Komunë e kemi bërë këtë, por ka ndodhur për shkak të vendimeve Gjyqësore sepse prej vitit 2021 kemi vendime gjyqësore që vlera totale nëse e mbledhim për çdo vit përfshirë edhe vitin 2025 është vlerë 11.6 milion euro, andaj këto mjete normale që janë marr nga buxheti ku janë planifikuar projektet të ndryshme e që me këtë rast janë cenuar shumë projekte për të cilat kemi vonesa edhe në realizim si dhe pagesa dhe fatura të pa paguara.

Po ashtu deshta që të plotësoj sa i përket detyrimeve kontigjente, nuk përfshihen bashkë faturat e pa paguara me detyrimet kontigjente sepse detyrimet kontigjente nuk kanë ndodhur ende e që pritet të ndodhin, po i përmend sepse njëri prej parafolësve i ceku dhe i mbledhi ato gjatë komentimit, 1.5 milion me 2.2 milion euro e që nuk mbledhen ato ashtu, por që realisht 1.6 milion euro fatura të pa paguara tani me alokimin e buxhetit kemi filluar t'i paguajmë, shpenzimet rrjedhëse janë kryer me kohë, jo nuk i kemi 1.6 milion borxhe sepse kjo shifër ka qenë në total së bashku me shpenzime rrjedhëse si dhe shpenzime kapitale, ku shpenzimet rrjedhëse siç e dini me 1/12-tën pjesë të buxhetit menjëherë kemi paguar për mallra, shërbime, komunalit siç i dim të gjithë i kemi paguar menjëherë, ndërsa me shpenzimet kapitale kemi filluar në mars sepse nuk kemi pasur buxhet dhe tani kemi filluar dhe mendoj që është e menaxhuar.

A a kemi probleme, po kemi si dhe do të kemi probleme, kemi Kontratën Kolektive ende valide dhe kemi ende persona në listë të detyrimet kontigjente që presin vendimin final dhe kur e marrin vendim gjyqësor Thesari vetëm na pyet se në cilat projekte do t'i marrim mjetet, madje ka pasur raste që nuk kanë pyetur fare por në shumicën e rasteve po dhe normal ato projekte do të cenohen dhe ne pastaj do të detyrohemi të bëjmë pagesa me mjete të cilat mbesin, nëse kam harruar diçka mund të më plotësoni por shumica e komenteve u plotësuan nga kolegët e mi nga Ekzekutivi.

U përmend edhe furnizimi me ushqim për çka e sqaroj edhe kolegu parafolës që është një numër i madh i nxënësve dhe t'ju them të drejtën buxheti i ndarë nuk mjafton për 6-7 muaj, pra kemi edhe kufizime buxhetore edhe këto kufizime nuk i bëjmë ne sepse vie sipas Qarkores nga Ministria dhe na kufizon shumë, pra nuk kemi shumë mundësi që t'a tejkalojmë atë, ndërsa tek të hyrat vetanake u përmend suficit dhe nuk mendoj që vlera 860,000.00€ është vlerë e madhe suficit të të hyrat vetanake dhe nëse kemi suficit të të hyrave vetanake është mirë ajo sepse ato bartën dhe nuk humbin, por duhet të kemi kujdes të granti qeveritar, kurse tek të hyrat vetanake është mirë ajo pra janë tejkaluar siç e thash për 130%, pra nuk është planifikuar ai tejkalim dhe ato shkojnë suficit por që barten. Normale që në këtë vit i paguajmë edhe projektet tjera, një pjesë që e kemi të papaguar dhe një pjesë që priten të realizohen gjatë vitit 2026.

z.Fatri Zhitija, theksoi, kam vetëm një përgjigje për kolegun asambleist z.Ekrem Rrahmani sa i përket asaj që e përmendi si çështje 19 Qershorin - Ditën e Çlirimit të Podujevës, me theks disa shpenzime buxhetore rreth 3,000.00€ apo 4,000.00€, në vitin 2025 më 19 Qershor Komuna e Podujevës ka organizuar një koncert shumë të mirë për Ditën e Çlirimit me këngëtarin Ilir Shaqiri dhe emra tjerë të estradës dhe ato shpenzime kanë qenë të atij koncerti.

Shyqyr që erdhi LVV në pushtet e filloj të shënoj këto data sepse patën me i harru krejt.

z.Besim Latifi, nga vendi reagon duke theksuar, ndër të tjera se po flitet krejt jashtë temës dhe nuk e keni idenë se çka është duke u folë këtu. Temë të rendit të ditës e kemi raportin financiar dhe shpenzimet që kanë ndodh, të hyrat dhe çështje tjera përkatëse që ndërliken me raportim financiar

të vitit 2025 dhe kjo është kryefjala, andaj i ndërtuar Kryesues ju lus të mos i lësh të dalin jashtë temës por ta respektoni Rregulloren e punës së Kuvendit.

z.Valon Demolli, theksoi, më bëri të marrë fjalën puna e drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit kur e tha për drunjë dekorativ ka qenë devijim i projektit, këtu nuk ka devijim të projektit por ka një nguti të drejtorit sepse procedurat e prokurimit i'u kanë dashtë të jenë më të ngutshme në mënyrë që fillimisht të mbjellën aty ata drunjë dekorativ e pastaj t'i heq nga aty, që do të thotë se është një projekt komplet i stër dështuar.

Pastaj e tha duke na u drejtuar se po e shfrytëzoni politikisht çështjen e qenve endacak, mirëpo unë e them se LDK nuk e ka kauzë që edhe vdekjen e njerëzve ta shfrytëzon politikisht, por ajo që ka ndodh tashmë është fakt, madje unë tashmë të ndjerën e kam pas edhe fqinjë, andaj qysh mund të thoni ju kinse ne po e shfrytëzojmë politikisht kurse ajo grua ka humb jetën nga qentë endacak, e qe besa për ta rritë buxhetin për qentë endacak unë mendoj se jo që ka nevojë por ka shumë nevojë sepse këtu ka shumë qen endacak.

Sa i përket këtij drejtorit të “rinovuar” drejtor i Drejtorisë së Arsimit i cili po e thotë që e kemi të trashëguar, unë nuk e di prej kujt e keni të trashëguar sepse ti ke qenë pjesë edhe e pushtetit të kaluar, je edhe tani, mandej po thotë jemi pa asnjë aferë korruptive, a e dini pse është pa asnjë aferë korruptive, sepse unë personalisht i kam deponuar ato lëndë në gjykatë, dhe në një rast policit hetues i'a punëson një anëtar të familjes dhe e mbyll lëndën, pastaj në rastin tjetër këta japin leje ndërtimi në qendër të Podujevës për t'i mbyllur hetimet e rastit që unë e kam deponuar, andaj ky pushtet i kapur e ky drejtor i cili vie e filozofon këtu e shet burri e parime, këto nuk qëndrojnë të vërteta, por këto janë kompensime që është dashtë t'i kryejnë këta për t'i mbyll ato lëndë, dy herë i kanë mbyll hetimet, pse, sepse i kanë kryer favore atyre policëve hetues për t'i mbyll dhe për t'i pushuar hetimet. Edhe njëherë propozoj të rritet buxheti për qentë endacak sepse vërtetë ka nevojë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, po filloj nga kolegu i cili foli për koncertin për 19 Qershor, edhe pse nuk e kam zakon të përplasem me koleg asamblistë, mirëpo unë i kam të dhënat edhe kush i ka marrë ato para sepse nuk ditë të Zotit që unë nuk jam në Podujevë dhe e di çka ka ndodh më 19 Qershor, por e thash që janë dhënë parat pa thirrje publike, pra njëri ka marrë 3,000.00€, njëri i ka marrë 4,700.00€ dhe njëri i ka marrë 1,100.00€, andaj nëse dëshiron mandej mund ti them edhe emrat e atyre që i kanë marrë ato para e që nuk kanë fare lidhje me këtë punë.

Përndryshe nuk e përqesha unë koncertin, por e thash dhe po e përsërisë se duhet të bëhet thirrja, kushdo që përzgjedhet le të përzgjedhet, e jo të veprohet pa thirrje publike.

Sa i përket drejtoreshës parafolëse, unë nuk e përmenda as kohën e fushatës as asgjë, edhe pse faturat ishin në korrik-nëntor, as nuk përmenda dy vetura as nuk e di ku, por unë pyeta përse janë marrë vetura me qira dhe janë paguar 5 fatura të njëjta nga 738 euro e që bëjnë 3,690.00€, mirëpo drejtoresha e dha një përgjigje goxha interesante duke thënë, na ka dal më lirë, po ta di ashtu unë dy vetura i kam dhe sot do i shes e pastaj shkoj i marrë në rent nëse veç më dalin më lirë, pra nuk e besoj që dalin më lirë ashtu qysh u tha.

Çështja e tjetër ka të bëjë me atë që e theksoi drejtori i DSHPMSH për qentë endacak e të cilit i paska ardh rëndë, mirëpo nunë nuk e kisha në atë aspekt dhe ky mund ta përdorë politikisht tani, pra unë e thash se po rritet çmimi kurse ne raport nuk kemi sa qen endacak janë trajtuar, por meqë më futet në këtë temë unë di rast dhe më kanë telefonuar persona prej fshatit Buricë të cilët më kanë thënë se tenderin po e merr ai që po e merr mirëpo nuk po i menaxhon qentë endacak por vetëm po i grumbullon dhe po i bjen po lëshon në Buricë, ata qen sërish vijnë në Podujevë sepse atje në Buricë nuk kanë as çka të hanë. Pra nuk raport sa qen endacak janë trajtuar, kurse drejtori e tha se sot janë 2500-3000 qenë endacak e që për mendimin tim nuk thuhet ashtu sepse po ka

diferencë të madhe, do të mund të thuhej 2500-2600 qenë, por jo të jetë ajo diferencë me 500, pastaj e tha po ashtu se trajtohen në vit 100-200, tash unë pyes a trajtohen 100 apo 200.

Unë e thash se ka nevojë të trajtohen qentë endacak, por unë e thash se po rritet çmimi kurse gjendja po mbetet e njëjtë.

Edhe te mirëmbajtja, ti drejtor e the 800,000.00€ kurse unë të tregova sakt se janë 891,888.00€ janë paguar gjatë vitit 2025 për mirëmbajtje, por nuk është mirëmbajtja e mirë, përndryshe nëse doni dilni në foltore dhe lavdërohuni ju dhe po dalim edhe ne po ju lavdërojmë e pastaj po ecim në shtëpi, por ne jemi këtu për t'i gjete gabimet, nuk e cekëm askush që krejt është zi sikurse e përmendi dikush pak më parë të cilit i'a ka shënuar shkrimin Dejona, pra nuk e tham që krejt është zi, por ne jemi për t'i gjete gabimet. Unë këtu i përmenda vetëm 7-8 pika kurse në raport janë rreth 100 pika e që do të thotë se ato që u përmenden janë gabime pak më të mëdha. Ose unë mund t'ju them se nuk ka gropa nëpër qytet, por tani duke ardh e devijova rrugën te kafiteria "Pranvera" sepse rruga aty ishte thuajse e pakalueshme, prandaj kjo shumë e shpenzuar nuk do të ishte e madhe nëse mirëmbajtja do të bëhej ashtu qysh duhet, paratë kanë shkuar kurse mirëmbajtja nuk është askund. Pastaj meqë përmendët gjithë atë trotuar, të lutem drejtor tregomë veç për fshatin Siboc të paktën kur keni mirëmbajtur trotuarin ose ndonjë gropë. Pastaj edhe te drunjë dekorativë që e përmende i nderuar drejtor, edhe unë e thash se na duhet gjelbërimi, por që e them se gabim jeni duke i bërë sepse sërish po them për fshatin Siboc ku janë mbjellë rreth 100 drunjë dekorativ kurse nuk e di 2 prej tyre a mund të kenë ose jo fletë, përndryshe nuk e di kur është koha e tyre sepse nuk jam agronom por ju tregova se çmimet e drunjëve janë 80€, 100€ dhe 110€ e që janë goxha shumë e madhe por patjetër duhet të mirëmbahen, duhet të ujiten, unë nuk e di në cilën kohë janë mbjellë a ka qenë kohë e përshtatshme por ju tregoj se ata drunjë nuk janë zënë dhe nuk janë me gjethe dhe ata duhet të hiqen, pastaj edhe për magjistrale nuk mund të thuash bre drejtor erdh Ministria më tha heqi ata drunjë sepse ne këtu jetojmë dhe e dim secili që ndriçimi publik shkon në mes të dy rrugëve aty në magjistrale, madje duhet ta besoni që edhe paraqet pengesë ajo mbjellje e drunjëve në atë formë qysh ka qenë sepse hapësira aq e ngushtë në mes dy korsive normale që pengon, pra e dim që duhet të ketë gjelbërim por aty paraqet pengesë, por të ishte ajo hapësirë më e gjerë normale që lejohet gjelbërimi por në atë hapësirë nuk lejohet, përveç ndriçimi asgjë tjetër nuk lejohet, shpresoj ti kesh mbjellë ata drunjë diku tjetër por unë nuk besoj që i ke mbjellë diku tjetër. Sa i përket shenjzimeve horizontale dhe vertikale, ty drejtor ndoshta të duket shumë e vogël e parave por mua po më duket shumë, 154,416.00€ për çdo vit për shenjzime mua vërtetë më duken shumë, e them këtë sepse këto shenjzime nëpër rrugë që janë me ngjyrë më shumë po qlyhen menjëherë, pra nuk e di unë qysh ty drejtor po të duket shumë e vogël 154,416.00€, përndryshe tabelat nuk vendosen për çdo ditë e as për çdo vit përveç në rastet e ndonjë aksidenti apo dëmtimeve tjera e që ndërrohen dhe vendosen të reja, madje ka raste edhe ku i dëmtojnë vetë qytetarët dhe e di që duhet të mirëmbahen apo të ndërrohen por nuk është shuma e shpenzuar është shumë e madhe.

z.Besim Latifi, theksoi, i nderuar Kryesues unë po shohë se janë larg prej elementit për çka jemi duke diskutuar në këtë pikë të rendit të ditës që është raporti financiar, pra ne jemi duke diskutuar për një raport financiar ose për pasqyrat financiare se si janë shpenzuar mjetet buxhetore të vitit 2025, sa kanë qenë të planifikuara për investime kapitale sa janë shpenzuar, sa kanë qenë të planifikuara për mallra sa janë shpenzuar, pastaj folëm për mungesë transparence, dhe unë fola për një raport i cili është me mungesë transparence për arsye se nuk po tregohen në zërat buxhetor këto fjalë që jeni duke i thënë ju, nuk im keni të pasqyruara në raport, është dashtë të merret kartela analitike për të ditë sa keni harxhuar mjete buxhetore për mirëmbajtje ta zëmë e që ajo që u tha nga drejtoresha e Administratës që ka qenë do të thotë është aq absurde sepse e tha se po marrë vetura me qira sepse po më del më lirë, kurse në anën tjetër e ka rritur mirëmbajtjen, do të thotë kjo është

absurde se çka foli ajo duke thënë se për ta rritur efikasitetin, nëse është ashtu unë ju pyes a i keni ende me qira ato vetura, (meqë përgjigja e drejtoreshës është se po) do ta shikojmë në fund se a do t'ju del në raport më lartë apo më poshtë shpenzimi, kjo sepse edhe paguan qira, pastaj edhe ato vetura dëmtohen dhe kanë nevojë për servise, edhe ato shpenzojnë derivate sikurse të tjerat, prandaj e them se absolutisht është absurde ajo që u tha.

Pastaj nëse e shohim raportin se sa ka pas shpenzim dhe sa ka pasë mbetje të mjeteve të pashpenzuara, do të thotë është qesharake ajo që e dëgjova që u tha është mirë që nuk kemi harxhuar paratë, mirëpo paratë kanë qenë të planifikuara nëpër kode ekonomike për t'u shpenzuar qoftë te të hyrat qoftë te grandit, është një borxh jashtëzakonisht i lartë, pastaj kemi parë pagesa që janë bërë prej kodi në kod pa vendim të këtij Kuvendi, pa vendim të Qeverisë së Kosovës, madje ka pasë shuma ku është marrë komplet shuma prej buxhetit e që është jashtë çdo norme sepse deri në 25% vetëm Kuvendi Kosovës mundet kurse deri në 5% ky Kuvend i Komunës, deri 15% Qeveria e Kosovës, pra është rregullativa ligjore qysh shpenzohet një buxhet.

Pra drejtoresh e nderuar, pasqyrat financiare, mund të hyni dhe të shikoni ato të mëhershme cilin do që dëshironi, e sheh se gjithmonë kanë qenë të krahasuar me vitin paraprak, përndryshe qysh mundesh të bësh analizë të pasqyrave kur nuk i ke krahasimet me vitet paraprake sepse aty sheh dhe bënë krahasime për zë buxhetor shembull sa ka qenë në vitin 2023 sa në 2024, sa në vitin 2025 dhe pastaj bënë krahasimet se a janë rritë shpenzimet a janë zvogëluar e kjo është element bazik në financa, prandaj të mos tentohet të pasqyrohet këtu duke u thënë janë bërë punë, në rregull është ajo dhe ne jemi duke diskutuar ato punë që janë bërë, qysh kanë ndodh ato shpenzime, a kanë ndodh në bazë të legjislacionit, a kanë ndodh në bazë të rregullores financiare që është për shpenzim të parasë, edhe raportimi a është duke u bërë qysh e jep Rregullorja për raportim financiar, dhe jemi në rregull.

U cekën detyrimet e papaguara të cilat kanë ardh në formë të faturave, kjo çështje është e kryer dhe kontigjenca pritet me ndodh por borxh jeni zonjë, pra kjo ka ndodh në vitin 2025 si detyrime të papaguara e që nuk i keni paguar brenda 30 ditëve e që këtu i në raport i keni shumat, madje ka edhe më shumë se 30 ditë, janë fakte këto ku janë rreth 1,600,000.00€ që janë të vitit 2025, pastaj i keni kontigjencat që kanë me ju ndodh në vitin 2026, kontigjencat e vitit 2025 janë diku rreth 2.6 milion euro pra kanë me ju ndodh edhe në vitin 2026, do të thotë jemi duke fole për borxhe të larta të Komunës dhe jemi duke fole në anën tjetër për një suficit shumë të lartë kurse ti po thua është në rregull, mirëpo unë t atem se nuk është në rregull sepse është dashtë të shfrytëzohen ato mjete financiare, do të thotë ti mund të planifikosh te inkasimi te të hyrat vetanake qoftë nga tatimi në pronë apo kudo tjetër por mundesh vetëm 1 euro ta inkasosh dhe në rregull jemi sepse e njeh sistemi, por duhet të planifikosh se sa realisht mund të inkasosh, pra duhet ta dish çfarë të hyrash ke me mbledh, sa është fuqia prej atyre të hyrave dhe me qenë afërsisht sepse nuk mund të luaj shumë raporti ashtu qysh po luan tani.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoj, vetë dëshiroj të sqaroj dhe po e citoj nenin 41 të Rregullores së Punës së Kuvendit, sqarimet plotësuese apo diskutimet për herë të dytë në kuadër të një pike të rendit të ditës lejohet vetëm pas përfundimit të të gjithë të paraqiturve në diskutim dhe atë në kohëzgjatje për 3 minuta, andaj ju lutem ta përfundoni diskutimin.

z.Besim Latifi, vazhdoi, atëherë i nderuar Kryesues edhe unë vetëm po ju kërkoj ta respektoni Rregulloren asgjë tjetër.

Për fund, gjithçka çka është në këtë raport do të merret prej Auditorit, ne të gjithë mund të dalim dhe të duartrokasim duke thënë se është i shkëlqyeshëm, por vie Auditori ashtu qysh ka ardh për sa vite me radhë dhe ju ka qitë se keq i keni pasqyrat financiare e nderuara drejtoresh e DBF-së edhe pse nuk është faji juaj sepse ti nuk ke qenë më përpara në këtë funksion, por keç ka dal, edhe si

pasojë e keqklasifikimit nga Kontrata Kolektive, edhe pagesat prej kodi në kod që janë bërë e që shumicën e tyre i ke aty, pra mbi 250,000.00€ si ta kalosh ajo del e keqklasifikuar, do të thotë që pastaj po humbet grandit i performancës dhe po vijnë një mori çështjesh tjera, prandaj nuk jemi në këtu në kontekstin qysh po aludohet si opozitë për t'ju kritikuar, jo sepse unë po ju lexoj faktet që ju i keni pasqyruar, po të them se tabela këtu është dashtë ta ketë edhe vitin 2023, e ka vitin 2024 po nëse ju mund ta lexoni atë që thuhet aty atëherë në rregull jemi, nuk mundesh sepse keni probleme në këtë raport edhe në aspektin teknik e të mos flasim në aspektin përmbajtësor.

Nuk jam për t'ju dhënë asnjë kritikë në kuptimin sa i përket asaj që jam opozitar, por këto janë fakte, suficiti është fakt sikurse borxhi po ashtu, ideja është që hapat që i keni ndërmarrë të mos ndodh më, kjo është me rëndësi për qytetarin, këto borxhe që i keni, këto probleme që po ju paraqiten vit pas viti, nga 12 vërejtje po ju bie Auditori kurse nga 8 po ju përsëriten minimalisht, pse po përsëriten, e në qoftë se nuk merren për bazë rekomandimet e Auditorit dhe shpenzohet buxheti qysh do, atëherë ne mund të vijmë këtu dhe të diskutojmë duke bërë lojëra politike a e kemi bërë mirëmbajtjen me 800,000.00€ apo me 500,000.00€, a me buxhet të Komunës apo me Kompani private e pastaj t'iu gjuhen edhe Kompanive publike qysh janë Eko-Llapi e të tjerat duke bërë duplikime për të njëjtat punë, kështu që kjo temë është pak më e gjerë se sa që duket.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, unë paraprakisht e lexova një nen të Rregullores së punës së Kuvendit dhe besoj të gjithë e dini atë, prandaj ju lus të gjithëve që t'i përmbahemi Rregullores së Punës, me theks kohës së diskutimit, përndryshe unë tani e tutja do ta shikoj këtë dhe nëse tejkalohen në këtë fazë mbi 3 minuta do të detyrohem t'ia ndërpres fjalën, prandaj kërkoj të mos e bini situatën deri aty por t'i përmbahemi Rregullave.

z.Besim Latifi, theksoi, i ndërtuar Kryesues atëherë respektoje Rregulloren edhe sa i përket rendit të ditës dhe mos i lë të dalin nga rendi i ditës.

z.Fatrri Zhitija, theksoi, parafolësi ishte shumë kundërthënës sepse në njërin anë po thotë pse i keni shfrytëzuar paratë dhe i keni përdorë për projekte tjera kurse në anën tjetër pse ke suficit, pra vazhdimisht pati kundërthënie mes fjalëve të veta.

Keqklasifikimi ne nuk e dim që nuk është keqpërdorim as nuk është keqmenaxhim, por keqklasifikimi është me i bartë paratë prej një kodi në një kod tjetër për një projekt të caktuar i cili nuk ka ecë mirë qysh është planifikuar, dhe në këtë aspekt unë jam ithtar që çdo herë të ketë keqklasifikime nëse realizohen projekte, e Komuna e Podujevës në vitin 2025 është dëshmitar që ka realizuar shumë projekte edhe pse ka pasë ndonjë keqklasifikim për shkak të ndonjë projekti të caktuar i cili nuk ka ecë ashtu qysh është planifikuar.

z.Besim Latifi, theksoi, në buxhet planifikohen shpenzimet nëpër secilën kategori, përndryshe nuk kish me pas nevojë e as logjikë fare të ketë Rregulla dhe buxhet të miratuar sepse vetëm i kishim marrë paratë nga një vend në tjetrin, prandaj për këto çështje edhe raporti i auditorit ju ka thënë që jeni gabim dhe po jua cekë për çdo vit, andaj për këtë përgatitet buxheti dhe planifikimet, përndryshe aty ku nuk keni mundur për një arsye të caktuar silleni në Kuvend të Komunës, ridestinoni kodet për këtë është Kuvendi i Komunës, këtë rol e ka që të mbikëqyrë dhe miratoj ridestinime të mjeteve aty ku nuk mund të vazhdohet ndonjë projekt, këto bëhen me procedura, ndërsa ajo çka foli parafolësi është hajgare.

znj.Gresa Qosa-Maqastena, theksoi, drejtori i DKA-së foli për procedura dhe ndër të tjera e tha që çdo çështje kalon nëpër 10 e 20 sy, madje e tha që për çështjen te shkolla "Naim Frashëri" është trashëguar, për besë edhe ju keni qenë aty, profesori (Kryetari i Komunës) ka qenë drejtor i Drejtorisë së Arsimit. Problem i trashëguar që 6 vite, rriteni stafin teknik në shkollën "Naim Frashëri" asgjë s'ju pengon ta rrisni sepse e keni katastrofë, pastaj e keni marrë një drejtorë e keni sjellë për favore politike që jua ka prish grevën e arsimit në Dobërdol dhe e keni sjellë në shkollën

“Naim Frashëri” e cila ka qenë prej shkollave më të mira dhe më elitare e që e din edhe Kryetari i Komunës, kurse sot është prej shkollave më katastrofë, prandaj ju thërres ta rritni stafin teknik sepse ndërrimi i dytë për çdo ditë fillon me mbeturina në atë shkollë, higjiena është e tmerrshme, madje tash për momentin në atë shkollë ka alergji dermatologjike tek fëmijët dhe nëse doni jua cekë me index dhe me emër e mbiemër të arsimtarit.

Edhe njëherë sa i përket procedurave që u cekën, nuk na interesojnë neve procedurat, ju i nënshkruani 20 kubik dru e jo t’i dërgoni atje 10 kubik, por duhet t’i dërgoni 20 kubik sepse pastaj të kanë dështuar edhe orët, në natën e Madhe të Bajramit ti drejtor i ke kërcënuar drejtorët për ta mbajtur orën e fundit ndërsa nuk e din që gjatë gjithë kohës së ramazanit t’i kanë liruar orët e fundit por e ke treguar që je drejtor në atë kohë, mirëpo ata prap se prap ty të binden edhe që i kërcënuar edhe që nuk i ke kërcënuar. Po vie pushimi pranverorë dhe ende nuk ke fol asgjë për dy ditë të humbura që i ke pas në arsim, pastaj shikoni sa orët e humbura i keni në shkollën Ekonomike, drejtorët dhe zëvendësdrejtorët që po i emëroni e të cilët kanë të bëjnë me politikë, asnjë ditë në arsim nuk e kanë, nuk din as sa orë të planifikuara nëpër lëndë i kanë.

Pra meqë drejtori i DKA-së foli për procedura, edhe njëherë po dua t’i them se neve nuk na intereson për procedura dhe a i ke stoqet, por vetëm duhet të tregosh ato 43,000.00€ që i ke harxhuar në vitin 2025 ku ka pasë rritje të buxhetit, çka ke bërë me ato para, kjo na intereson neve sepse në bodrum nuk besoj që i ke lën.

z.Ermal Osmani, theksoi, deshta të ndërlihem edhe unë me drejtorinë DKA-së, ne e dim të gjithë Avni, nga Kryetari e Kryesuesi e që ne tani këtu që jemi asnjë nuk kemi qenë drejtor të LDK-së, por në kohën që ti e the e kam trashëguar shkollën “Naim Frashëri” prej LDK-së, ti në atë kohë ke qenë drejtor, ke qenë anëtar i Kryesisë së LDK-së dhe ke qenë nga pozicioni i LDK-së, pra ti vetveten po e bënë fajtor me këtë çështje, mirëpo ke ditë të “notosh” sepse i mençur je, i pate lëshuar edhe mustaqet pastaj dole paksa i heqë mustaqet, po tani e ke lëshuar edhe mjekrën, prandaj e pyes drejtori e DKA-së z.Avni Fetahu se a e ndjen veten fajtor për atë çështje.

z.Avni Fetahu, U.D. drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, theksoi, jam i gatshëm për çdo përgjigje që të jap mirëpo sot u bë një akuzë prej parafolësit Valon Demolli, dhe sot jemi në datën 31 mars, ora qenka 12:14 minuta, deri në seancën e ardhshme ti Valon Demolli ata emra të hetuesve që unë i’ a pasna punësuar më herët ndonjë anëtar të familjeve të tyre, e ke për obligim t’i sjellësh këtu dhe nëse ti i sjellë, unë para krejt këtyre që janë prezent këtu unë po jap betim se unë do të dal këtu dhe do të jap dorëheqje, por ti e ke për obligim që t’i sjellësh emrat dhe të tregosh.

Unë po besoj se ata hetues do të kenë punë edhe me ty por edhe me veprimtarinë tënde, megjithatë unë po jap premtim publik kurse ti e ke për obligim që t’i sjellësh emrat. Unë tani hetuesve as emrat nuk jua di sepse kanë kaluar dy vite, ama ti e ke për obligim që krejt procedurave, me hetues dhe me krejt çka kanë qenë me i sjellë emrat e tyre dhe të thuash shembull, e ke punësuar atë ose këtë, unë e kam për obligim sot një muaj apo kurdo që mbahet seanca, të dal këtu dhe të jap dorëheqje, mbanë mend këtë dhe mbamëni për fjale.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, nuk e pata ndërmend të marrë fjalën pasi që kjo fusha e ekonomisë është paksa jashtë profesionit tim, megjithatë në qoftë se e shohim në përgjithësi raportin financiar është një raport financiar i balancuar e në qoftë se shohim realizimin gjatë vitit 2025 kemi një realizim të buxhetit 98% që tregon një sukses të jashtëzakonshëm si dhe kur jemi dëshmitar të përmirësimit të kushteve qoftë në arsim, shëndetësi, infrastrukturë dhe në të gjitha sferat e jetës.

Më bënë të marrë fjalën dy gjëra të cilat goxha logjike që u cekën nga disa prej kolegëve nga opozita, njëra ishte për humbjen e vlerës së pajisjeve mjekësore, e që siç e dim logjikisht nëse investojmë në ari, arit zakonisht i rritet vlera, por nëse investojmë në aparatura mjekësore ose në vetura ato zakonisht brenda 1 viti i’u përgjysmohet vlera,

Çështja e dytë që deshta të ndërlihem është termi dermatologji alergjike, mendoj se kjo është një term shëndetësorë për të cilin nuk na takon neve këtu sepse te dermatologjia alergjike, alergjia nuk shfaqet për shkak se në një ambient të caktuar mund të ketë paksa pluhur ose nuk ka pluhur ose nuk ka mbeturina, ajo është diçka tjetër që ka të bëjë me sistemin imunitar dhen janë terme mjekësore kështu që do të thoja të kursehemi prej këtyre termeve. Pra ne jemi dëshmitar që në qoftë se dikush ka alergji, edhe në shtëpitë e tyre ku është pastërtia maksimale ajo prap shfaqet edhe në qoftë se nuk ka pluhur. Gjithashtu jemi dëshmitar se në çfarë gjendje ka qenë sistemi arsimor dhe pastërtia në të kaluarën dhe çfarë është sot.

z.Valon Demolli, theksoi, ku drejtori parafolës i DKA-së nuk e di çfarë problemesh ka, unë duke dal deri jashtë te dera më drejtohet, mos ik, mirëpo unë nuk kam ikur as kur ka qenë koha.

Ato çka i thash më herët janë plotësisht të vërteta, të gjitha, edhe nuk e di ky drejtor që mundohet të shes parime për cilën veprimtari timen e ka fjalën, ky drejtor, ky shefi i propagandës së LVV-së nuk ka lënë kun pa ma përlyer emrin nëpër media, nëpër portale fake (të rreme), mirëpo drejtor, unë jam Valon Demolli, unë i takoj një familje NDSH, e jo një familje sikur familja jote, meqë po më shtin të lëshohem shumë në personale, a ka mundësi t'ju tregosh qytetarëve Llapjan ku të jeton gjysma e familjes tënde, a ka mundësi të tregosh, a ka mundësi të tregosh ku ka punuar babai yt.

Pastaj kur e përmende veprimtarinë time, dil e tregoje këtu çfarë veprimtarie kam unë dhe çfarë veprimtarie ka familja ime, prandaj nuk ke nevojë.... Ke shkuar dhe më ke përlyer emrin tim nëpër portale fake (të rreme), ti ke qenë shef i propagandës

Kryesuesi i Kuvendit, bënë thirrje për tu përmbajtur nga debate të tilla sepse në të kundërtën tash e tutje do t'ju ndalet fjala, pra diskutimet të jenë vetëm në kuadër të rendit të ditës.

z.Haki Rudari, theksoi, unë dëgjova diskutimet e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, nga pozita dhe nga opozita, kam qenë në dy mandate opozitë së bashku me kolegët tjerë dhe e dimë çdo herë se raportit financiar ngjall debate sepse edhe ne kur kemi qenë në opozitë sigurisht që kemi bërë kritika andaj edhe tani opozita që është tani këtu është për të bërë kritika, por kritikën duhet të jenë të drejta të sinqerta dhe jo përgojuese. Pra unë jam ithtarë i një diskutimi në bazë të raportit që na është dërguar në bazë të rendit të ditës. Haki Rudari bashkë me Adelina Stubllen dhe Bahri Selimin kemi qenë opozitë në vitet 2013 – 2017 dhe kemi qenë shumë aktiv por besoni kurrë nuk kemi qenë përgojues. Ka qenë ish drejtori i Financave, prindi i kolegut tani z.Besim Latifi le mund ta pyes ky atë, pra kemi qenë aktiv por jo gjëra tjera, prandaj po dua të them se debati duhet të bëhet por të bëhet në kuadër të pikës së rendit të ditës, të tjerat nuk jam ithtar që t'i përkrasi dhe më vie keq që gjatë debateve edhe pse përmendet emri nuk ka problem por në rastet kur kalon jashtë rendit të ditës, po ma impononi që pastaj edhe unë ta lëshoj seancën e që në jetë asnjëherë nuk i kam lëshuar seancat.

Jam shumë ithtar shumë të dëgjoj edhe vërejtjet e opozitës, unë si shef i Grupit i përcjellë, i shënoj dhe i evidentoj, por ato vërejtje që janë të drejta dhe ato që janë me vend, kurse vërejtje që thuhet hajt veç të them diçka për besë nuk më bëjnë përshtypje fare, madje as të Grupit tim e që më herët bëra vërejtje kur unë diskutoja këtu kurse ata në vend atje bënin zhurmë duke pëshpëritur.

Këshilltari Komunal ka një fuqi për arsye se atë e ka marrë nga qytetarët, ka marrë votë nga qytetarët, andaj po dua ta përfundoj këtë diskutim dhe mendoj se Kryesuesi i Kuvendit duhet ta respektoj Rregulloren e punës së Kuvendit, andaj i nderuar Kryesuesi i Kuvendit në bazë të Rregullores, këshilltari i cili ka folë njëherë i jepet fjala për herën e dytë pasi të kryhen debatet, folë herën e dytë vetëm në rast se ka replikë, i jepet fjala edhe Kryetarit të Komunë dhe të tjerëve, dhe sërish në rast se ka replikë, unë Haki Rudari dhe të tjerët duhet të qëndrojnë në vend dhe të respektohet Rregullorja ngase është në interes të të gjithëve.

Unë deshta të kërkoj pauzë, por sigurisht që edhe Kryetari i Komunës ka kërkuar fjalën dhe sigurisht që ka për të diskutuar, mirëpo mendoj se pasi ta kryejmë këtë pikë të rendit të ditës mund të shkojmë në pauzë.

z.Bahri Selimi, U.D. drejtor i DSHPMSh, theksoi, po e shoh që paksa eskaloi dhe krejt çka pash në këtë debat te Grupi i LDK-së ishte një ç'akordim total apo i plotë sepse njëri thotë folni për zëra buxhetor, tjetri bënë pyetje për X projektin dhe thotë që janë shpenzuar shumë para, tjetri thotë që nuk janë shumë por duhet të rriten ende buxhet, prandaj është mirë që fillimisht të dakordoni paksa mes veti sepse kur parashtroni pyetje ne duhet të përgjigjemi pastaj.

Se a flasim ne për zëra buxhetor apo për ndonjë gjë tjetër krejt varet se qysh i parashtroni ju pyetjet, pra rasti ku z.Ekrem Rrahmani thotë që janë shumë 42.000.00€ për trajtimin e qeneve endacak, ndërsa z.Valon Demolli thotë që duhet të rritet ende buxheti për qentë endacak, pra a keni folur ju në mes veti, tani a të rrisim buxhetin apo ta zvogëlojmë sepse nuk po e kemi shumë të qartë, mund ta shihni incizimin se çfarë keni folur.

Në anën tjetër ishte një akuzë te trajtimi dhe bartja e qeneve endacak, dua të them që nuk ndodh kjo te kompanitë tona por kjo ndodh mes Komunave dhe për këtë arsyeje kur u përgjigja e theksova 2500 deri 3000 e u duk shumë e madhe ajo diferencë prej 500, mirëpo unë e them që mund të ketë edhe më shumë, pra duhet ta kuptoni fjalën endacak, të lëvizshëm dhe këto bartjet bëhen prej komunave në komunë e që na sjellin neve këtu, bartën edhe në Sharban edhe në Ballaban, Dobratin, Kërpihë, pra shumë shpesh na vie llavë nga atje, por ky është problem shtetëror dhe nuk është vetëm problem komunal. Prandaj me një fjalë e them se ju duhet të jeni të dakorduar se si po e bëni pyetjet ne pastaj ashtu ja japim edhe përgjigjen sepse tash nuk po mund t'a se a të rritim buxhetin 60.000.00€ apo ta zvogëloj në 30.000.00€.

Më së paku zotëri Ekrem unë dua që të lëshohem në sulme familjare sepse po të dua do t'ia sulmoja sot babain njërit këtu që prej vitit 2013 që jam në asamble, por nuk dua sepse ato janë të kaluara e unë flas për tashmen dhe për të ardhmen.

znj.Valbona Ibishi-Azemi, U.D drejtoresh e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS, theksoi, sa i përket shpenzimeve të cilat u diskutuan në kuadër të Autoparkut dua vetëm të bëjë një sqarim të vogël, në kuadër të Autoparkut kontrata e mirëmbajtjes nuk e ka vetëm Atoparkun e Komunës por aty hyjnë edhe Njësia e Zjarrfikësve, QKMF dhe Urgjenca, kështu që sa i përket Autoparkut shpenzimet janë të pakrahasueshme që kanë bërë një ulje me shtimin e veturave të reja dhe përdorimi i tyre. Pastaj një sqarim tjetër shtesë është se në këto vetura nuk është vetëm çmimi i qirasë por ato kanë edhe mirëmbajtje duke përfshirë gomat dhe të gjitha shërbimet tjera të cilat i bëjmë në kuadër të Autoparkut dhe kontratave të tjera.

z.Avni Fetahu, U.D. drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, theksoi, për 5 vite radhazi çështjen e familjes ma keni përmendë, dhe unë e ndjej si obligim t'ju them se babi im e ka emrin Jahir Fetahu të cilin e përshëndes (i ka 70 vite), ka qenë policë dhe zëvendëskomandir i policisë dhe komandant i policisë deri në vitet e 90-ta kur është prish Jugosllavia dhe im kan heq prej pune, po ashtu edhe mixha im Fetah Fetahu që banon në Austri, babai im banon në fshatin Shtedim, dhe nuk mund ta përlyeni familjen e askujt e që unë nuk jam merre me këtë qe 5 vite, por tani po e ndjej për obligim për hatër që t'ia qetësoj edhe babait tim zemrën dhe të mos mendoj që foli dhe po e asgjësoj këtë punë. Krejt na njohin, Llapjan jemi dhe s'mundeni të na përlyeni në asnjë formë si familje sepse familje ime ka punuar deri sa i kanë heqë sikurse shumicën e njerëzve 90% që i kanë larguar prej pune e që në mesin e tyre është edhe babai im i cili e ka kryer shkollën në Vushtrri, e kanë qar në Kaqanik ku ka shpërblyer atje, kemi jetuar edhe ne atje, është përmbyll ajo epokë dhe s'mund të më ngjitni tjetër gjë, përndryshe mundohuni sa të doni por kjo është e vërteta.

Pra rreth asaj që pata pyetje, familja ime, babai im jeton në fshatin Shtedim, mixha im që ka shërbyer një kohë si oficer, dhe pas viteve 90-ta që është prish Jugosllavia sot jeton në Austri, kjo është e vërteta, tjerat janë shpifje të njerëzve të ulët që i kanë bërë në këtë vendin tonë për fat të keq e që ke mund të ndikohesh edhe ti prej tyre (i drejtohet Valon Demollit).

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, pasi që diskutimet rreth kësaj pike të rendit të ditës kanë përfunduar atëherë fjalën i'a jap Kryetarit të Komunës.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, duke përshëndetur gjithë të pranishmit, theksoi, dua që të jem shumë i shkurtër në diskutimin tim për këtë pikë të rendit të ditës sepse mendoj se mjaft gjëra u sqaruan, shumë prej sqarimeve i bënë drejtorët/shat e drejtorive të Komunës të cilët janë bartës të këtyre punëve dhe projekteve të cilat i kemi realizuar në vitin 2025.

Jam në dijeni që si opozitë në këtë Kuvend detyrë e juaja është të kritikoni dhe të japni vërejtje sikurse që është detyrë e jona si Ekzekutiv të të përgjigjemi në atë çështje që mund të përgjigjemi.

Duhet pranuar se në vitin 2025 buxheti i Komunës ka qenë mbi 35 milion euro, prej tyre mbi 9 milion euro për investime kapitale, pra një prej buxheteve më të mëdha që ka pas Komuna e Podujevës ndonjëherë. Se cilat janë punët dhe projektet që janë përmbyllë, ose që kanë filluar ose që janë në proces besoj i dini të gjithë e para së gjithash i dinë qytetarët e Komunës së Podujevës, mirëpo a mund të ketë ndonjë dobësi aty-këtu, në menaxhim të gjithë këtyre punëve të shumta dhe projekteve të shumta, sigurisht që po edhe mund të ketë. Potencialin e resurseve humane i kemi këto që i kemi gjete këtu nuk është që kemi bërë ndenjë transformim të madh.

U diskutuan shumë tema për të cilat në masën më të madhe morën përgjigjet prej drejtorëve të Drejtorive, mirëpo unë bëra përpjekje t'i selektoj ato çështje për të cilat i morën përgjigjet në mënyrë që të mos i përsërisë, mirëpo pati edhe disa për të cilat do të jap përgjigje.

U përmenden drekat, sepse gjithmonë është një pikë në zërin buxhetor që është më i ndjeshëm, janë rreth 13,000.00€ shpenzime, jo që nuk janë shumë sepse edhe mund të jenë shumë, por ju e dini që në fundvit një ndej e stafit komunal që është bërë e ka një kosto, pastaj një delegacion i cili ka ardh prej shteteve të binjakëzuara brenda Komunës tonë dhe të cilat ju e dini sa janë bartë me vete një pjesë të shpenzimeve buxhetore sepse nuk mund t'i lëm mysafirët pa ushqim e pije dhe pa i akomoduar diku, duhet t'i bëjmë ato sepse jemi Komunë dhe jemi shtet. Mendoj që nëse bëjmë krahasime të mëhershme e që ju e dini se unë i di, jemi në shifra minimale të shpenzimeve, pastaj nëse themi se janë shumë edhe mund ta diskutojmë atë se a ka mundësi të ulen shpenzime të tilla sepse mirë është të jenë sa më të ulëta.

U përmend inventari e që shuma ishte pak mbi 40,000.00€ nëse nuk gaboj, i kemi 57 objekte shkollore në funksion, e kemi Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare me gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe objektet e shërbimit tjera shëndetësore që veprojnë, pastaj e kemi institucionin e Komunës dhe mendoj që me gjitha këto institucione, nuk besoj që janë shifra shumë të larta ato që u cekën dhe a e dini pse po ju them këtë sepse ka përafërsisht 6 muaj që nuk po mundemi ta lëshojmë në funksion që të jetë e gatshme shkollën e Fshatit Lluga për shkaqe të mungesës së inventarit, andaj po të kishim buxhet të mjaftueshëm për inventar sigurisht që do ta lëshonim në përdorim shkollën e Fshatit Lluga e cila është komplet e përgatitur por që për shkak të mungesës së inventarit nuk kemi mund ta lëshojmë në funksion për nxënësit e fshatit, pra po të kishim shuma aq të mëdha dhe të bollshme sigurisht që do ta bënim me buxhet të Komunës dhe nuk do të prisnim.

Furnizimi me ushqime, shuma rreth 349,000.00€, kjo është një shumë e cila vie komplet nga niveli qendrorë me atë zë buxhetor, madje e di që edhe kjo shpeshherë nuk ka qen e mjaftueshme dhe na është dashtë të marrim mjete nga zërat tjerë buxhetor për ta bërë të mundur plotësimin e tyre.

Problemi me të cilin jemi ballafaquar dhe atë jo vetëm në këtë vit por realisht nga viti 2020 është Kontrata Kolektive, asambleistë të respektuar llogariteni po të hiqen prej një buxheti rreth 9 milion euro 3.7 milion euro kompensime nga vendimet Gjyqësore dhe Përmbartimore, andaj çka do të bënim po të mos ishte një shumë jashtëzakonisht e madhe për projekte të cilat janë realizuar drejtpërsëdrejti si rezultat i bashkëpunimit të mirë që kemi pasë me nivelin qendror dhe me dikasteret e caktuara ministrore, dhe nëse ju e vlerësoni që krejt ky vit buxhetor i viti 2025 është mbyllë me këtë shumën e mbetur prej rreth 3.7 milion euro, do të thotë ju e dini që ka qenë absurde sepse nuk do të mund ta mbyllnim.

A ka keqklasifikime, po ka dhe i kemi bërë për një arsye të vetme që të mos na mbesin mjetet buxhetore suficit dhe në anën tjetër të mbetemi në borxhe, pra pse i kemi bërë këto keqklasifikime, për arsye se qysh në start e kemi ditë që raporti i Auditorit do të jetë i kualifikuar, nëse vetëm edhe 10 euro merren në formë përmbartimore të një subjekti i cilit do qoftë ai, raporti i Auditorit do të jetë i kualifikuar dhe ne pra të kualifikuar se të kualifikuar kemi bërë përpjekje të mos krijojmë deficit buxhetor dhe mos lëm borxhe për vitin vijues por që t'i mbulojmë me këto mjete financiare. Përmbartuesit në shumicën e rasteve kanë pyetur se ku dëshironi t'ju merren mjetet, janë heq mjete prej subvencioneve, prej shërbimeve, prej mallrave, janë heq mjete edhe prej projekteve kapitale, pra prej gjitha kategorive përveç kategorisë së pagave dhe mëditjeve, të gjitha zërat buxhetor janë atakuar dhe është dashtë të gjendet forma dhe mënyra qysh t'i kompensojmë krejt ato shuma buxhetore për ta bërë të mundur realizimin e ndonjë punë ose projekti të mirë për Komunën tonë, pra nuk ka qenë e lehtë për ta menaxhuar këtë.

Andaj mendoj që suksesshëm është përmblyll, pse e themi suksesshëm sepse nëse unë them që mbi 97% e buxhetit është shpenzuar ju e thoni po ju kanë marrë 3.7 milion euro, po i kanë marrë, mirëpo po t'i lenim ato kategori ashtu qysh kanë qenë të kategorizuara nëpër zëra buxhetor ndoshta sot do të kishim një borxh 2 ose 2.5 milion euro më të lartë se që mund ta kem në këtë vit që jemi, prandaj kjo ka qenë arsyeja përse janë bërë ato lëvizje nga një zë buxhetor në tjetrin zë buxhetor.

Në anën tjetër, u bënë shumë pyetje dhe disa ishin shumë pyetje me vend, njëra prej tyre ishte ajo që u diskutua shumë sa i përket dy veturave me qira, e për ato vetura me qira që i kemi marrë e që nuk e di sakt sa është shuma e mjeteve që paguajmë në muaj, ne vetëm derivatet i kemi si shpenzime kurse çdo gjë çka ndodh me ato vetura është përgjegjësi e furnitorit sepse nuk është rent por është një Agjencion ku merren të gjitha veturat zyrtare në këtë formë me qira, prandaj ju e shihni çfarë është autoparku ynë, fatmirësisht në fund të vitit të kaluar kemi arrite ti blejmë edhe 3 makina të reja por shumica e këtyre veturave tjera janë të amortizuara, shumë prej tyre disa herë im kemi vë në ankand publik dhe nuk janë shitë, vetëm një prej tyre që ju e dini cili është nuk e kemi vë në ankand për shitje, të gjitha tjerat pothuajse i kemi vë në ankand publik për t'i shitur, atë që po e përmendni po e mbajmë për kujtim.

Kështu që ky raport ka defekte por ne nuk mund të dalim jashtë formës dhe shabllonit sepse nëse është shabllon i Ministrisë ky raport dhe duhet të jepen këto informacione brenda këtij shablloni ne nuk mund të bëjmë shabllon të ri sepse pastaj jemi jashtë standardit, mirëpo nëse ka nevojë për informata shtesë të hapur jemi, unë ndoshta nuk mund t'ju jap gjitha përgjigjet por besoj një pjesë të përgjigjeve po se çfarë ka ndodh, mirëpo ja ku e keni drejtoreshën e Buxhetit dhe Financave.

U përmenden akuza andaj e këndeje, por lëri ato gjëra sepse janë organet kompetente që merren me ato gjëra e që kurdo që ata mendohet se janë plotësuar kushtet për të vazhduar tutje ata vazhdojnë vetë, nuk ecin me inercion, unë namin disa do t'i fusja në burg po të mundja por nuk mundem sepse nuk jam organ unë që i fus në burg, po të më pyesnin ndoshta do të flisja ndonjë fjalë të keqe për ta mirëpo ata nuk i fusin në burg veç pse unë e flas ndonjë fjalë të keqe, prandaj bëhuni më serioz, i themi dhe i diskutojmë të gjitha sepse unë besoj që edhe ju mendoni për të mirën e kësaj

Komune sikurse ne, sot jemi ne këtu, më, parë keni qenë ju atje, i kemi pasë rolet e ndryshme, unë herë atje herë këtu, është mirë me ditë edhe qysh mu sjellë nganjëherë, kështu që është mirë të thuhet gjërat bardh e zi ashtu qysh janë. A kemi progres, po, u përmend disa herë që ka papastërti, është shumë e vërtetë që as unë nuk jam i kënaqur por a është shumë më mirë se sa ka qenë më parë zotëri Ekrem, duhet ta pranojmë se jemi shumë më mirë. A kemi problemi, po kemi sikurse që po përmendën tani gropat nëpër rrugë e që tani u njoftova se janë duke u mbyllur dhe janë 10 dit afat për t'i mbyll ato gropa.

Po ashtu kemi telashe me disa prej kompanive të cilat vërtetë kanë qenë kompani me emër, serioze por që tash së fundmi kanë probleme, a financiare apo me resurse humane nuk e di por problem është, kurse në anën tjetër shumë prej këtyre kompanive besoni që nganjëherë edhe pa dëshirën tonë arrijnë deri te nënshkrimi i kontratës, pra ndoshta nga Komuna nuk përzgjedhet por në rrugë tjera ligjore nëpër OSHP e Gjykata vijnë deri te lidhja e kontratës.

Nuk është lehtë të menaxhohet në veçanti tani në këtë vit që sapo kemi hyrë ku minimalisht rreth 30% janë çmimet më të rritura në shumë prej këtyre kategorive të shpenzimeve, mirëpo punët duhet të kryhen sepse kemi shumë kontrata dy vjeçare që janë nënshkruar në vitin e kaluar.

Unë shpresoj shumë dhe lutem që niveli qendrorë të bëjë diçka në këtë aspekt sikurse në kohën e Pandemisë që ka pas ndihma kompanive sepse po vazhdoi në këtë formë unë kam frikën që shumë prej punëve dhe projekteve nuk do të mund t'i realizojmë sepse siç e thash ka rritje enorme të çmimeve në shumë fusha e në veçanti te ndërtimtaria, prandaj 1 m³ asfalt apo qysh shkojnë ato, që është blerë para 3 muajve me një çmim tjetër sot është tjetër çmim, ashtu betoni, hekuri e të tjerat, pra në çdo gjë ka rritje të çmimeve.

Ejani të punojmë bashkë në interes të qytetarëve, vërejtjet që janë me vend i marrim me kënaqësinë më të madhe, sugjerimet që janë të mira po ashtu i marrim parasysh, mirëpo në interes të përgjithshëm ju thërras ta kemi një pikë të përbashkët, ndërsa kështu në aspektin politik mendoj se kemi kohë edhe rreth 3 vite e gjysmë, fillojmë atë vitin e fundit bëjmë politikë sepse besoj që mjaftueshëm është atëherë ngase po të fillojmë tani herët është, lodhemi dhe dikur kur vie koha për të bërë politikë atëherë nuk mundemi.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, konsideroj diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës përfunduar qoftë nga radhët e anëtarëve të Kuvendit qoftë nga Ekzekutivi i Komunës, kështu që raporti financiar ishte ai se çfarë ka ndodh në vitin e kaluar dhe meqë këto raporte nuk votohen, unë e konstatoj të përfunduar diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës, dhe njëkohësisht meqë disa herë kishte kërkesa për pauzë, nëse pajtoheni shkojmë në pauzë për 1 orë, pra deri në ora 13:30 ku vazhdojmë me këtë mbledhje.

U konstatua e përfunduar kjo pikë e rendit të ditës.

Kuvendi shkon në pauzë, (ora 12:30). Njëkohësisht Kryesuesi i Kuvendit cakton kohën e vazhdimin të kësaj seance sot nga ora 13:30.

Pas pauzës, mbledhja vazhdon në ora 14:00.

Vazhdimin e mbledhjes e hapi dhe e kryesoi z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit.

Të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV: Adelinë Stublla; Artrit Mulliqi; Fatri Zhitija; Kasib Bashota; Florent Hasani; Valdet Kamerolli; Arbrim Konushevc; Flandra Kadriu; Luljeta Muçolli-Azemi; Vlora Jashanica; Haki Rudari; Abedin Zeka; Avni Islami; Qëndresë Hajrizi; Ardi Hasani.

Nga LDK: Enis Shabani; Alisa Jetullahu; Enis Dërvisholli; Besim Latifi; Valdet Restelica; Blerta Azemi-Berisha; Valon Demolli; Ekrem Rrahmani; Ermal Osmani; Gresa Qosa-Maqastena; Arben Xhemajli; Arnisa Sylejmani; Isak Ejupi.

Nga PDK: Isak Shabani-Kryesues i Kuvendit; Lulzim Pollomi; Mimoza Abdullahu; Rinesa Goxhufi,

Nga GUXO: Demokrat Hodolli.

Nga Unioni i Blakçorve: Gentrif Arifi.

Nga AAK: Baki Feta, i cili mungoi pas lirim të tij nga kjo seancë për arsye shëndetësore.

Gjithashtu të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes nga Ekzekutivi i Komunës ishin, z.Fahri Restelica, Nënkryetar i Komunës, U.D. drejtorët/shat e Drejtorive të Komunës, dhe atë;

(Ditjona Statovci-Drejtoria e Administratës DA; Arbnoorë Uka Osmani-Drejtoria e Buxhetit dhe Financave DBF; Avni Fetahu-Drejtoria e Arsimit DKA; Lirie Hoti Rama-Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Saranda Stublla-Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Bahri Selimi-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSH; Shuajb Blakçori-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSH; Behram Latifi-Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE).

Të pranishëm ishin edhe, përfaqësues media lokale (TV Llapi), dhe disa zyrtar komunal.

Kryesuesi i Kuvendit, e hapi vazhdimin e mbledhjes duke konstatuar kuorumin ku prezent në sallë për momentin ishin 34 anëtarë/e të Kuvendit, theksoi, vazhdojmë me pikën e radhës të rendit të ditës.

3. Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësitë kadastrale P-00706-0 dhe P-00704-0, Zona Kadastrale Llapashticë e Poshtme

3.1. Propozim vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim

znj.Saranda Stublla-Uka, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, pra si propozim vendim kemi miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës Njësitë kadastrale P-00706-0 dhe P-00704-0, Zona Kadastrale Llapashticë e Poshtme dhe kërkoj nga ana juaj që ta përkrahni këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, të nderuar koleg e hapi debatin rreth kësaj pike të rendit të ditës, urdhëroni kush dëshiron të marrë fjalën.

znj.Qëndresë Hajrizi, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së, shprehim përkrahjen tonë për këtë propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, ne besojmë se realizimi i këtij vendimi do të sjell zhvillim ekonomik lokal, do të rris të hyrat vetanake të Komunës dhe do të krijoj mirëqenie për qytetarët, andaj për këto arsye ne e mbështesim.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, ne jemi kundër dhënies në shfrytëzim të kësaj prone për shkak se kjo pronë po falet për 99 vite, po ashtu në material kemi një objekt dhe nuk e di se a është shtëpi apo çfarë objekti është e që për atë objekt është dashur të bëhet një shpjegim nga ana e Komunës sepse ata që janë të interesuar për të marrë në shfrytëzim këtë pronë po hezitojnë shkak i këtij objekti sepse po dyshojnë se është një kontest gjyqësor.

Pse të jepet në shfrytëzim 99 vite kur ne e dimë që prej vitit në vit po ndryshojnë çmimet dhe po lëviz qyteti, për 99 vite unë personalisht nuk e votoj me mbet në procesverbal që kam votuar për dhënie në shfrytëzim të ndonjë prone për 99 vite, pas 99 viteve ndoshta qyteti zgjerohet dhe deri atje shkon, pse me ia mundësuar atij aty, që kolegeje e tha për investime dhe me pas të hyra Komuna, nuk e di unë çka planifikohet aty edhe kush dëshiron me marrë në shfrytëzim atë, por Komuna është dashur së paku me dhënë në shfrytëzim për 30 vite e jo 99 vite sepse s'ka kuptim ngase kjo i bie sikur me falë një pronë, aty janë 10 ha dhe kështu që ne jemi kundër.

znj.Mimoza Abdullahu, theksoi, sot para nesh kemi katër propozime për dhënie në shfrytëzim të pronave të paluajtshme komunale, këto nuk janë propozime thjeshtë vetëm procedurë administrative por janë vendime me rëndësi strategjike për zhvillimin e Komunës tonë.

Qëllimi kryesor është shfrytëzimi racional dhe afatgjatë i pronës publike përmes investimeve kapitale dhe aktiviteteve afariste që sjellë vlerë të shtuar për qytetarët, kjo nënkupton krijimin e vendeve të reja të punës, rritjen e aktivitetit ekonomik lokal si dhe përmirësimin e shërbimeve dhe infrastrukturës në interes të përgjithshëm publik. Përmes këtyre dhënies në shfrytëzim Komuna nuk humb prona, përkundrazi ajo e aktivizon atë, e bënë funksionale dhe përfiton drejtpërdrejtë nga zhvillimi që gjëndërohet, përfitimet janë të shumëfishta si të hyra të rregullta buxhetore, zhvillim ekonomik lokal, partneritet në sektorin privat dhe ngritjen e cilësisë për jetën e qytetarit.

Po ashtu është shumë e rëndësishme që këto procese të shoqërohen në transparencë dhe llogaridhënie, andaj ne presim dhe kërkojmë që secilën pronë të dhënë në shfrytëzim Komuna të ketë raporte të rregullta vjetore mbi performancën, investimet e realizuara dhe përfitimet konkrete që i kthehen qytetarëve, duke i vlerësuar këto si hapa të drejtë ne në funksion të zhvillimit dua të theksoi se qëndrimi i këshilltarëve të PDK-së është Për.

Ne i mbështesim këto 4 pika të rendit të ditës që kanë të bëjnë me këto prona sepse besojmë që janë në interes të drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe të ardhmes ekonomike të Komunës tonë.

znj.Saranda Stublla-Uka, U.D. drejtoresh e DPKGJ, theksoi, po ndalem te asamblisti z.Ekrem Rrahmani që tha se është në kontest gjyqësor, ne nuk kemi informata prej përfaqësuesit të Komunës që ka kontest gjyqësor aty, por nëse ky ka diçka mund të na njoftosh më konkretisht.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, e thash pak më qartë, sipas vizatimit aty gjendet një objekt në atë pronë të Komunës dhe dihet se objektin e ka ndërtuar dikush ilegalisht, tash me vetë faktin që ekziston objekti dhe ai që dëshiron me marrë atë pronë në shfrytëzim nuk dëshiron të konfrontohet me dikë që e ka ndërtuar atë objekt. Për mendimin tim Komuna është dashur ta rrënoj atë objekt ose ta kufizoj atë parcelë e të tregoj se është pronë komunale dhe ata që dëshirojnë me marrë atë pronë në shfrytëzim mos të kenë probleme, përndryshe unë kam takuar individ që kanë shprehë dëshirë ta marrin në shfrytëzim atë parcelë mirëpo ata kanë dyshime shkak i atij objekti dhe kur më kanë pyetur a ka kontest unë ju kam thënë nuk e di, prandaj unë e thash se ka qenë dashur të sqarohet ky problem, të rrënohet ai objekt e të tregohet që ajo është pronë komunale dhe që ka të drejtë kushdo që dëshiron ta marrë në shfrytëzim.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, nëse s'ka diskutime tjera atëherë e vë në votim këtë pikë të rendit të ditës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 34 anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 20 vota Për, 13 vota Kundër, asnjë votë Të Përmbajtur, (një nuk votoi), miratohet Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës -Njësitë kadastrale P-00706-0 dhe P-00704-0, Zona Kadastrale Llapashticë e Poshtme, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, si nën pikë e rendit të ditës siç e dini për çdo pronë të paluajtshme që është për dhënie në shfrytëzim duhet të bëhen edhe komisionet vlerësuese, andaj në materiale e keni edhe përbërjen e tyre e që për këtë fjalën ia kaloj drejtoreshës së DPKGJ-së.

znj.Saranda Stublla-Uka, U.D. drejtoresh e DPKGJ, theksoi, si pikë e rendit të ditës e kemi edhe Propozim vendimin për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës Njësitë kadastrale P-00706-0 dhe P-00704-0, Zona Kadastrale Llapashticë e Poshtme, andaj nga Ekzekutivi i Komunës me propozim të Kryetarit është z.Bahri Selimi dhe znj.Arbnorë Uka, ndërsa sa i përket OJQ-ve, ne si Drejtori kemi bërë thirrje për aplikim ku gjithsej kanë aplikuar 5 OJQ, mirëpo nuk i kanë specifikuar numrat e parcelës. Një sqarim shtesë është znj.Selvete Sejdiu e ka dërguar vetëm CV-në, ne ia kemi kërkuar edhe letrën motivuese por nuk ka arrit me kohë ta plotësoj atë, pra nga OJQ-të kemi Selvete Sejdiu, Vjollca Breznica, Shqipdon Rushiti, Nazife Gashi dhe Shukrije Neziri.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, në bazë të kësaj po shohë që përbërja e komisionit është prej 5 anëtarëve, ne paraprakisht u konsultuam me shefat e Grupeve të këshilltarëve dhe në bazë të asaj që shihet këtu do bëhen propozimet e anëtarëve nga Ekzekutivi dhe pasi që janë 4 propozime ne u pajtuam që në secilin propozim të jenë anëtar nga LVV, nga LDK dhe anëtar nga PDK, mirëpo në bazë të bisedës që kam pasë me shefin e Grupit të LDK-së për dy propozimet e para nuk kanë kandidatë, kurse për dy propozimet tjera kanë kandidatët e tyre, prandaj ju kisha lutur që të kalojmë në propozime.

znj.Saranda Stublla-Uka, U.D. drejtoresh e DPKGJ, theksoi, nga Ekzekutivi i Komunës propozojmë z.Bahri Selimi dhe znj.Arbnorë Uka për këtë propozim të miratuar paraprakisht.

z.Haki Rudari, theksoi, nga Grupi i këshilltarëve të LVV-së për këtë komision vlerësues propozojmë kolegun z.Artrit Mulliqi.

z.Lulzim Pollomi, theksoi, në emër të PDK-së propozojmë znj.Rinesa Goxhufi.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, janë 5 anëtar për komisione dhe për anëtarët nga OJQ-të, unë betohem në Zot që nuk e njoh asnjërin prej tyre, por pasi që janë lexuar 5 emra ju kisha lut nëse pajtoheni ashtu siç janë lexuar emrat prej 1-5, vetëm i rendisim në kuadër të këtyre komisioneve nëse veç ndokush nuk ka diçka kundër, nëse po urdhëroni.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, këtu tani duhet të specifikohet se kush është për cilën pjesë dhe këtu njëra prej CV që pash ishte Vjollca Breznica dhe nuk e di a bëhet fjalë për personin që e njohë unë apo dikë tjetër sepse mund të jetë dikush tjetër, kjo ka qenë në listë të LVV-së si kandidate për asamble, është edhe drejtoresh e shkollës, kurse tani na del që paska edhe OJQ siç është propozuar.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, pasi që aplikimin e kemi të kufizuar, nuk kemi çka t'i kontestojmë sepse kanë ardhë në emër të OJQ-ve, kështu që unë kisha lexuar emrat që u propozuan për këtë komision; Bahri Selimi, Arbnorë Uka, Artrit Mulliqi, Rinesa Goxhufi, Selvete Sejdiu, kush është për që këta të jenë anëtar/e të këtij komisioni sipas propozim vendimit përkatës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 34 anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 20 vota Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë Të Përmbajtur, (të tjerët nuk votuan), miratohet Propozim vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës -Njësitë kadastrale P-00706-0 dhe P-00704-0, Zona Kadastrale Llapashticë e Poshtme, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, dhe me këtë përbërje:

Bahri Selimi, nga Ekzekutivi i Komunës

Arbnorë Uka-Osmani, nga Ekzekutivi i Komunës

Artrit Mulliqi, nga Kuvendi i Komunës

Rinesa Goxhufi, nga Kuvendi i Komunës

Selvete Sejdiu, nga sektori joqeveritar lokal

4. Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-202-3, Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm

4.1. Propozim vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim

znj.Saranda Stublla-Uka, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, në rend dite kemi Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës Njësia kadastrale P-202-3, Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm andaj nga ana juaj kërkoj që ta përkrahni.

z.Abedin Zeka, theksoi, në emër të Grupit të asamblistëve të LVV-së, dua të theksoi disa arsye thelbësore pse ky propozim duhet të mbështetet, së pari është në interes publik të qytetarëve, prona komunale siç e tha dikush më herët nuk është pronë e askujt individualisht, ajo është pasuri e përbashkët e qytetarëve, pra ky propozim vendim synon pikërisht që këtë pasuri ta kthej në pasion të dobisë së qytetarëve duke e aktivizuar atë për zhvillim, shërbime, investime që ndryshe do të mbeteshin të bllokuara. Së dyti zhvillim lokal dhe ekonomik, sepse mos shfrytëzimi i pronave komunale është humbje e drejtpërdrejtë për Komunën prandaj duke e dhënë në shfrytëzim këtë pronë ne krijojmë mundësi për hapje të vendeve të punës, rritje të aktivitetit ekonomik lokal dhe përmirësimin e jetës së banorëve të asaj zone. Ky është një hap konkret drejt një komune më funksionale dhe më zhvilluese.

Së treti transparencë dhe llogaridhënie, ky vendim nuk po merret për arsye të njëanshme por po kalon nëpër Kuvend përmes debatit dhe votës suaj, kjo garanton se çdo vendim është i hapur, i diskutuar dhe i përgjegjshëm ndaj qytetarëve të Komunës tonë. Së katërti përgjegjësi institucionale, si përfaqësues i qytetarëve ne e kemi për obligim të mos e lëmë pronën publike të degradoj apo të mbetet e pa shfrytëzuar apo të bëhet deponi ilegale e mbeturinave nga disa njerëz fatkeqësisht të pa ndërgjegjshëm. Mosveprimi është gjithashtu vendim dhe shpeshherë i dëmshëm. Së pesti, precedent pozitiv për të ardhmen, miratimi i këtij propozimi vendos një standard të ri që çdo aset publik duhet të ketë funksion, vlerë dhe ndikim konkret për jetën e qytetarëve.

Të nderuar koleg, sot nuk po votojmë vetëm për disa parcela apo për një procedurë, por po votojmë për mënyrën se si ta konceptojmë zhvillimin e Komunës tonë, andaj në emër të Grupit të LVV-së ju ftoj që ta mbështesni këtë propozim vendim me votën tuaj si një hap drejtë, të arsyeshmes dhe në shërbim të qytetarëve të Komunës tonë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, siç e thash edhe dje në mbledhje të KPF-së, edhe sot po dal këtu dhe po e sqaroj pse ne nuk votojmë për, këtu prona në Lupç ka afërsisht 14 ha, dhe me Ligjin nr.06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës, i jepet e drejta Kryetarit të jap këtë pronë në shfrytëzim me negociim, tani po lexoj edhe rastet kur Kryetari i Komunës mundet me i dhënë vetë këto prona pasi që ai t'i negocioj këto prona e pastaj t'i sjellë në Kuvend që të kalojnë për miratim, e jo t'i fut në konkurrencë. Në këtë rast ne e dimë që është përmend një fabrikë që prodhon autobus e kjo nuk e di a ka qenë për fushatë apo jo, për mua ndërtimi i asaj fabrike nuk ka qenë e vërtetë se por ka qenë gënjeshtër sepse këtu nuk janë prodhuar autobusë kurrë.

Pra Ligji ia mundëson Kryetarit të Komunës me dhënë në shfrytëzim në këto raste, në rast kur vlera e investimit është së paku 10% e buxhetit të përgjithshëm për investime kapitale të Komunës të vitit paraprak por jo më shumë se vlera minimale e përcaktuar me ligjin për investime strategjike në Republikën e Kosovës, që i bie se në vitin paraprak ne kemi pasë investime kapitale rreth 9 milion euro e që atij investitori i bie të investoj rreth 900,000.00€, Kryetari i Komunës duhet të negocioj këtë pronë. Pika e dytë thotë, në rast kur një investitor ka shpreh intersimin për hapjen e një biznesi në interes të komunës e që mendoj se nëse vie ai dhe hapë një fabrikë këtu dhe i plotëson kushtet që Kryetari negocion për këtë pronë, dhe nuk e di pse po i ikë përgjegjësisë.

Në rastin e tretë, kur nuk ka interesim në marrjen e pronës së Komunës në shfrytëzim nga palët së paku tri vite, edhe këtë e plotëson sepse ne e dimë që brenda tri viteve këtë pronë nuk e ka marrë askush në shfrytëzim.

Arsyeja e katërt është dhënia në shfrytëzim për 99 vite, unë prapë nuk po e kuptoj pse, unë e di që ligji e mundëson për 99 vite dhënia në shfrytëzim këtë pronë por që për mendimin tim është shumë e gabuar dhe se maksimumi që është dashtë me dhënë në shfrytëzim këtë pronë është 30 vite, e jo 99 vite sepse po i bie që kur ne të marrim këtu vendim sot, edhe ata që lindin sot do të vdesin dhe nuk e presin që të kaloj aj afat, si dhe nuk e dimë ne pas 10 viteve që ajo pronë në Lupç sot e ka vlerën 50€ deri 100€ për ari, kurse pas 50 viteve qysh e dimë ne e sidomos gjenerata ime çfarë ndryshimi ka pasë prej vitit 1990 e këndeje. Një vend ku e ke pasë ndoshta një ari ka pasë vlerë 50€ sot aty vlera e një ari toke është 100,000.00€, kaq ndryshim ka pasë dhe në këtë aspekt jam kundër.

znj.Saranda Stublla-Uka, U.D. drejtoresh e DPKGJ, theksoi, edhe në pikën e tretë që e përmendi **z.Ekrem Rrahmani** që po i falet prona, mund të them se prona e Komunës nuk falet, nuk privatizohet, por lidhet kontrata, janë kushtet kontraktuale të cilat ceken në kontratë, aty shumë mirë thotë nëse nuk i përmbush kushtet dhe nëse komuna e ka të specifikuar ndonjë projekt madhor për qytetin mund të bëjë shkëputjen e kontratës, asnjëherë pronat e komunës nuk janë privatizuar dhe nuk privatizohen.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, nuk thash që po falen, por 99 vite është sikur me ia falë, dhe unë thash nëse ai ka shprehë interesim me hapë fabrikë pse të futet në konkurrencë kur këtu ishte fjala kur ligji ia jep të drejtën Kryetarit të Komunës të negocioj këtë pronë dhe ta sjellë pastaj në Kuvend vetëm për miratim, përndryshe rrena janë ato që aty do ndërtohet fabrikë. Nëse ti e futë në negociim i bie që ti atij nuk po i jep përparësi, a e din qysh është kjo punë me fol më thjeshtë e thash edhe dje njëjtë sikur dikush që dëshiron me i mbajt 100 copa dhenë dhe i merr ata 154 ha për kullosë e ju po e shtini në konkurrencë me atë që e ndërton një fabrikë, në këtë rast ju keni thënë që do të punësohen 600 deri në 2000 punëtor. Unë e thash nëse ligji atij ia mundëson me negociim dhe me ia dhënë atë pronë në shfrytëzim pse Kryetari i Komunës nuk e ka sjellë në Kuvend me kalu e mos me fut në konkurrencë, pra me ia lehtësu atij biznesi punën e me pas ai të qartë që mos me i hi procedurave, por me negociim me Kryetarin me sjellë në Kuvend me kalu, kaq thash unë.

znj.Saranda Stublla-Uka, U.D. drejtoresh e DPKGJ, theksoi, përveç që po thua me negociim të Kryetarit ligji ia lejon edhe me ankand publik andaj ne kemi zgjedhë me sjellë me ankand publik që ia mundëson të gjithëve të aplikojnë e pastaj komisioni e bën përzgjedhjen.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 34 anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 21 vota Për, 12 vota Kundër, asnjë votë Të Përmbajtur, (një nuk votoi), miratohet Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës Njësia kadastrale P-202-3, Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, siç u theksua më herët të gjithë e dimë se për çdo pronë për dhënie në shfrytëzim duhet të formohen edhe komisionet, atëherë fjala është e juaja.

znj.Saranda Stublla-Uka, U.D. drejtoresh e DPKGJ, theksoi, për propozim vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës Njësia kadastrale P-202-3, ZK Lupç i Poshtëm, nga ana e Ekzekutivit të Komunës me propozim të Kryetarit kemi znj.Valbona Ibishi-Azemi dhe z.Shuajb Blakçori.

z.Haki Rudari, theksoi, nga grupi i këshilltarëve të LVV-së ne propozojmë z.Kasib Bashota.

z.Lulzim Pollomi, theksoi, në emër të PDK-së e propozojmë znj.Mimoza Abdullahu.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, përfaqësuesi nga OJQ-ja është në renditje znj.Vjollca Breznica, atëherë në bazë të propozimeve të bëra këta janë emrat e propozuar për këtë komision, znj.Valbona Ibishi-Azemi dhe z.Shuajb Blakçori nga Ekzekutivi i Komunës, z.Kasib Bashota, nga Kuvendi i Komunës, znj.Mimoza Abdullahu nga Kuvendi i Komunës, znj.Vjollca Breznica nga sektori joqeveritar lokal, andaj e vë në votim këtë që këta emra të jenë anëtar/e të këtij komisioni sipas propozim vendimit përkatës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 34 anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 19 vota Për, 1 votë Kundër, asnjë votë Të Përmbajtur, (të tjerët nuk votuan), miratohet Propozim vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës -Njësia kadastrale P-202-3, Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, dhe me këtë përbërje:

znj.Valbona Ibishi-Azemi, nga Ekzekutivi i Komunës

z.Shuajb Blakçori, nga Ekzekutivi i Komunës

z.Kasib Bashota, nga Kuvendi i Komunës

znj.Mimoza Abdullahu, nga Kuvendi i Komunës

znj.Vjollca Breznica, nga sektori joqeveritar lokal

5. Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës -Njësia kadastrale P-1339-0, Zona Kadastrale Orllan

5.1. Propozim vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim

znj.Saranda Stublla-Uka, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, kemi këtë propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës Njësia kadastrale P-1339-0, Zona Kadastrale Orllan, andaj nga ana juaj kërkoj që ta përkrahni edhe këtë pikë të rendit të ditës.

znj.Luljeta Muqolli-Azemi, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, e përkrahim iniciativën për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës Njësia kadastrale P-1339-0, Zona Kadastrale Orllan.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, në emër të Grupit të asamblistëve të LDK-së e përkrahim këtë propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës Njësia kadastrale P-1339-0, Zona Kadastrale Orllan.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, atëherë e vë në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njësëri me 33 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës Njësia kadastrale P-1339-0, Zona Kadastrale Orllan, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, tani sipas radhës duhet të bëhen edhe propozimet për anëtar të komisioni, prandaj fjalën i'a kaloj drejtoreshës së DPKGJ.

znj.Saranda Stublla-Uka, U.D. drejtoresh e DPKGJ, theksoi, tani kemi propozim vendimin për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës Njësia kadastrale P-1339-0, Zona Kadastrale Orllan, dhe me propozim të Kryetarit nga ana e Ekzekutivit të Komunës është z.Vigan Salihu dhe znj.Ditjona Statovci.

znj.Adelina Stublla, theksoi, nga Grupi i këshilltarëve të LVV-së ne propozojmë z.Haki Rudari.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, nga Grupi i këshilltarëve të LDK-së ne propozojmë z.Isak Ejupi.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, me radhë përfaqësues nga OJQ-ja është z.Shqipdon Rushiti, atëherë në bazë të propozimeve që bëtë janë këta emra të propozuar për këtë komision, z.Vigan Salihu dhe znj.Ditjona Statovci nga Ekzekutivi i Komunës, z.Haki Rudari dhe z.Isak Ejupi nga Kuvendi i Komunës, z.Shqipdon Rushiti nga sektori joqeveritar lokal, andaj e vë në votim që këta emra të jenë anëtar/e të këtij komisioni sipas propozim vendimit përkatës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njësëri me 33 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet Propozim vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës -Njësia kadastrale P-1339-0, Zona Kadastrale Orllan, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, dhe me këtë përbërje:

z.Vigan Salihu, nga Ekzekutivi i Komunës

znj.Ditjona Statovci, nga Ekzekutivii i Komunës

z.Haki Rudari, nga Kuvendi i i Komunës

z.Isak Ejupi, nga Kuvendi i Komunës

z.Shqipdon Rushiti, nga sektori joqeveritar lokal

6. Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00459-0, Zona Kadastrale Podujevë

6.1. Propozim vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim

znj.Saranda Stublla-Uka, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë- DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, në këtë seancë si pikë të rendit të ditës kemi edhe propozim vendimin për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës Njësia kadastrale P-00459-0, Zona Kadastrale Podujevë, pra kemi të bëjmë me dy lokale të cilat janë të vendosura në këtë parcelë në rr."Skënderbeu" andaj kërkoj nga ana juaj që ta përkrahni këtë pikë të rendit të ditës.

z.Florent Hasani, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e mbështesim këtë propozim vendim.

z.Valdet Restelica, theksoi, ne Grup i LDK-së e përkrahim propozim vendimin për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës Njësia kadastrale P-00459-0, Zona Kadastrale Podujevë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, edhe unë e përkrahi këtë por kam një kërkesë sepse ne e kemi pasë disa herë këtë pronë këtu për dhënie në shfrytëzim dhe nuk i ka marrë askush në shfrytëzim këto dy lokale që gjinden në rr."Skënderbeu", unë e bëra si propozim se a ka mundësi që Komuna t'i rregulloj këto lokale që pastaj t'i marr dikush në shfrytëzim sepse ato lokale kanë mbet ashtu dhe se komuna nuk ka marrë asnjë të mirë prej tyre, andaj me pak para të rinovohen nga Komuna e pastaj t'i jap në shfrytëzim sepse janë në vend shumë të mirë dhe nuk e di pse kanë mbet ashtu. Nuk kam qenë pjesë e komisionit por sigurisht nuk ka aplikuar askush, andaj them t'i rinovojmë e t'i rregullojmë ato lokale e pastaj t'i lëshojmë me qira.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, nëse dikush dëshiron me marrë fjalën urdhëroni nëse jo atëherë e vë në votim këtë pikë të rendit të ditës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njësëri me 34 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent, miratohet Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës -Njësia kadastrale P-00459-0, Zona Kadastrale Podujevë, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, tani kemi formimin e komisionit ku fjalën ia kaloj znj.Saranda Stublla, U.D. drejtoresh e DPKGJ.

znj.Saranda Stublla-Uka, U.D. drejtoresh e DPKGJ, theksoi, me propozim të Kryetarit nga ana e Ekzekutivit të Komunës anëtar të këtij komisioni kemi znj.Lirie Hoti-Rama dhe z.Behram Latifi.

z.Florent Hasani, theksoi, nga radhët e LVV-së ne propozojmë znj.Qëndresa Gashi-Hajrizi.

z.Valdet Restelica, theksoi, nga radhët e LDK-së ne propozojmë znj.Gresa Qosa-Maqastena.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, atëherë në bazë të propozimeve që u bënë janë këta emra të propozuar për këtë komision, znj.Lirie Hoti-Rama dhe z.Behram Latifi nga Ekzekutivi i Komunës, znj.Qëndresë Hajrizi dhe znj.Gresa Qosa-Maqastena nga Kuvendi i Komunës, znj.Nazife Gashi nga sektori joqeveritar lokal, andaj pa humbur kohë e vë në votim që këta emra të propozuar të jenë anëtar/e të komisionit në fjalë sipas propozim vendimit përkatës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njësëri me 31 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet Propozim vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës -Njësia kadastrale P-00459-0, Zona Kadastrale Podujevë, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, dhe me këtë përbërje:

znj.Lirie Hoti-Rama, nga Ekzekutivi i Komunës

z.Behram Latifi, nga Ekzekutivi i Komunës

znj.Qëndresë Hajrizi, nga Kuvendi i Komunës

znj.Gresa Qosa-Maqastena, nga Kuvendi i Komunës

znj.Nazife Gashi, nga sektori joqeveritar lokal

7. Propozim vendim për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush ka propozime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

znj.Vlora Jashanica, nga radhët e LVV-së propozoi znj.Adelina Stublla dhe z.Fatri Zhitija.

z.Enis Dervisholli, theksoi, në emër të Grupit të LDK-së propozojmë z.Valdet Restelica.

z.Fatri Zhitija, theksoi, meqenëse duhet të jenë vetëm dy anëtarë, atëherë unë tërhiqem nga propozimi, le të mbesin znj.Adelina Stublla nga LVV dhe z.Valdet Restelica nga LDK-ja.

znj.Saranda Stublla-Uka, U.D. drejtoresh e DPKGJ, theksoi, me propozim të Kryetarit për anëtar të komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës kemi z.Avni Fetahu dhe z.Ahmet Ahmeti.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, si përfaqësuese nga radhët e OJQ-së ka mbet znj.Shukrije Neziri, atëherë në bazë të propozimeve që u bënë emrat e propozuar për këtë komision janë znj.Adelina Stublla dhe z.Valdet Restelica nga Kuvendi i Komunës, z.Avni Fetahu dhe z.Ahmet Ahmeti nga Ekzekutivi i Komunës, znj.Shukrie Neziri nga sektori joqeveritar lokal, andaj pa humbur kohë i vë në votim që këta emra të janë anëtar/e të këtij komisioni sipas propozim vendimit në fjalë.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 34 anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 32 vota Për, 2 vota Kundër, miratohet Propozim vendimi për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, dhe me këtë përbërje:

znj.Adelina Stublla, nga Kuvendi i Komunës

z.Valdet Restelica, nga Kuvendi i Komunës

z.Avni Fetahu, nga Ekzekutivi i Komunës

z.Ahmet Ahmeti, nga Ekzekutivi i Komunës

znj.Shukrie Neziri, nga sektori joqeveritar lokal

8. Propozim vendim për dhënie në shfrytëzim afatgjatë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, objektin e ish Emergjencës së Qytetit

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, theksoi, për këtë pikë të rendit të ditës ftoj propozuesen znj.Lirie Hoti-Rama, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS të bënë prezantimin e kësaj pike.

znj.Lirie Hoti-Rama, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, sot në cilësinë e drejtoreshës së DSHMS-së para jush prezantoj propozim vendimin për dhënie në shfrytëzim afatgjatë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, objektin e ish Emergjencës së Qytetit.

Dhënia në shfrytëzim e këtij objekti shëndetësor ka për qëllim shfrytëzimin e të njëjtit për nevojat e Qendrës së Shëndetit Mendor në Podujevë pasi që është vlerësuar se ofron kushte më të përshtatshme për kryerjen e shërbimeve përkatëse për shëndetin mendor.

Zhvendosja e objektit të Qendrës së Shëndetit Mendor në Podujevë bëhet për arsye se ish objekti i saj është rrethuar si rezultat i realizimit të projektit të Qendrës Rezidenciale apo Shtëpisë për të Moshuarit. Afati kohor për dhënien e këtij objekt në shfrytëzim është afat afatgjatë prej 30 vitesh.

Lidhur me këtë dhënie në shfrytëzim para jush në dokumentacionin të cilin e keni në material keni të bashkëngjitur edhe vendimin e QKMF-së apo i Këshillit Drejtues të QKMF-së ku thuhet se ky objekt tashmë nuk nevojitet për nevojat dhe shfrytëzim të QKMF-së, gjithashtu bashkëngjitur në dokumentacion tuaj keni edhe kërkesën nga SHSKUK për dhënie në shfrytëzim të të njëjtit objekt, andaj duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj çështje ju ftoj dhe ju lus që ta përkrahni këtë pikë, dhe duke ju falënderuar edhe njëherë për kontributin tuaj mbetëm e hapur për pyetjet tuaja.

z.Arbrim Kunushëci, theksoi, sot para nesh kemi një propozim vendim të cilin e citoj paraprakisht drejtoresha znj.Lirie Hoti e që për mendimin tim nuk është vetëm një vendim teknik por është thellësisht i lidhur me dinjitetin e shërbimeve shëndetësore dhe trajtimin që ne e ofrojmë për qytetarët tanë e dimë mirë, por që drejtoresha e citoj se Qendra e Shëndetit Mendor kohën e fundit ka hasë në disa vështirësi dhe në disa sfida, fillimisht kohën e fundit duke humbur edhe objektin e saj dhe duke u detyruar të funksionoj në një objekt tjetër që mendoj se nuk i përmbush standardet minimale për ofrimin e shërbimeve cilësore që është dashur t'i ofroj si institucion.

Kjo është çështje e kujdesit ndaj një kategorie shumë të ndjeshme të shoqërisë sonë e cila me të vërtetë e meriton një trajtim dinjitoz dhe profesional. Objekti aktual ku kjo Qendër e ushtron profesionin e saj nuk i plotëson kushtet dhe ky është një realitet që ne nuk duhet ta anashkalojmë, përkundrazi ne sot kemi një mundësi konkrete për ta korrigjuar këtë gjendje dhe dhënia në shfrytëzim e ish objektit të Emergjencës është një hap i drejtë i arsyeshëm dhe jashtëzakonisht i domosdoshëm, është investim në shëndetin publik dhe një dëshmi që institucionet tona marrin vendim në interes të qytetarëve, prandaj ju ftoj sot që përtej dallimeve politike ta mbështesim këtë propozim dhe ta japim njëherit një mesazh të qartë se kujdesi për shëndetin mendor nuk është një prioritet dytësor por është një përgjegjësi e përbashkët, prandaj në emër të Grupit parlamentar të LVV-së e mbështesim fuqishëm propozim vendimin për dhënie në shfrytëzim afatgjatë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, objektin e ish Emergjencës së Qytetit.

znj.Blerta Azemi-Berisha, theksoi, në emër të LDK-së, shprehim mbështetjen tonë të plotë për dhënie në shfrytëzim afatgjatë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, objektin e ish Emergjencës së Qytetit, e mbështesim këtë pikë të rendit të ditës me qëllim se është një pikë e cila është me rëndësi të veçantë për të gjithë komunitetin tonë sepse siç e dimë shëndeti mendor është po aq i rëndësishëm sa shëndeti fizik.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, parimisht edhe unë e përshëndeti dhe e përkrahi këtë propozim meqenëse është propozim për dhënie në shfrytëzim për 30 vite parimisht është në rregull sepse kjo kategori e njerëzve ka mbet keq, mirëpo ne duhet të mendojmë në afat sa më të shkurt për shkak të nevojave specifike që ka ajo kategori e njerëzve dhe gjithashtu për shkak të pozicionimit të objektit, pra është mirë të mendohet që në afat sa më të shkurtër t’iu bëhet zgjidhje e përhershme dhe të bëhet një objekt nga fillimit i cili i përmbush nevojat e kësaj kategorie të shoqërisë.

z.Isak Ejupi, theksoi, kam nevojë për një sqarim e nderuara drejtoresh e DSHMS se a është ky objekt që do të jepet vetëm për pacientët e Komunës tonë apo meqenëse ka të bëjë me SHSKUK-në, është edhe për pacientët që vijnë nga zonat tjera të Kosovës.

znj.Lirie Hoti-Rama, U.D. drejtoresh e DSHMS, theksoi, ky objekt do të jepet në shfrytëzim vetëm për Qendrën e Shëndetit Mendor në Podujevë, çka nënkupton se pacientët do të jenë vetëm të Komunës tonë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, nëse s’ka tjerë të lajmëruar për diskutim e hedh në votim këtë propozim vendim për dhënie në shfrytëzim afatgjatë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, objektin e ish Emergjencës së Qytetit, sipas materialit përkatës dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 34 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit prezent, miratohet Propozim për dhënie në shfrytëzim afatgjatë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, objektin e ish Emergjencës së Qytetit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

9. Propozim vendim për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Kompania Regjionale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A.

z.Fahri Restelica, Nënkryetar i Komunës, theksoi, propozimin me emërimin e anëtarit të Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike-Kompania Regjionale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A. paraqitet për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin komunal me qëllim të sigurimit të funksionimit të rregullt, të qëndrueshëm dhe ligjor të kësaj Ndërmarrje ku aksionar është Komuna në përputhje me ligjin nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike. Propozimi për emërimin anëtarëve të komisioneve komunale të aksionarëve paraqitet në mandatin e ri të Kuvendit komunal prandaj në funksion të sigurimit të vazhdimësisë institucionale dhe në funksion normal të normalizimit të kësaj Ndërmarrje propozohet që Kuvendi i Komunës të shqyrtoj dhe miratoj përbërjen e cila do të propozohet nga ana e asamblastëve.

Sa për informatë, Kryetari i Komunës me vendim të veçantë emëron nga një anëtar për secilën Ndërmarrje Publike, andaj ju ftoj që t’i votoni propozimet për formimin e Komisioneve komunale të aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike të cilat janë si pika të rendit të ditës në këtë mbledhje.

z.Fatri Zhitija, theksoi, përfaqësuesi i LVV-së të Ndërmarrja Publike-Kompania Regjionale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A, propozohet të jetë z.Abedin Zeka.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, unë edhe dje në mbledhjen e KPF-së e kam pas një lloj propozimi për t’i menaxhuar këto Ndërmarrje, këta aksionar që shkojnë prej Kuvendi dhe sipas ligjit të raportojnë një herë në vit, por jo kështu, shembull tri Ndërmarrje përjashtojnë atë të mbeturinave, i bie që ne nga 3 aksionar t’i dërgojmë prej Komunës ata pastaj t’i zgjedhin nga 4 anëtar të bordit, 1 Kryeshef, 1 zyrtar financiar, pra për një Ndërmarrje 9 persona e që për 3 Ndërmarrje arrijnë 27 persona, shtoj këtu edhe aksionarët që shkojnë në KRM “Pastrimi” i bie diku rreth 30 persona që i

zgjedhim pa filluar puna fare, kur e dim që këto Ndërmarrje e veçmas KRM “Pastrimi” është me rënie të lirë e që nisur shembull nga fshati prej nga vie unë Siboc ka rreth 3 javë që nuk ka ardh t’i mbledh mbeturinat e që gjendja nëpër rrugë është bërë katastrofë dhe tani edhe qentë endacak i kan shpërndarë mbeturinat nëpër rrugë, pastaj NP Banesore për të cilën ne duhet t’i dërgojmë 3 aksionarë nga Komuna ku ata pastaj shkojnë dhe i zgjedhin edhe 4 anëtar të bordit, Kryeshefin, zyrtarin financiar kurse ajo Ndërmarrje nuk e ka asnjë punëtor, pra fjala bie Kryeshef i kujt është ai që zgjedhet në këtë Ndërmarrje Banesore ku se ka asnjë punëtor ajo, pse në këtë rast nuk i jepet, ne e dimë që kemi dhënë edhe subvencion kësaj Kompanisë së Pastrimit, Stacionit të Autobusëve dhe Eko-Llapit, i’a ka vlejtur që i kemi dhënë subvencion Eko-Llapit, u përmirësuar dhe po i kryen disa shërbime, pse nuk zgjedhin aksionar dy të Kuvendit dhe një të Ekzekutivit, gjithsej 3 në kuadër të Eko-Llapit e me i menaxhuar këto kompani, kështu nëse ne duam t’i punësojmë e t’i bëjmë më kallaballëk e të funksionojnë mundemi edhe kështu, por nëse duam punë funksionale kush nuk e din mund të hyjë e të shikoj edhe te qytetet më të mëdha që i kemi përreth si Zagrebi shembull qysh funksionon ku shkojnë dy prej Kuvendit dhe një prej Ekzekutivi të cilët i menaxhojnë krejt Ndërmarrjet Publike, ata vijjnë e raportojnë në Kuvend brenda një viti dhe funksionojnë për mrekulli. Unë e di që ka nevojë për punësime por të bëhet gjithë ky kallaballëk e që gjithë këta që shkojnë sigurisht që pas një muaji do të na e sjellin në Kuvend për votim sepse i kërkojnë pagesat që shkojnë si aksionar, e kërkojnë pagën minimale të asaj Ndërmarrje e tani paga minimale është 500 € dhe po t’i llogaritim këta 30 veta që punësohen këtu nga 500€ kah po na shkon neve buxheti pastaj. Më mirë është ato para t’ia ndajmë asaj kompanie dhe ta forcojmë.

Ne nuk e dimë gjendjen, kemi votuar edhe më herët, shembull për aksionar të Stacionit të Autobusëve dhe nuk e dimë se në çfarë gjendje është, ia kemi nda edhe një subvencionim 30,000.00€ dhe nuk e dimë a kanë paga ata që janë aty apo vetëm duam t’i zgjedhim, është goxha punë e koklavitur kjo. Pra unë do t’i bëja në një vend duke i zgjedh dy anëtar të përgjegjshëm dhe nuk ka lidhje prej cilës parti janë sepse s’ka lidhje dhe mua nuk më intereson ajo dhe e votoj, por pas një viti apo për çdo vit dua raporte prej tyre, me ditë se ku ka mbërri ajo Ndërmarrje, a është kthjellë apo ka krijuar ndonjë bazë apo deri ku kemi mbërri.

z.Fahri Restelica, Nënkyetar i Komunës, theksoi, i nderuar Ekrem, e kam pyetur edhe Zyrën ligjore dhe për Ndërmarrjet Publike ideja jote nuk funksionon, arsyeja është që secila Ndërmarrje duhet të ketë Komisionin e vet të Aksionarëve dhe këtu kjo përfundon, përndryshe unë prita që po jep ndonjë ide më të mirë se qysh t’i bëjmë rentabile këto Ndërmarrje, kurse sa për këtë që e potencove që nuk lejohet.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, unë e di që funksionon kjo i nderuar zotëri Nënkyetar, shembull kemi Ndërmarrjen për Banim e cila themelua me vendim të Kuvendit, atë minutë që vie në Kuvend ajo shuhet si Ndërmarrje. Tjetra, tash duhet të bëhet edhe Ndërmarrja e Tregut e cila i shuan këto Ndërmarrje, emrat ua heq dhe e bënë, shembull, për mua Ndërmarrja më e mirë është Eko-Llapi, ia jep Eko-Llapit në menaxhim këto dhe i menaxhon, unë e thash në këtë pjesë.

Çdo Ndërmarrje që është finalizuar këtu në Kuvend, me Kuvend hiqet, do të thotë këtë Ndërmarrjen Banesore unë e kam hulumtuar pak dhe e cila në vitin 2012 është funksionalizuar këtu në Kuvend dhe për mendimin tim ajo duhet të shuhet, mirëpo tani unë e di që ka nevojë sepse ka banesa dhe duhet të mirëmbahen ato, Kompani që i mbikëqyrë këto, përndryshe unë e llogarita sa shefa duhet të zgjedhën që të gjitha Ndërmarrjet të jenë funksionale e kështu që nëse ne duam të vazhdojmë kështu është diçka tjetër, por kur ajo të vie në Kuvend shuhet dhe ia jep Eko-Llapit në menaxhim dhe vazhdojmë, do të thotë se kjo mund të bëhet.

z.Fatri Zhitija, theksoi, vetëm një sqarim, e di që në mandatin e kaluar jemi angazhuar në këtë pjesë që t'i shkrijmë Ndërmarrjet në kuadër të Bordit të aksionarëve të Eko-Llapit. E di që Ligji për ndërmarrjet publike nuk ka lejuar që të bëhet shkrimi e gjithave, Stacioni, Tregu, Banimi e të tjerat, e që shumica prej tyre janë jashtë funksioni por vetëm ekzistojnë si ndërmarrje, pra që me u shkri dhe me u funksionalizuar edhe për shkak të kostos por për funksionuar dhe t'i jepej llogari vetëm një bordi dhe disa aksionarëve të cilët i kanë aksionarët që i përfaqësohen prej partive politike këtu në Kuvend.

z.Enis Shabani, theksoi, ne nga LDK e propozojmë për anëtar të komisionit z.Ermal Osmani.

znj.Rinesa Goxhufi, theksoi, në emër të PDK-së për anëtar të Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Kompania Regjionale e Mbeturinave "Pastrimi" Sh.A. propozoj znj.Mimoza Abdullahu.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ka propozime tjera, nëse jo atëherë siç e dini ne si Kuvend duhet të votojmë dy anëtarë nga radhët e Kuvendit kurse kemi tri propozime, andaj shkojmë me votim për secilin propozim veç e veç, sipas radhës dhe në fund konstatojmë se ata që marrin numër më të madh të votave do të jenë anëtar/ të komisioneve të aksionarëve të këtyre Ndërmarrjeve Publike.

-Pas votimit, u konstatua se nga 34 anëtarë/e të Kuvendit prezent në sallë, 20 vota ishin Për, që z.Abedin Zeka të jetë anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Kompania Regjionale e Mbeturinave "Pastrimi" Sh.A.

-Pas votimit, u konstatua se nga 34 anëtarë/e të Kuvendit prezent në sallë, 13 vota ishin Për, që z.Ermal Osmani të jetë anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Kompania Regjionale e Mbeturinave "Pastrimi" Sh.A.

-Pas votimit, u konstatua se nga 34 anëtarë/e të Kuvendit prezent në sallë, 20 vota ishin Për, që znj.Mimoza Abdullahu të jetë anëtare e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Kompania Regjionale e Mbeturinave "Pastrimi" Sh.A.

Në bazë të rezultateve të mësipërme të votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se dy anëtarët e propozuar z.Abedin Zeka dhe znj.Mimoza Abdullahu, kanë marrë numër më të madh të votave dhe me këtë zgjedhen anëtarë nga Kuvendi i Komunës në kuadër të Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Kompania Regjionale e Mbeturinave "Pastrimi" Sh.A. sipas propozim vendimit përkatës të dërguar me materialin e kësaj mbledhje.

10. Propozim vendim për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale Stacioni i Autobusëve Podujevë Sh.A

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, theksoi, edhe në këtë pikë të rendit të ditës kemi zgjedhjen e dy anëtarëve të komisionit komunal të aksionarëve respektivisht ngritjen e komisionit komunal të aksionarëve të Ndërmarrjes Stacioni i Autobusëve Podujevë, andaj e hapi debatin rreth kësaj pike për të cilën po ashtu kërkohen të jepen propozimet e anëtarëve për këtë komision sikurse procedura e mëparshme.

z.Besim Latifi, theksoi, i nderuar Kryesues unë po shohë që kjo është një parapërgatitje që anëtarët e komisioneve të aksionarëve të këtyre Ndërmarrjeve Publike të shkojnë kompletë prej pushtetit, konkretisht prej koalicionit të juaj që e keni bashkërisht. Vetëm dua t'ju them se kur po ju pëlqejnë praktikat e mëhershme po i merrni ndërsa kur nuk po ju pëlqejnë po i ndërroni, mirëpo

unë ju them se mund të hyni dhe të shikoni aksionarët se qysh kanë qenë në praktikat e mëhershme, pra gjithherë kanë qenë një anëtar nga pozita një nga opozita.

Si do qoftë, nëse veç vazhdoni me këtë lojë e numrave, si fazë mund të shkojë lehtë mirëpo për atë arsye pastaj edhe gjendjen e keni të keqe ku shembull këtë Ndërmarrje të Stacionit të Autobusëve duhet subvencionuar në vazhdimësi për ta mbajtur ngjallë si Ndërmarrje sepse nuk mundet të funksionoj dhe mbijetoj me të hyrat e veta që i ka.

z.Kasib Bashota, theksoi, Grupi i LVV-së e propozon z.Valdet Kamerollin dhe znj.Luljeta Muqollin për anëtar/e në këtë komision të aksionarëve.

znj.Alisa Jetullahu, theksoi, nga LDK propozojmë z.Arben Xhemajlin.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka propozime tjera, atëherë kalohet në votim sikurse procedura e mëparshme, pra për secilin anëtar sipas radhës votohet veç e veç, pastaj dy anëtarët të cilët marrin numrin më të madh të votave konstatohet se zgjedhjen anëtar të këtij Komisioni përfshirë edhe miratimin e propozim vendimit sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

-Pas votimit, u konstatua se nga 34 anëtarë/e të Kuvendit prezent në sallë, 20 vota ishin Për, që z.Valdet Kamerolli të jetë anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale Stacioni i Autobusëve Podujevë Sh.A.

-Pas votimit, u konstatua se nga 34 anëtarë/e të Kuvendit prezent në sallë, 22 vota ishin Për, që znj.Luljeta Muçolli-Azemi të jetë anëtare e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale Stacioni i Autobusëve Podujevë Sh.A.

-Pas votimit, u konstatua se nga 34 anëtarë/e të Kuvendit prezent në sallë, 14 vota ishin Për, që z.Arben Xhemajli të jetë anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale Stacioni i Autobusëve Podujevë Sh.A.

Në bazë të rezultateve të mësipërme të votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se dy anëtarët e propozuar z.Valdet Kamerolli dhe znj.Luljeta Muçolli-Azemi, kanë marrë numër më të madh të votave dhe me këtë zgjedhen anëtarë nga Kuvendi i Komunës në kuadër të Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale Stacioni i Autobusëve Podujevë Sh.A. sipas propozim vendimit përkatës të dërguar me materialin e kësaj mbledhje.

11. Propozim vendim për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A Podujevë

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, theksoi, tani kemi propozim vendimin për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A Podujevë, andaj e hapë diskutimin edhe për këtë pikë të rendit të ditës, urdhëroni kush dëshiron fjalën.

z.Kasib Bashota, theksoi, për Ndërmarrjen Publike Lokale “Eko-Llapi” propozojmë z.Arbrim Kunushefcin dhe z.Lulzim Pollomin që të jenë anëtar të komisionit të aksionarëve.

znj.Alisa Jetullahu, theksoi, nga LDK e propozojmë z.Valon Demollin.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, meqë nuk propozime tjera atëherë i hedh në votim propozimet e paraqitura, sipas renditjes, pra procedura është njëjtë sikurse ngritja e komisioneve paraprake.

-Pas votimit, u konstatua se nga 33 anëtarë/e të Kuvendit prezent në sallë, 19 vota ishin Për, që z.Arbrim Kunushefci, të jetë anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A. Podujevë.

-Pas votimit, u konstatua se nga 33 anëtarë/e të Kuvendit prezent në sallë, 19 vota ishin Për, që z.Lulzim Pollomi të jetë anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale Lokale “Eko-Llapi” Sh.A. Podujevë.

-Pas votimit, u konstatua se nga 33 anëtarë/e të Kuvendit prezent në sallë, 14 vota ishin Për, që z.Valon Demolli të jetë anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale Lokale “Eko-Llapi” Sh.A. Podujevë.

Në bazë të rezultateve të mësipërme të votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se dy anëtarët e propozuar z.Arbrim Kunushefci dhe z.Lulzim Pollomi, kanë marrë numër më të madh të votave dhe me këtë zgjedhen anëtarë nga Kuvendi i Komunës në kuadër të Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale Stacioni i Autobusëve Podujevë Sh.A. sipas propozim vendimit përkatës të dërguar me materialin e kësaj mbledhje.

12. Propozim vendim për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim Sh.A Podujevë

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse dikush dëshiron fjalën për këtë pikë të rendit të ditës.

znj.Flandra Kadriu, theksoi, nga LVV e propozojmë z.Florent Hasani dhe z.Fatri Zhitija.

z.Enis Shabani, theksoi, ne nga LDK-ja e propozojmë z.Ekrem Rrahmani.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, për shkak të angazhimit që kam, por dhe kështu unë jam i lindur si opozitar, tërhiqem nga gara sepse nuk më ka hije mua, kur jemi Për, këta e marrin fjalën, kurse kur jem kundër fjalën e marrë unë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, nëse s’keni propozime tjera atëherë po kalojmë në votim që z.Florent Hasani dhe z.Fatri Zhitija të zgjedhen anëtarë nga Kuvendi i Komunës në kuadër të Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim Sh.A. Podujevë, sipas propozim vendimit përkatës të dërguar me materialin e Konstatimeve nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pas votimit, meqë në këtë pikë të rendit të ditës kishte vetëm dy anëtarë të propozuar, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 32 anëtar/e të Kuvendit prezent në sallë, me 18 vota Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë Të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), z.Florent Hasani dhe z.Fatri Zhitija zgjedhen anëtarë nga Kuvendi i Komunës në kuadër të Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim Sh.A. Podujevë, sipas propozim vendimit përkatës të dërguar me materialin e Konstatimeve nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, unë shënimet i mora kush është zgjedh aksionar në këto Ndërmarrje publike dhe tani po jua rikujtoj Ligjin për ndërmarrje publike, raportimin para publikut dhe performancën e aksionarëve çdo komision i aksionarëve i përgjigjet Kuvendit Komunal mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësive të cilat u janë dhënë me këtë ligj, Komisioni komunal i aksionarëve do t’i raportoj Kuvendit Komunal në baza vjetore mbi performancën e këtyre kompetencave dhe përgjegjësive si dhe mbi arritjen e objektivave të përcaktuara në politikën e përgjegjësive të përcaktuara në nenin 62 të këtij ligji.

Më tepër nuk po lexoj sepse ne do t’ju kërkojmë llogari këtyre aksionarëve e besoj që do të vijnë të raportojnë dhe do të përgjegjshëm. Shpresoj që edhe Ekzekutivi ka me fut raportimin si pikë në rend dite sepse nëse nuk e kemi si pikë ne këtyre nuk mund t’ju kërkojmë përgjegjësi, por do të kërkojmë llogari prej tyre.

13. Të ndryshme

z.Kasib Bashota, theksoi, për Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-SHPMSH, kemi dy kërkesa prej qytetarëve të Llapashticës; 1- kërkesë është ndërtimi i trotuarit prej “Stadiumit Nderimi” deri te Lagja “Muçiqi” me gjatësi 450 metra, vërtetë në atë rrugë është rrezik si për këmbësorët ashtu edhe për biçikletat andaj kërkesa ime është që brenda mundësive Drejtoria përkatëse ta përfshij ndërtimin e këtij trotuari sepse e lidh gjithë fshatin me Podujevën.

2-Kërkesë është ndërtimi i urës te “Mulliri i Havollëve”, aty është një urë vetëm me një korsi kalimi, në këtë urë kanë ndodh tri aksidente me pasoja ekonomike-materiale shumë të mëdha por fatbardhësisht nuk ka pasë dëme në njerëz dhe kjo urë është shumë e dëmtuar fizikisht dhe ka nevojë që të intervenohet në rregullimin dhe zgjerimin e saj.

z.Enis Dervisholli, theksoi, kemi kërkesa nga qytetarët për riparimin e rrugëve ”Ibrahim Demolli” dhe “Iliria”.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, nga qytetarët kam kërkesë që dy çështje të ngritën në Kuvend.

Çështja e parë, sa e di para dy vitesh afërsisht nëse nuk gaboi është diskutuar për krijimin e linjave të trafikut urban, qytetarët janë të interesuar ta dinë se çka po ndodh me këtë pjesë dhe a pritët të punohet diçka në atë drejtim.

Një pyetje tjetër e kam nga një qytetar, saktësisht nga familja Hamiti që jetojnë në magjistralen Podujevë-Prishtinë te kilometri i parë, saktësisht te dyqani “Agro Bau” që po kanë probleme me ujë të pijshëm, sipas tyre ata kanë bërë edhe kërkesë në Drejtorinë përkatëse, mirëpo nuk kanë marrë përgjigje ende.

E di që kam drejtë dy pyetje, mirëpo po e them se në rr.”Haxhi Sadri Blaku” ndriçimi publik ka probleme dhe duhet dikush ta mirëmbaj atë.

znj.Gresa Qosa-Maqastena, theksoi, meqenëse drejtori i DKA-së nuk është prezent për momentin, por shpresoj që pyetjen e merr publikisht dhe kërkoj që në seancën tjetër të përgjigjet.

Kur dihet që në secilin sektor të jetës tonë, si në administratë, arsim, shëndetësi e të tjera i kemi të punësuar ata që i kanë përfunduar studimet në sektorin privat, e kam një pyetje për DKA-në, pse studentët e sektorit privat që janë student nuk marrin bursa nga Komuna por vetëm janë të privilegjuar vetëm ata student të cilët janë duke i përfunduar studimet në sektorin shtetëror, kjo është pyetja ime sot për drejtorin e DKA-së z.Avni Fetahu.

z.Lulzim Pollomi, theksoi, sot po e marr fjalën për të ngritur një shqetësim serioz që prek drejtpërdrejtë jetën e përditshme të banorëve te “Lagjia e Dëshmorëve” në Ballofc , konkretisht në rrugën që e lidh këtë lagje me fshatin Surkish, gjendja e kësaj rruge është jashtëzakonisht e rëndë dhe e pa pranueshme për një komunitet që meriton kushte dinjitoze të jetesës, rruga është e dëmtuar në masë të madhe me gropa dhe deformime që e bëjnë lëvizjen të vështirë dhe të rrezikshme si për automjete ashtu edhe për këmbësorët.

Përveç kësaj ndriçimi publik në këtë zonë është jashtë funksioni, errësira gjatë natës rrit ndjeshëm pasigurinë për banorët e veçanërisht për fëmijët pasi që në këtë pjesë të Lagjes është edhe shkolla “Dëshmorët e Kombit” me një numër shumë të madh të nxënësve. Mungesa e ndriçimit jo vetëm që vështirëson qarkullimin por gjithashtu krijon rrezik potencial për fëmijët.

Një problem tjetër shqetësues është mungesa e trotuarit, këmbësorët detyrohen të ecin në rrugë bashkë me automjete e kështu duke e rrezikuar jetën çdo ditë, kjo është e pa pranueshme dhe kërkon ndërhyrje urgjente nga institucionet përgjegjëse. Prandaj përmes kësaj kërkesë kërkoj nga Komuna dhe Drejtoria përkatëse që të bëhet sanimi dhe asfaltimi i kësaj rruge, të rikthehet ndriçimi publik sa më parë dhe të ndërtohen trotualet për sigurinë e këmbësorëve. Këto nuk janë kërkesa luksi por nevoja bazike për një jetë të sigurt dhe dinjitoze për qytetarët tanë.

Ju faleminderit për vëmendje dhe shpresoj për veprime konkrete dhe të shpejta nga ana juaj.

z.Valdet Restelica, theksoi, kam një pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, lidhur me rr.”Zahir Pajaziti” ku janë duke u bërë punime por me një dinamikë shumë të ngadaltë dhe po vërehet që shoferët po kanë shumë telashe në qarkullim e që po vie deri te rrezikshmëria e aksidenteve sepse është dëmtuar shumë ajo rrugë, andaj edhe sa kohë merr riparimi komplet i kësaj rruge dhe a është duke u punuar me intensitet të plotë.

z.Isak Ejupi, theksoi, infrastruktura e fshatit Sekiraqë, besoj e dini që është ndërtuar komplet me vet kontribut të banorëve të fshatit, ditëve të fundit kemi probleme me rrugën që shpie deri te shkolla dhe kemi punuar në atë drejtim me dy pronarët e pronave që janë rreth asaj rruge me të cilët kemi gjet mirëkuptim që ta lirojnë një hapësirë për ndërtimin e trotuarit për fëmijët sepse ajo rrugë tash ka filluar të përdoret edhe nga veturat dhe normalisht që paraqet rrezik edhe për fëmijët. Andaj ju kisha lut që në planet për vitin 2026 të futet ajo rrugë për zgjerim, asfaltim dhe për trotuar në shërbim për nxënësit e asaj shkolle.

Njëkohësisht ne e kemi kompletuar infrastrukturën e fshatit edhe me një objekt tjetër që do të shërbej për nevojat e komunitetit dhe aty para objektit ka nevojë për një përkrahje për fshatin, ndërkohë po ashtu kemi negociuar me pronarin e pronës që është ngjitur me shkollën dhe është e nevojshme që hapësirën që ai e ka liruar, të ndërtohet një fushë sportive që do të jetë në funksion të fëmijëve të asaj shkolle por edhe të komunitetit të të rinjve të fshatit Sekiraqë.

z.Enis Dervisholli, theksoi, kemi edhe një kërkesë për rregullimin e ndriçimit publik në rr.”Kongresi i Manastirit”, kjo është një kërkesë nga qytetarët e asaj zone. Po ashtu edhe në fshatin Penuhë banorëve i’u është premtuar ndriçimi publik andaj edhe aty mundësisht të bëhet ndriçimi publik sepse edhe aty është i domosdoshëm.

znj.Gresa Qosa-Maqastena, theksoi, meqë sot shërbimet publike u përmenden më shumë se të tjerat për shkak të problemeve sepse i kanë neglizhuar disa gjëra shumë të thjeshta, e din e edhe drejtori i kësaj Drejtorie që këtu afër në fund të sheshit “Ali Ajeti”, te laura e banesave njëherë i keni rregulluar kartelat, mëndej nuk e di se çka keni bërë me to, i keni dyfishuar dhe prapë është prishë laura dhe ka shumë probleme në atë parking të atyre banorëve të qytetit, ka shumë aksidente që ndodhin dhe janë disa lokale që e përdorin atë laurë e cila është prishur kurse ju keni premtuar se do e rregulloni, andaj ju pyes i nderuar drejtor se kur do të rregullohet kjo dhe kur nuk do t’i keqpërdorni ato kartela, sidomos për ata të cilët janë të Vetëvendosjes.

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, theksoi, të nderuar të pranishëm, dua t’i drejtohem me një kërkesë Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Podujevës, gjegjësisht drejtorit z.Avni Fetahu, kërkesa ka të bëjë me një organizim institucional me rastin e 5 Majit - Ditës së Dëshmorëve. Në rrethanat kur po tentohet të zbehet dhe deformohen vlerat e luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përgjegjësia për ruajtjen e kujtesës historike bie drejtpërsëdrejti mbi institucionet tona, e veçanërisht mbi sistemin arsimor, prandaj kërkoj nga Drejtoria e Arsimit që me rastin e 5 Majit-Ditës së Dëshmorëve të organizoj për çdo vit nga një vizitë të përbashkët dhe të detyrueshme për të gjithë maturanët e shkollave të mesme në Kompleksin e Dëshmorëve në Penuhë, dhe në Kompleksin Memorial Zahir Pajaziti në Orllan.

Shtrohet pyetja pse pikërisht me 5 Maj, sepse kjo është Dita e Dëshmorëve të Komunës tonë por edhe më shumë se kaq në këtë ditë, pranë varreve të Dëshmorëve janë të pranishëm edhe familjet e tyre e që është momenti më i ndjeshëm dhe më domethënës për nderim, prania e maturanëve dhe të rinjve tanë pranë tyre do të ishte jo vetëm një akt respekti por një mesazh i fuqishëm mirënjohje që do të bënte që këto familje të ndihen të nderuara dhe të vlerësuara nga brezi që po rritet në lirinë për të cilën ata dhanë gjithçka.

Pra le të shohin të rinjtë me sytë e tyre të vërtetën se kishte edhe Dëshmorë që ishin për afërsisht të moshës së njëjtë me ta por me një vendim shumë më të madh, lirinë mbi jetën. Në kuadër të kësaj

vizite të përfshihet edhe ndalesa te Këndi i Batalionit të Mjekësisë në Penuhë, si dëshmi e pa kontestueshme e luftës çlirimtare dhe dimensionit human të saj.

Po ashtu kërkojmë nga DKA-ja, të shqyrtojë edhe mundësinë që pjesë e këtij organizimi të jenë edhe semimaturantët në mënyrë që ky edukim historik dhe Kombëtar të përfshij sa më gjerë gjeneratat e reja. Pas pjesës përkujtimore maturantët mund të qëndrojnë për një aktivitet të lirë pranë liqenit të Batllavës në zonën e njohur të “Plepat në Orllan” si simbol i jetës së lirë të fituar me sakrificë. Ky nuk është vetëm një organizim por është një obligim moral dhe Kombëtar, kujtesa nuk ruhet me fjalë por me veprime dhe veprimi i juaj sot është garanci që historia jonë nuk do të tjetërsohet kurrë as nesër.

Presim trajtim me prioritet të realizmit pa vonesë të kësaj kërkesë e cila besoj se është edhe kërkesë e të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal të Podujevës.

z.Enis Shabani, theksoi, kemi një kërkesë nga qytetarët për zhbllokimin e rrjetit të kanalizimit të rr.”Vëllezrit Frashëri”.

z.Bahri Selimi, U.D. drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSSH, theksoi, po mundohem shkurtimisht që secilit t’i përgjigjem veç e veç sepse mbajta shënime dhe besoj që nuk më ka kaluar diçka.

Po filloj prej pyetjes ose kërkesës së z.Kasib Bashota që ishte kërkesë për trotuar dhe ndërtim të urës, për të gjitha kërkesat që janë për investime kapitale dua t’ju them që këtë vit nuk ka ndërtime të reja nga DHPMSH por as Drejtoritë tjera nuk planifikojnë investime kapitale për shkak të buxhetit, e biseduam më herët punën e buxhetit, besoj se e keni të qartë, do të thotë nuk ka investime kapitale, ka veç mirëmbajtje. Sa i përket mirëmbajtjeve jemi dakord me secilin prej jush por te ndërtimet i nderuar Kasib më vie shumë keq por nuk bëhet as trotuari e as ura, mirëpo vitin tjetër e bënë kërkesën në kohën e caktuar.

Pastaj z.Enis Dervisholli pati dy kërkesa, për rregullimin e rr.”Ibrahim Demolli” dhe ndriçimin publik të rr.”Kongresi i Manastirit”, te riparimi i rrugëve ju veç e keni parë që kemi filluar me riparim të rrugëve mirëpo kemi pak probleme si pasoj nga koha dhe pak nga neglizhenca e kompanisë përkatëse, por është në vazhdimësi duke ecë. Prioritet i yni është fillimisht me i mbyll gjitha gropat brenda pjesës urbane apo qytetit e për të vazhduar pastaj në periferi dhe fshatrat e rëndësishme që kontrata është e lidhur dhe janë duke vazhduar punimet. Te riparimi po lidhet edhe një pyetje tjetër të “Lagjja e Dëshmorëve”, që u paraqitë nga njëri prej asambleistëve (Lulzim Pollomi), atë rrugë e dimë që është në gjendje të keqe për shkak të punimeve që i ka bërë Ujësjellësi me vendosjen e gypit prej “Lagjes së Dëshmorëve” deri në rezervuarin të “Parku i Pishave”, ajo ka mbet ashtu sepse nuk kemi mundur të intervenojmë për shkak të kontratës së lidhur të ujësjellësit e cila ka qenë aktive e që nuk kemi të drejtë të ndërhyjmë me dy kontrata brenda një kontrate, andaj është dashur të presim derisa t’i kaloj plani dinamik asaj në mënyrë që të vazhdojmë, por tash me kontratën që kemi lidh besoj që janë pjekur kushtet dhe do të rregullojmë rrugën dhe trotuarin që janë në gjendje goxha të mjerueshme.

znj.Arnisa Sylejmani pat tri pyetje, e para trafiku urban që ishte shumë me vend, është e vërtetë që e kemi biseduar kaheerë dhe tash jemi në fazën kur e kemi biseduar edhe në bord dhe në një rreth pak më të gjerë, tashmë jemi gati në fazën finale të shpallja por diskutabile është se a të shpallët me operator privat apo të futet në kuadër të Stacionit të Autobusëve, e duke marrë për bazë gjendjen e Stacionit të Autobusëve nuk e dimë qysh do të veprojmë, mirëpo me rëndësi është që të gjitha kushtet janë pjekur, dokumentacioni është i gatshëm, shpallja publike është e gatshme dhe vetëm po presim me u pjek kushtet dhe të vazhdojmë me trafik urban e që besoj që së shpejti për të mos thënë brenda këtij viti keni me parë trafikun urban në Komunën e Podujevës, besoj që para se të bëhet shpallja ndoshta do të bëjmë edhe një dëgjim publik sepse e kërkon rendi ashtu.

Ne tani për pjesën urbane kemi planifikuar tri linja të cilat janë të specifikuara edhe me vendndalime dhe linjat kah janë, që i bie se është e përfshirë komplet pjesa urbane me trafik urban, tri linja me 7 autobusë, secila linjë i ka nga 2 autobusë dhe 1 autobusë duhet të jetë gjithëherë i gatshëm apo rezervë për raste emergjente. Me një fjalë të gjitha janë të gatshme, por ta kemi dëgjimin publik keni me qenë pjesë edhe ju dhe do ta shihni se çka përfshihet sa i përket qarkullimit të linjave sepse jemi munduar ta përfshijmë komplet pjesën urbane dhe të mos ketë asnjë pjesë të qytetit apo qytetarët larg autobusin urban.

Sa i përket problemit me ujë të pijshëm në Lagjen që e ceke në magjistralen Podujevë-Prishtinë, tani për tani nuk e di sepse në këtë kohë nuk kemi probleme me ujë të pijshëm, është bërë një rregullim, nuk e di dhe nuk e kam këtë si kërkesë, aty mund të jetë ndonjë problem teknik brenda sepse madje nganjëherë edhe brenda rrjetit të shtëpisë mund të kenë probleme dhe mandej e paraqesin si problem në Komunë.

Te ndriçimi publik tashmë e dini që kemi një kontratë me Ndërmarrjen Eko-Llapi e cila është duke punuar në vazhdimësi në rregullimin e të gjitha dëmtimeve në rrjetin publik, një risi është që tani dua ta shfaqim këtu është se kemi filluar para dy-tri ditëve me role kohore në mënyrë që me ndal në ora 12:00 të natës, ai lëshohet me errësim, do të thotë e ka kohën kur lëshohet dhe ndalet në ora 24:00, pra kemi filluar ta zbatojmë këtë praktikë e qëllimi dhe arsyeja e kësaj është për shkak të shpenzimeve të mëdha që janë bërë. E patë edhe në raport financiar janë mbi 500,000.00€ pagesë veç për ndriçim publik, prandaj e kemi bërë me role kohore dhe tash mund të përgatiteni edhe ju dhe përgatitni ju dhe ata që ju bëjnë kërkesa sepse mund t'ju bëjnë kërkesa pse po na ndalet ndriçimi në ora 24:00, pra ne kemi filluar me fshatin Dumnicë ku tash atje në ora 24:00 ndalet ndriçimi publik dhe jemi duke vazhduar në gjithë territorin e Komunës me këtë orar.

Sa i përket pyetjes së z.Valdet Restelica për riparimet në rr."Zahir Pajaziti", ne tani prej mëngjesit jemi këtu në seancë, mirëpo tashmë gropat janë mbyllur atje, e di që janë vonuar paksa por tash më njoftuan që janë duke i mbyllë ato gropa dhe një pjesë e madhe e tyre janë mbyllë dhe janë duke punuar në atë drejtim.

Sa i përket kërkesave të z.Isak Ejupi që ishin për ndërtimin e trotuarit në "Sekiraqë" dhe zgjerimin e rrugës atje i cili kërkoi të futet në projektet e radhës sepse e din që tash nuk kemi mundësi ta bëjmë një gjë të tillë.

Ishte edhe çështje e fundit që u ngrit nga znj.Gresa Qosa-Maqastena dhe e cila më bëri shumë përshtypje sa i përket laurës te Sheshi këtu afër, në fakt i ngriti disa akuza e të cilat nuk qëndrojnë dhe janë shumë të pa baza sepse e tha keqpërdorime të kartelave. Ju e dini shumë mirë se qysh e kemi bërë atë për ata që banojnë e jetojnë në ato banesa, shumë mirë e dini se çka kemi bërë ne për atë bllok banesor, përveç që e kemi bërë laurën i kemi bërë edhe kartelat për secilin banorë me emër e që unë e kam edhe listën e gjithë banorëve me emra që i kemi pajisur me kartela, mirëpo pastaj shumëzimin e tyre fatkeqësisht e keni bërë ju, nuk e kemi bërë ne. Tri herë kanë shkuar Inspeksioni së bashku me Polici dhe i kanë dënuar të gjitha automjetet që nuk i përkin banorëve të bllokut banesor dhe kur e kanë parë që ne po e bëjmë mbikëqyrjen pastaj kanë filluar dhe e kanë thyer laurën, ne e kemi rregulluar tri herë atë laurë dhe prapë e njëjta është e thyer, do të thotë krejt fajin aty e kanë banorët, Komuna e ka bërë krejt atë që i ka takuar në bazë të Ligjit për shoqëritë e banimit, pra i kemi siguruar secilit banor nga një parking në atë pjesë, por kur kemi parë se nuk po funksionon kështu ne prapë nuk jemi ndal dhe nuk e kemi ndërmend të ndalemi tash me këto keqpërdorimet që i bëjnë banorët dhe qytetarët në këtë rast të atij banimi kolektiv aty, mirëpo kemi planifikuar laura për të gjitha banimet kolektive dhe janë 4 laura të reja që do të hapen vetëm me tabela të automjeteve, nuk do të hapen më me kartela, kontrata është lidhur dhe kur ne ta shohim të arsyeshme që janë pjekur kushtet dhe të lirohet kompania, ne do i vendosim ato. Pra këto janë të

planifikuara në kuadër të asaj kontrate që është për mirëmbajtjen e rrugëve dhe pa u mbyllë krejt gropat në territorin e Komunës nuk punojmë diçka tjetër, ato janë të specifikuar dhe janë të kontraktuara që i zgjatë asaj kompanie të punoj, pra që e zgjatë punën por që ato janë brenda kontratës, që mund të ndodh deri te ndonjë shkëputje eventuale e kontratës apo diçka tjetër kjo mund të shtyhet apo vonohet deri sa të lidhet kontrata tjetër, por tashmë është kontratë e lidhur edhe për 4 lura që janë të përfshira 4 blloqe kolektive ku kanë me u pajis me lura të cilat do të hapen me tabela të automjetit, pra po e provojmë edhe këtë, nëse nuk bënë edhe kjo, Zoti zgjidhjen ua bëftë se s' di çka u bëj më.

znj.Gresa Qosa-Maqastena, theksoi, ju po bini në kundërshtim i nderuar drejtor sepse këndeje po thoni po e dërgojmë inspeksionin kurse inspeksioni po na dënon neve banorëve, mua personalisht më ka dënuar pse unë s'kam pas vend ku me parku makinën dhe është dashtë me lënë diku, ndërsa bizneset që janë aty afër, e jo banorët qysh na fole, por ato biznese që janë të afërta me juve i kanë dyfishuar për të pasë punë më shumë duke na e bërë të pa mundur neve parkimin e makinave, përndryshe sa herë jemi ankuar te Policia ata kanë thënë ne nuk i kemi tabelat se kush ka të drejtë parkimi këtu, veç qysh i gjejmë ashtu.

z.Bahri Selimi, U.D. drejtor DSHPMSH, nga vendi, theksoi, s'është e vërtetë as kjo.

znj.Gresa Qosa-Maqastena, vazhdoi, atëherë dikush po gënjen këtu, po ashtu dua të them se nuk është e vërtetë që ne banorët i kemi dyfishuar apo kopjuar kartelat e laurës sepse ne e kemi të pa mundur t'i lëmë diku tjetër makinat. Unë vetëm dua të ndërlidhem me atë se qysh të duket ty me ardhë dikush para derës tuaj në shtëpi e me ta lënë makinën aty dhe me ta pamundësoj ty me dalë, situatë kjo e cila i'u ndodh qytetarëve aty, madje edhe për raste emergjente me të sëmur e që duhet pastaj me i thirr njerëzit me telefon ejani e largojeni makinën se s'po mund me dalë.

z.Bahri Selimi, U.D. drejtor DSHPMSH, theksoi, unë besoj që ti e dinë shumë mirë për të gjitha këto procedure që i kemi bërë, e din shumë mirë që ne kemi ardhë me listë te secili banor ku ia kemi marrë emrin dhe targën e automjetit dhe e kemi bërë listën, atë listë unë e kam në Drejtori, mund t'jua ofroj kur do që doni mund të vini dhe ta merrni listën e banorëve që ne i kemi bërë me numra të targave të automjeteve që i posedojnë ata. Ka pasë kërkesa që dy automjete me i lënë, ne ju kemi thënë veç një sepse ligji na thotë që t'jua sigurojmë një parking një banori dhe ne ua kemi bërë veç për nga një automjet, me listë dhe me kartela, mirëpo që kartelat pastaj janë shumëzuar prej banorëve apo prej bizneseve, ajo është çështje krejt tjetër, ato biznese që janë aty, unë e di prej banorëve dhe prej bizneseve, ne nuk i kemi shumëzuar kartelat, ne jemi munduar ta mirëmbajmë atë parking në mënyrën më të mirë sepse kemi investuar aty, kemi bërë një laurë dhe kartelat për secilin banor. Sa i përket kësaj në kundërshtim listën, listën e kemi dhe mund ta shikoni kurdo që dëshironi e që sigurisht që i njeh ata banorë se a janë apo s'janë aty duke banuar, mirëpo ne vetëm me atë listë kemi vepruar dhe asnjë kartelë më shumë nuk e kemi dhënë.

Pastaj policia që të kanë thënë nuk është punë e jona, unë ju them se inspektori nuk shqipton gjopa në trafik, unë e kam dërguar Policinë së bashku me inspeksion dhe jo veç ty por secilin që e ka gjet aty që se ka pasë parkingun e që aty e ka pasë automjetin ka qenë biznes ose jo, nuk na ka interesuar, pra unë ia kam dhënë listën, Policia edhe sot e ka listën të cilën ua kam dhënë dy herë dhe të përditësuarën, dhe e them me përgjegjësi se Policia e kanë listën dhe me atë listë i kam thënë që të veprojnë Policisë.

Sa herë është thyer ajo laurë, 3-4 herë, nuk e kam thyer unë sepse asnjëherë në jetën time nuk e kam parkuar makinën aty, e keni thyer ju banorët vet, unë banorët i lë fajtor dhe nëse ju nuk keni arrit ta ruani atë shumëzimin e kartelave prapë është faji tek ju sepse ju ja keni dhënë kartelat shokut apo dikujt tjetër nga familja dhe janë shumëzuar ato, të gjitha këto i di këto me detaje se kush i ka shumëzuar ato kartela dhe kush i ka dhënë, por nuk dua të flas me emra këtu, këto i kanë

bërë ata njerëz të atij kompleksi që banojnë dhe punojnë aty, ata janë brenda atij rrethit, përndryshe unë ju kam treguar që punët ne i bëjmë me prioritet dhe nuk e vendosi laurën pa i mbyll gropat, pastaj vie në radhë laura.

z.Enis Dervisholli, theksoi, për riparimin e rrugëve a ka ndonjë komision për me ditë cilat rrugë kanë nevojë sepse në përgjithësi të gjitha rrugët kanë nevojë për riparim, kompanitë nuk janë të Podujevës për me ditë se cilat rrugë kanë nevojë më shumë të riparohen.

z.Bahri Selimi, U.D. drejtor DSHPMSH, theksoi, përveç komisionit i cili është komision për pranimin e punëve në kontratë që tashmë janë duke u bërë, ne e kemi një inxhinierë të komunikacionit në kuadër të DSHPMSH që së bashku me menaxherin e kontratës kanë dalë që një javë dhe e kanë bërë krejt identifikimin e gropave, ka mund t'ju ikë ndonjë mirëpo kjo çështje është edhe e juaja që nëse diku ka ikë ndonjë gropë pa u evidentuar, mirëpo e rëndësishme është që e kanë bërë identifikimin dhe janë duke punuar në atë drejtim, pra edhe ju për secilën gropë që e dini që ka mbetur e hapur tregona sepse ne jemi duke punuar në atë drejtim dhe jemi në vazhden e kësaj pune që të mbyllen të gjitha gropat, me përjashtim të ndonjë grope që ndoshta nuk mund ta evidentojmë, por s'është mirë të mos e evidentojmë asnjë, prandaj jeni edhe ju, që t'i paraqitni.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, ju falënderoj për diskutimin dhe kontributin e juaj për këtë takim, konstatoj të përfunduar mbledhjen.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, duke i falënderuar për pjesëmarrjen Kryesuesi i Kuvendit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 15:35

Procesverbalin e mbajtën dhe hartuan;
Enis Sheholli
Osman Bajrami

Nr.Prot.01-060/04-0019223/26
Podujevë,
31 mars 2026

Kryesuesi i Kuvendit
Isak Shabani